



Formulari për Paraqitjen e Tezës së Magjistraturës

Emri: Pajtesa Bisha

Program Studimor: Diplomaci (MSC)

Fakulteti: Shkencave Shoqërore Bashkëkohore

Fillimi i Studimeve: 01. 09. 2018

Universiteti i Evropës Juglindore

Tetovë 2022

Kërkesë

Me mbylljen me sukses të provimeve të sezonit të fundit, kam nisur të punoj për punimin e Temës së Diplomës, të përzgjedhur që nga vjeshta e vitit të kaluar. Motivimi në punimin e hulumtimit ka qenë nxitja për të reaguar në mënyrë studimore ndaj rasteve të shumta të abuzimit me të drejtën njerëzore në Shqipërinë postkomuniste, duke realizuar punë sistematike në gjetjen e fakteve, rasteve të shkeljeve, abuzimeve, reflektimin e sistemit të drejtësisë dhe të faktorit ndërkombëtar etj. Kjo ka dhënë pasqyrën e plotë dhe strategjinë për ta sistemuar atë në këtë material hulumtues. Duke realizuar një punim modest dhe serioz, po parashtoj kërkesën time pranë Departamentit të Universitetit të Europës Jug-lindore, për miratimin e temës:

“Njohja dhe Respektimi i të Drejtave të Njeriut në Shqipërinë postkomuniste”

(“Признавање и почитување на човековите права во посткомунистичка Албанија“)

("Recognition and respect of Human Rights in post-communist Albania")

Kandidati

Pajtesa Bisha

Mentori

Prof. Dr. Zemri Elezi

Deklaratë e Studentes për Punë Origjinale

Me anë të kësaj deklarate, unë Pajtesa Bisha deklaroj me përgjegjësi se, ky punim nuk është prezantuar për vlerësim, apo botuar më parë, pjesërisht apo në tërësi, pranë këtij apo ndonjë institucioni tjetër. Më tej deklaroj se:

- a) Punimi i paraqitur këtu, është punuar në tërësi nga unë;
- b) Punimi nuk është marrë nga studentë të tjerë, apo nga punime të tjera në Universitetin e Evropës Juglindore, ose ndonjë universiteti tjetër;
- c) Punimi nuk është kopje e ndonjë publikimi të marrë në internet apo bibliotekë;
- d) Punimi nuk përmban modifikim të dhënash, duke i paraqitur ato si kontribut origjinal;
- e) Punimi respekton të gjithë kërkesat për të drejtat e autorit, duke i saktësuar dhe cituar të gjitha kontributet nga burimet e tjera.

Ky punim Diplome vlen për ciklin e studimeve “Master” dhe mban titullin:

“Njohja dhe Respektimi i të Drejtave të Njeriut në Shqipërinë Postkomuniste”.

Dëshmoj se jam vënë në dijeni që, vërtetimi ndryshe i atyre që u thanë më sipër, do të rezultojë me tërheqjen e titullit të fituar, bazuar në këtë punim.

Studentja Pajtesa Bisha

Tetovë, 2022.

Titulli Punues i Temës:

Working Title of the Topic:

“Njohja dhe Respektimi i të Drejtave të Njeriut në Shqipërinë Postkomuniste”

“Признавање и почитување на човековите права во посткомунистичка Албанија“

"Recognition and Respect of Human Rights in Post-communist Albania"

PËRMBAJTJA

1.		
2.		
3.		
4.		
5.		
6.	i punimit.....	13
7.	90	
8.	Bibliografia.....	92

CONTENT

1. Subject of study	3
2. Purposes of the analysis	7
3. Hypothesis	8
4. Study methodology	8
5.Importance of the Paper	11
6. Structuring the Paper	13
7. Completion	90
8. Bibliography	92

Tema: “Njohja dhe Respektimi i të Drejtave të Njeriut në Shqipërinë Postkomuniste”

1. Lënda e Hulumtimit

Njerëzimi është krejt i lirë të zgjedhë vlerat dhe mënyrat e jetesës. Njerëzit janë absolutisht të lirë të zgjedhin, ata duhet të zgjedhin, sepse secili duhet të zgjedhë një mënyrë për të jetuar jetën e tij. Shumë njerëz ende nuk e kuptojnë që e kanë këtë liri, duke jetuar me mendimin se u mungon filozofia e veprimit mbi të drejtën e mëvetësisë së jetës së tyre. Sipas Aristotelit, “*..inteligjenca është shkalla përcaktuese e lirisë së individit. Njeriu inteligjent kërkon liri dhe jo kënaqësi*”. (Aristoteli, 2001:9). Çfarë kuptojmë me drejtësi dhe padrejtësi? Njeriu është i prirur në ekzistencën e tij të futet në marrëdhënie me botën që e rrethon dhe më pas, të orientojë dhe përkufizojë vetëveten në raport me të.

Kudo në botë liria dhe të drejtat kanë një çmim, përballë zhgënjimeve që pëson individi në raportet e përcaktimit, njohjes, respektimit dhe dhunimit të tyre që çojnë në diskriminim etnik, racor, etno-kulturor, duke ngritur barriera të larta kundër vlerave të jetës në liri. Përvoja botërore ka treguar se zhdukja e pabarazisë dhe e mungesave ekonomike, është parakushti dhe paradigma bazë e zhdukjes së konfliktit midis njeriut, të drejtës, ligjit, shtetit dhe dhunës psikofizike.

Tema studimore bazohet në studimin dhe hulumtimin e rasteve të shkeljeve të të drejtave të Njeriut, të evidencuara në jetën e përditëshme mbi shtresat e ndryshme sociale, të rasteve dhe fenomeneve që shkaktojnë lëkundje të raporteve mes sistemit të drejtësisë dhe të drejtave njerëzore. Ato meritojnë më shumë vëzhgimin, ndërhyrjen dhe denoncimin e organizmave ndërkombëtare dhe Organizatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre juridike dhe institucionale të përfaqësimit në Republikën e Shqipërisë.

Detyrimi juridik me ndikime në fushën politike dhe diplomatike të marrëdhënieve të Republikës së Shqipërisë me jetën ndërkombëtare, të detyrimeve që ajo ka në rritjen e standardit të vlerave të një demokracie funksionale, nuk ka të bëjë vetëm me konstatimin, statistikën, pasojat, por duhet të orientojë drejt ndikimit efektiv, të cilin duhet ta ndiejnë pozitivisht në jetën e tyre qytetarët shqiptarë.

Në demokraci, presupozohet që institucionet e pushtetit politik “*të jenë përgjegjëse ndaj publikut*” (Piers Robinson, 2012: 212), kundër abuzimeve me të drejtën dhe ligjin, me krijimin e klimës së shëndoshë në respektimin dhe zbatimin e të drejtave të njeriut në Republikën e Shqipërisë, ndërhyrja e institucioneve ndërkombëtare në kushtëzimet politike të sistemit politik dhe pushtetit, duhet të kenë çmimin e lartë të ndryshimit, pa toleruar vlerat humane të ligjit, shtetit dhe shoqërisë, të vendosura dhe të pranuar nga bota demokratike në vite e shekuj.

Kjo do të thotë që opinioni i njerëzve që jetojnë në Republikën e Shqipërisë, të ndikojë në standardizimin e politikave juridike, në interes të edukimit me frymën e solidaritetit njerëzor, për garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në mjedisin shqiptar, sepse “*virtuti dhe vesi janë brenda fuqisë tonë*”. (Aristoteli, 2001:85). E para duhet respektuar, e dyta duhet mbajtur nën kontroll.

Ndikimi i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunimin Evropian (OSBE), si institucion prestigjioz, që monitoron dhe kontrollon respektimin e të Drejtave të Njeriut, paraqet periodikisht për çdo vit progres-raportin mbi ecurinë e realizimit të detyrimeve nga institucione ligjzbatuese për të drejtat qytetare në Republikën e Shqipërisë.

Në periudhën 30 vjeçare të sistemit të ri politik, në R. Shqipërisë janë miratuar shumë ligje dhe akte nënligjore për të harmonizuar të drejtën njerëzore, në raport me sistemin e drejtësisë, aktet juridike penale, civile, administrative, në raport me rritjen e fenomeneve negative me ndikime në jetën sociale të vendit. Raportet midis shtetit dhe individit janë, “*të dëshirueshme dhe sjellin kënaqësi, duke mbrojtur të mirën e individit, dhe fisnike e hyjnore, kur mbron të drejtën e komunitetit dhe shtetit*”. (Aristoteli, 2001:23). Përballë qëndrimeve të sistemit elitar të shoqërisë, perspektiva pluraliste në rritjen e dimensionit ligjor të frenohet hera herës, në dimensionin human, kundër konflikteve që krijohet midis shtetit dhe individit, dhunës, grabitjes së pronës, presioneve verbale, rrëmbimeve, përdhunimeve, abuzimeve me qëllime përfitimi etj.

Përballja e qytetarëve me sistemin e drejtësisë, në rastet e abuzimit me të drejtën, dhunës mbi gratë, fëmijët, abuzimeve seksuale, tentativëvrasjesh, ndotjeve akustike, vizuale, mitmarrjeve, mungesa e zgjidhjeve ligjore, janë bërë shkak i humbjes së besimit të qytetarëve mbi drejtësinë shqiptare. Korrupsioni në sistemin e drejtësisë, zvarritjet e vendimeve gjyqësore, pamundësia për të mbrojtur të drejtën ligjërishit përmes avokatisë sëpastër e të pavarur, kanë thelluar hendekun me qytetarin, duke lenë hapësira të shumta në dhunimin e të drejtave njerëzore.

Rastet e abuzimit me ligjin, keqpërdorim institucionesh për interesa të ngushta, të ballafaqimit të drejtësisë me qytetarin, raportet në respektimin dhe zbatimin e të drejtave të Njeriut, janë objekt hulumtimi në studim, si dhe lënda bazë për të arritur përmes analizës shkencore në përfundime optimale me efekte përmirësimi ligjor. Në shoqëritë me natyrë autoritariste, nuk ka hapësirënë respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave njerëzore. *“Të ndërgjegjshëm prej injorancës, shumica e njerëzve marrin përshtypje prej çdo njeriu, i cili është i pompuar, sikur të ishte i vetmi njeri i saktë, që thotë diçka që është sipër kokave të tyre”*. (Aristoteli, 2001:26). Koncepti filozofik mbi të drejtën përjashton diktatin. Shoqëria shqiptare vuan ende nga psikologjia e “njëshit”, duke anashkaluar dimensionin e të drejtës dhe lirisë. Kundër këtij mentaliteti, materiali njëkohësisht denoncon situatën mbrojtjes së të drejtave njerëzore në R. Shqipërisë, duke dhënë kontributin modest në përmirësimin e shëndetshëm të jetës social-politike të qytetarit shqiptar.

Përmes analizës shkencore dhe ballafaqimit, studimi përfshin trajtimin e kushteve dhe kritereve për reforma në R. Shqipërisë, mbështetur në synimet për antarësimin në BE. Bazë mbetet zbatimi i kërkesave të Traktatit të Amsterdemit i vitit 1999. Në thelb, *“çdo shtet evropian që respekton parimet e lirisë, të demokracisë, të respektimit të të drejtave të Njeriut dhe lirive themelore, të drejtat e shtetit ligjor, mund të aspirojë për t’u bërë shtete antar i BE”*. (Foot Rosemary, 2012:522).

Si lëndë bazë në studim, janë përfshirë elemente të subjekteve private, institucioneve të Shoqërisë Civile, të cilat marrin peshë të madhe në garantimin e të drejtave njerëzore, brenda standardeve demokratike bashkëkohore. Ndërthurja e tyre i bën më të besueshme përfundimet e studimit. Tërheqja e vëmendjes në studim, ballafaqon dukuritë dhe fenomenet me dokumentet fundamentale kushtetuese dhe juridike, procedurat penale dhe civile, aktet ligjore e nënligjore, të cilat respektojnë dokumentet ndërkombëtare të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut, duke realizuar lidhjen kauzale në funksion të qëllimit mbi standarde demokratike.

Në studim paraqitet trajtimi i thelbit të dokumenteve ndërkombëtare, të pranuar dhe ratifikuara nga Parlamenti në R. Shqipërisë, të cilat mundësojnë normimin e të drejtës penale-juridike kombëtare e ndërkombëtare, për mbrojtjen e të drejtave dhe kufizimin e jashtëligjshëm që i dhunojnë ato. Midis rëndësisë së konventave ndërkombëtare të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, në studim veçohen dallimet e mospërputhjeve që mund të ekzistojnë në zbatimin konkret, në mjedisin konkret. *“Jeta e një populli, institucionet e tij, besimet dhe arti i tij, nuk janë veçse indi i dukshëm i shpirtit të tij të padukshëm”*. (Le Bon, Gustave, 2001:6).

Si i kemi mbrojtur të drejtat e njeriut më herët në historinë tonë? Si impononte e drejta zakonore rregulla dhe norma që e bënin jetën më të lehtë? Atëherë, duhet të ndërtojmë urat e komunikimit me jetën moderne, e cila me vecoritë dhe karakteristikat e saj ndikon në mos ndërveprimin e shtresave sociale, etnitetet në mjedisin shqiptar, ushtrimin e disa besimeve fetare, shtresave në nevojë, motiveve kriminale që dhunojnë të drejtën publike dhe çenojnë sigurinë njerëzore etj. Këto fenomene të mbështetura nga masa të dëshpëruara në vështirësitë e jetës, janë kthyer në problem dhe shqetësim për drejtësinë dhe sigurinë publike.

Mbështetja në këto dokumente, ka sjellë interpretimin e drejtë të veprimit ligjor të institucioneve bazë ligjvënëse dhe drejtësisë. Ato shprehin vullnetin politik të pushtetit dhe shtetit për ndryshime pozitive. Konteksti tenton të shfaqet i dobishëm. Sipas Aristotelit, *“e padrejtë do të thotë ose e paligjshme, ose e pandershme, ndërsa e drejtë do të thotë, ose e ligjshme, ose e ndershme”*. (Aristoteli, 2001:140). Mbështetja juridike ndërkombëtare, ka nxitur institucionet shqiptare të jenë të kujdesshme në respektimin e raporteve periodike të hulumtimeve ndërkombëtare, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi institucionet për situatën që shfaqet në R. Shqipërisë.

Duke veçuar momentet e dukurive social-politike dhe ekonomike, në studim bëhen përpjekje për t'i përfshirë ato në këndvështrim të gjerë, të lidhura me pengesat juridike dhe sigurisë, që veprojnë ende në R. Shqipërisë. Sipas metodave analitike, krahasuese dhe ballafaqese, është synuar në përfundime dhe rekomandime, drejt masave parandaluese për kapërcimin e situatës.

Në këtë kontekst, tema studimore merr rëndësi teorike dhe praktike në format rekomanduese për institucionet ligjzbatuese dhe publike, të cilat nëkarakterin e tyre filozofik, politik, psikologjik, juridik dhe ekonomik, duhet të krijojnë hapësira të reja në vendimmarjen politike, në interes të klimës së besimit, drejt shoqërisë së shëndetshme përballë të drejtës, ligjit, individit dhe shtetit.

2. Qëllimi i studimit . Zhvillimet politike dhe shoqërore në R. e Shqipërisë, sjellin natyrë interesante studimore në fushën e të drejtave njerëzore. Ato lidhen me tranzicionin e tejzgjatur dhe të pambyllur. Ky mbetet problemi i problemeve për fusha të tjera me interes zhvillimi në jetën shqiptare. Realiteti me problemet shoqëruese, ka sjellë nevojën e studimit të thellë sociologjik, identifikimin e fenomeneve dhe dukurive të spikatura, që shfaqen në fushën e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duke evidentuar strategjitë dobishme në drejtësi, shëndetësi, punë sociale dhe sigurinë publike. Njohuritë bazë në trajtimin sociologjik të fenomeneve mbi të drejtat njerëzore, të ndërthurura në aspektin historik të trashëguar, por dhe aktual, kërkojnë transformim të thellë psikologjik. Ato janë *“elementet e ndryshëm të qytetërimit që përfaqësojmë”*, janë shfaqja *“e jashtme e psikologjisë tonë”*. (Le Bon, Gustave, 2001:38). Analiza dhe ballafaqimi evidentojnë elementet dominues të përgjithëshëm dhe veçues, të cilët kanë kultivuar klimë mosbesimi ndaj politikës, shtetit, ligjit dhe drejtësisë. Një arsye më shumë për të veçuar rëndësinë që merr studimi në mjedisin shqiptar, i cili kushtëzohet nga koha e gjatë e ndryshimeve dhe hapjen e negociatave të antarsimit në BE. Pse ka ndodhur kështu?! Ky është shqetësimi që shoqëron opinionin shqiptar dhe ndërkombëtar, duke kaluar në një situatë të lodhjes pa zgjidhje. Hapësira e veprimit të fenomenit, mban të brishtë realitetin shqiptar, përballë pengesave të situatës. Duke respektuar përmbajtjen e lëndës, natyrshëm shtrohen pyetjet kryesore kërkimore, të cilat japin të qartë thelbin e problemit:

- Si ndikon kultura strategjike dhe emancipimi shoqëror në përmirësimin e situatës juridike në R. e Shqipërisë, në garantimin e mbrojtjes së të drejtave njerëzore?
- Cilat janë qasjet e reja që mund të ndryshojnë situatën sociale, për rrugëtë sigurta drejt standardeve bashkëkohore?
- Cilat janë kriteret politiko-juridike dhe kushtetuese në drejtësi, si element bazë në mbrojtjen e të drejtave njerëzore?
- Pse drejtësia dhe rendi publik, mbeten elementet bazë të garantimit të të drejtave, përballë ligjit në marrëdhënie me qytetarin?
- Cilat janë qasjet e reja sociologjike në edukimin qytetar, arsimimin, kundër mospërputhjeve juridike në ndërtimin e marrëdhënieve; shtet-ligj-media-qytetar?

- Duke e konkretizuar në këtë formë objektin e studimit, ai plotëson pasqyrën e prekëshme të qëllimit të tij, duke i dhënë karakter racional, pragmatist, teoriko-praktik, me rekomandime modeste në përmirësimin e situatës.

3. Hipotezat

Një nga instrumentet më të rëndësishme përshkruese të punimit të tezës studimore është hipoteza e saj, të cilën do ta trajtojmë të ndarë në orientim dhe varësi të çështjeve kryesore që trajtohen, të ballafaquara me artikujt kryesorë të Deklaratës së të Drejtave të Njeriut në mjedisin social-politik shqiptar.

Si objekt kryesor dhe në nënshtresat e saj hipoteza do të ketë analizën e pamjes së përgjithshme të mbrojtjes së të drejtave, si dhe shkeljeve të tyre në sistemin social-politik në Shqipërinë postkomuniste. Si instrument i rëndësishëm përshkruese i punimit të tezës së magjistraturës, Hipoteza e Hulumtimit do të trajtohet në atë kryesore dhe ndihmëse.

Hipoteza kryesore:

Njohja dhe respektimi i të drejtave të njeriut është një nga shtyllat themelore të mirëfunksionimit të shtetit të së drejtës.

Hipoteza ndihmëse:

Të drejtat e njeriut janë të drejta dhe liri themelore pa të cilat njerëzit nuk mund të jetojnë si qenie njerëzore me dinjtet.

Ato përbëjnë bazën e lirisë, drejtësisë e paqes dhe respektimi i tyre mundëson progresin e plotë të individit dhe shoqërisë.

4. Metoda e Hulumtimit

Për brezin nëdemokraci, habia shmanget lehtësisht prej deformimeve të kohës, përballë opinioneve emocionale, drejt të vërtetave që ofron metodologjia shkencore e studimit dhe logjika dialektike e prurjeve të saj, jashtë ndikimeve ideopolitike. Kjo nuk paragjykohet në kohë edhe pse lidhjet shkakësore të periudhave që ka kaluar shoqëria shqiptare, kanë vështirësinë e tyre. Dyshimi për spekulime në hapësira të cekta të mendimit mbiveprimet nëmbrojtje të të drejtave njerëzore në R. e Shqipërisë, nuk kanë nisur herët ndaj pretendimeve spekulative, duke e sendërtuar arsyetimin logjik, (të etiketuar “*shkencor*”), mbi shtresëzime historike të padrejta.

Mendimet dhe metodat dogmatike nuk janë shkencore. Sipas konceptit politik, dogmat kanë sjellë deformime mbi të vërtetat historike. Ende kjo nuk ka sjellë vlerën e dobishme tek shoqëria mbi barazinë dhe të drejtat njerëzore. Të çliruara nga pasionet dhe ideologjia, studimet vlerësuese kthehen në nxitje shpirtërore dhe mendime të lira, drejt të vërtetave historike dhe vizionin për të ardhmen. Shpjegimi psiko-filozofik vlerësohet metodikisht i plotë, kur ushtrimi i të drejtave të individit dhe shoqërisë, do të jenë të plota në përputhje me standardet dhe bazën e progresit.

Metoda e thjeshtë teoriko-praktikeme natyrë kërkimore, mundësia dhe aftësia e interpretimit juridik të dokumentacionit bazë ligjor, synon t’u përgjigjet kërkesave të hipotezave, tëmarra si pika referimi. Kjo e ka sjellë problemin e mbrojtjes së të drejtave njerëzore më pranë realitetit, si pika lidhëse me racionalitetin e qëllimit dhe rëndësisë së temës studimore. Studimi mbi të drejtat e njeriut në Shqipërinë postkomuniste, sipas hipotezave, nuk merr përsipër t’u japë përgjigje të gjithë pyetjeve të shtruara, pasi mbrojtja e të drejtave njerëzore është dimension i gjerë veprimi, me ndikimin e institucioneve shtetërore dhe Shoqërisë Civile. “*Nëse një formulim është i vërtetë, të gjithë të dhënat janë në harmoni me të, ndërsa kur është i rremë, atëherë të dhënat shpejtë do të nxjerrin në pah mospërputhjet*”. (Aristoteli, 2001:38). Metodologjia e përdorur, krijon hapësira të reja diskutimi dhe gjetjen e përgjigjeve në perspektivë.

Referencat e përdorura në funksion të qëllimit të temës, kanë sjellë veç trajtimit teorik, të dhëna interesante mbi shëmbujt, format, statistikën, kategoritë e shkeljeve dhe abuzimeve me të drejtat njerëzore, shtresëzimet sociale, duke i dhënë materialit natyrën praktike. Metodologjia e studimit mbi metodën krahasuese, empirike, analitike, historiko-juridike, kanë dhënë natyrën interesante dhe intriguese. Metodologjia e studimit është orientuar në tre drejtime kryesore:

Metoda e krahasimit. Ballafaqimi i thelbit të dokumenteve ndërkombëtare me dokumentet fundamentale në R. e Shqipërisë, në mbështetje të garantimit të të drejtave të njeriut.

Metoda e ballafaqimit. Institucionet vendimmarrëse dhe ligjzbatuese të politikëbërjes, përballen me ndikimin negativ të kohëve, sistemeve politike, marrëdhënieve ndërkombëtare, si vlerësime reale dhe mundësi drejt shoqërisë sëhapur demokratike, qërespekton dhe mbron të drejtat e njeriut.

Metoda e analizës. Brenda hapësirës së shumë faktorëshme të veprimit të standardeve juridike që garantojnë të drejtat njerëzore, arrihet përmbledhja racionale e argumentuar, e besueshme, duke shfrytëzuar situatat institucionale dhe statistikat, në interes të qëllimit të temës. Përmes analizës dhe kundër mbulimit të gjendjes, shmanget ndikimi politik, duke i qëndruar korrekt të vërtetës së qëndrimeve kombëtare e ndërkombëtare në mbrojtjen e të drejtave të njeriut në R. e Shqipërisë.

Nëse strategjitë dhe politikat juridike të shtetit përbëjnë rrezik në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, kjo mbetet objekt i analizës dhe kritikës konstruktive me efekte ndryshimi. Zgjidhjet e problemeve delikate për shoqërinë dhe shtetin, janë të kushtëzuara nga ana juridike dhe alternative, duke respektuar karakterin gjithpërfshirës.

Studimi përfshihet në rastet e mira të kërkimit shkencor, mbështetur në instrumente teoriko-praktike të dobishme dhe të përshtatshëm për periudhën postkomuniste. Përfundimet normojnë, kushtëzojnë, sjellin qasje të reja për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të individit në R. e Shqipërisë.

5. Rëndësia e Studimit

Studimi mbështete në analizën e tre drejtimeve kryesore, të cilat në tërësi japin një pamje të plotë të kuptimit të dokumentit më kryesor të miratuar nga OKB, Deklaratës së të Drejtave të Njeriut. Kjo merr rëndësi të veçantë për faktin se, pa kuptuar në mënyrë sistematike përmbajtjen kryesore të Deklaratës, nuk mund të realizohet ballafaqimi politik, juridik, social dhe të ndikimeve të tjera mbi jetën e njeriut.

Studimi merr rëndësi të dyfishtë, në ndërthurjen e anës historike, pikënisjes, momentit të krijimit të saj dhe strukturës bazë, të cilat në kompleks, pasqyrojnë thelbin e të drejtave njerëzore sot në kohën moderne, kur kushtet e zhvillimit social-ekonomik dhe teknologjik, kanë hedhur në qarkullim doktrina të reja me ndikime cilësore në jetën njerëzore.

Rëndësia teorike. Teza përmban sqarime teorike mbi Konventën Europiane për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, si dokument ndërkombëtar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, hartuara nga Këshilli i Evropës. Deklarata siguron bashkpunim të ngushtë mes shteteve antare që e kanë miratuar, pranimi me dëshirën për t'i ratifikuar këto të drejta të plota. Shqipëria ka ratifikuar Konventën Evropiane, "*Mbi ushtrimin e të Drejtave të Fëmijëve*". (Strazburg 25.01.1996). Më 1 tetor 1994 u shfuqizuan të gjitha dispozitat dhe u ndryshuan protokollet. Më 1 nëntor 1998, hyri ligjërish në fuqi.

Rëndësia praktike. Studimi shërben si material i nevojshëm për brezat për njohjen dhe mbrojtjen e lirive Themelore të të Drejtave të Njeriut, duke u ardhur në ndihmë qytetarëve, nxënësve, studentëve për njohjen e situatës reale të vendit në promovimin dhe praktikimin e të Drejtave. Kjo bazohet nëhulumtimet shkencore. Ligjet e natyrës reflektojnë me haroninë e tyre njësoj në jetën sociale të shoqërisë. Atje ku prishet harmonia, prishen marrëdhëniet. Jetës së njeriut i duhet drejtësi politike, "*e cila mund të bazohet në ligjet natyrore ose qytetare (sociale)*". (Aristoteli, 2001:148). Studimi i shërben bibliotekës universitare, duke qenë studim shkencor që mund të merret si burim studimi nga studiues në UEJL dhe më gjerë.

Shprehjet, "*të drejtat e njeriut*", "*të drejtat njerëzore*", "*të drejtat e personit*", janë përdorur në mënyre alternative për t'iu referuar të njëjtit koncept. Më përpara përdorëshin shprehjet, "*të*

drejta natyrore” dhe “*të drejta origjinare*”. Gjithashtu, shprehja “*të drejta morale*”, e përdorur nga Stuart Mill. (Hooker, 2007:8, § 7, Cituar Edmond Kumnova), bën pjesë në filozofinë juridike të të drejtave. Mund të ruhet pikpamja mbi të njejtin vlerësim politik dhe social.

Me përfshirjen e të drejtave tënjeriut brenda deklaratave të para kombëtare dhe ndërkombëtare apo dhe në kartat kushtetuese kombëtare, filloi të flitej për, “*të drejta themelore*” apo “*liri themelore*” (Hooker, kapitulli I, 2007:8, §7, Cituar E. Kumnova). Duke analizuar terminologjinë e përdorur nga shekulli XVIII deri më sot, koncepti “*njeri*” i referohet qenies njerëzore në mënyrën më të gjërë të mundshme, edhe pse duhet nënvizuar që hera-herës termi është përdorur për t’iu referuar vetëm disa kategorive njerëzore (shtetasve, grave, fëmijëve, punëtorëve, të huajve, refugjatëve etj).

Historiku: Koncepti mbi drejtësinë dhe padrejtësinë mes qënieve njerëzore, është i hershëm. Raportet mes tyre kanë evoluar sipas zhvillimit të marrëdhënieve njerëzore në etapa të ndryshme të shoqërisë njerëzore. Sipas Aristotelit, “*Drejtësia është mesore, (e mesmja e Artë), jo sikurse virtytet e tjera, sepse ajo ka të bëjë me një kusht të ndërmjetëm, ndërsa padrejtësia ka të bëjë me ekstreme*”. (Aristoteli, 2001:149). Në vitin 1690, Xhon Loku shkroi dy Traktate për qeverisjen. Teoritë politike të tij janë përfshirë në thelbin e demokracive perëndimore. Shumë ide ndikuan në revolucionet në Amerikë dhe Francë, në shekullin e ‘XVIII. Sipas tij, “*njerëzit janë krijuar të barabartë, duke mos e ngatërruar gjendjen natyrore të njeriut me gjendjen e luftës*”. (Wliam Reaper, Linda Smith, 1999:89). Për Lokun, baza e qeverisjes është ligji, jo forca. Ligjet bëhen nga përfaqësuesit e popullit, në emër të popullit dhe qytetarët kanë “*të drejta*” të imunizuara prej ndërhyrjes së qeverisë. Ky mendim u pasqyrua në Ligjin e të Drejtave në Kushtetutën Amerikane.

Statuti i OKB përfshiu të drejtat e njeriut në jetën ndërkombëtare, pjesë integrale e veprimtarisë, të frymëzuar drejt një Preambule të pranuar: “*Ne popujt e Kombeve të Bashkuara, të vendosur... për të shpallur edhe njëherë besimin tonë në të drejtat themelore të njeriut, në dinjitetin dhe në vlerën e personit njerëzor, në barazinë e të drejtave të burrave dhe të grave ... kemi vendosur të bashkojmë forcat tona për realizimin e këtyre qëllimeve*”. (<https://www.ohchr.org/sites/default/files/UDHR/Documents,1948:1>). Megjithatë, ky statut nuk ofronte mbrojtje të mjaftueshme të të Drejtave të Njeriut. Nevojitej qëndrimi unik, ikonkretizuar në daljen dhe miratimin e Deklaratës Universale të Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut. Ajo i specifikonte këto të drejta dhe shtjellonte elementet përbërës, duke u kthyer në detyrim global për jetën demokratike të njerëzimit.

- **Krijimi:** Teksti i Deklaratës u realizua në vitin 1946. E drejta e formulimit iu dha Komisionit mbi të Drejtat e Njeriut, të kryesuar nga Eleanor Roosevelt, avokate e njohur e të drejtave të njeriut. Për një kohë dy vjetare në përbërje u përfshinë “18 anëtarë të nacionaliteteve dhe përkatësive politike të ndryshme”. (<https://sq.wikipedia.org/wiki>). Struktura e saj u frymëzua nga Kodi Napoleonik, duke përfshirë Preambulën dhe hyrjen, ku shpalosen parimet e përgjithshme të Deklaratës. Artikujt 1 dhe 2, u vlerësuan si themeli i Deklaratës, të cilat parashtronin “parimet e dinjitetit, lirisë, barazisë dhe vllazërisë”. (<https://sq.wikipedia.org/wiki>).

Pas “luftës së ftohtë”, në jetën politike planetare u përfshinë në analizën doktrinare elemente të “Përplasjes së Qytetërimeve dhe nevojën e Ribërjes së Rendit Botëror”. Presidenti Bush e përcaktoi nevojën e forcimit të mbrojtjes së të drejtave njerëzore si, “forcim të demokracisë”. (Huntington Samuel, 2004:310). Pas vitit 1992, kjo u bë përparësi për administratën Clinton. Kundërshtimet erdhën nga vendet komuniste dhe muslimane, kryesisht aziatike. “Dora e Perëndimit mbi Lindjen dhe Azinë Juglindore, është shkurtuar mjaft”. (Huntington Samuel, 2004:310). Dallimet mes demokracisë perëndimore dhe Lindjes, “u shprehën qartë në Konferencën e OKB për të Drejtat e Njeriut në Vjenë, në qershor 1993”. (Huntington Samuel, 2004:314). Si rrjedhojë, “përveç një miratimi të fortë për të drejtat e grave, deklarata e miratuar nga konferenca ishte vetëm diçka minimale...kontradiktore dhe me të meta”. Deklarata e Vjenës nuk përmbante, “asnjë pohim të shprehur për të drejtat e liritë e fjalës, të shtypit, të mbledhjes dhe të besimit fetar, duke dalë kështu nga shumë anë më e dobët se Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, që OKB miratoi më 1948”. (Huntington Samuel, 2004:316). Kundërshtimi i Kinës dhe vendeve të tjera komuniste, i shumë vendeve me popullsi muslimane, “ishte i paprecedentë dhe do të përcaktonte politikën e re ndërkombëtare për të drejtat e njeriut”. (Huntington Samuel, 2004:316)

Duke vlerësuar thelbin e Deklaratës Universale, rëndësia teorike dhe praktike e studimit mbi të Drejtat e Njeriut në Shqipërinë postkomuniste, nuk ka të bëjë vetëm me paraqitjen e situatës në trajtimin teorik. Ballafaqimi me problemet që hasin qytetarët përballëligjit, shtetit dhe institucioneveshtetërore e private, pengesat, zvarritjet, diskriminimi social e juridik, janë një situatë reale. Njerëzit përballëdrejtësisë dhe ligjit, nuk sigurojnëshërbimin e nevojshëm juridik. Një arsye më shumë për mungesën e besimit ndaj institucioneve, duke ndikuar negativisht në ndërveprimin social dhe politik të shoqërisë. Përballë institucioneve shtetërore e private, qytetarët përballen me refuzimin, diskriminimin, mosplotësimin e nevojave, duke provuar ecejake pa zgjidhje. Burokracia raskapitëseështë tregues real i mosrespektimit të të drejtave njerëzore.

6. Struktura e Punimit

Abstrakt	15
Hyrje	19K

KAPITULLI I

I. Lidhja historike e të drejtave të njeriut me kohën modern	29
I.1. Drejtësia mbështetet në barazinë para Ligjit.....	30
I.2. Institucionalizimi dhe mbrojtja ligjore e të drejtave të Njeriut.....	32
I.3. Drejtësia, baza morale e juridike për mbrojtjen e të drejtave njerëzore.....	36
I.4. Roli i sigurisë kombëtare në mbrojtjen e të drejtave njerëzore.....	43

KAPITULLI II

II. Të drejtat e njeriut në mjedisin social-politik shqiptar	48
II.1. Koncepti filozofik dhe psiko-social i mbrojtjes së të drejtave të njeriut.....	48
II.2. Të drejtat njerëzore, individi, edukimi dhe pritshmëritë.....	50
II.3. Pandemia dhe të drejtat e njeriut sipas Konventës Evropiane.....	52

II.4. Të drejtat e njeriut në Shqipëri, përballë situatës së Covid-19.....	55
--	----

KAPITULLI III

Mbrojtja e të drejtave të njeriut në mjedisin social-politik shqiptar.....	64
III.1. Ndryshimet kushtetuese dhe ndikimet psikologjike në Shqipërinë postkomuniste.....	65
III.2. Institucioni i Avokatit të Popullit, risitë e reja të përballjes me drejtësinë.....	68
III.3. Raportet me sistemin e drejtësisë për mbrojtjen e të drejtave njerëzore.....	74

KAPITULLI IV

III. Respektimi i Lirive dhe të Drejtave Civile.....	80
IV.1. Dukuritë negative, të dhunës ndaj të drejtave njerëzore.....	80
IV.2. Mediat dhe opinioni publik në mbrojtjen e të drejtave të njeriut.....	85
IV.3. Vlera e dobishme të lirisë së shprehjes, publikimit dhe informacionit.....	88
Përfundime.....	90
Referenca.....	92

ABSTRAKT

Njeriu është i lirë të zgjedhë mënyrën e jetesës në marrëdhënie me shtetin, ligjin, pronën dhe mjedisin shoqëror. Liria dhe të drejtat kanë çmim të lartë në njohjen, respektimin apo dhunimin e tyre. Qëndrimet antihumane çojnë në diskriminim etnik, racor, etno-kulturor, në barrierë kufizuese kundër vlerave të jetës. Tendencat humanitare kundër pabarazisë shoqërore dhe disnivelit ekonomik, janë parakushti i shmangies së konfliktit midis njeriut dhe difekteve të mjedisit politiko-shoqëror dhe juridik, në raport me të drejtën, ligjin, shtetin, dhunën psiko-fizike.

Studimi, *“Njohja dhe respektimi i të Drejtave të Njeriut në Shqipërinë postkomuniste”*, shpreh thelbin e situatës së mbrojtjes së të drejtave njerëzore në një sistem kushtetues dhe juridik në formim e sipër. Analiza mbështetet mbi fenomenet e jetës së përditëshme të individit dhe shtresave sociale, të fenomeneve dhe ngjarjeve specifike që lëkundin raportet mes shtetit, sistemit të drejtësisë dhe marrëdhënieve me qytetarin. Fenomenet sociale dhe juridike meritojnë përkujdesjen e institucioneve dhe strukturës së Shoqërisë Civile, për më shumë vëzhgime, studime, rekomandime, ndërhyrje ligjore, denoncime, duke përmirësuar bazën juridike sipas standardeve të OKB, Organizatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Shteti dhe shoqëria shqiptare në 32 vjet kanë ndërtuar marrëdhënie me jetën ndërkombëtare, duke synuar ndërtimin e demokracisë funksionale, duke reflektuar nëpërmirësimin e psikologjisë ndikime nga e kaluara. Ato bëjnë përpjekje për hapësira më të mëdha në respektimin e vlerave të jetës së njeriut. Mbështetja në përvojën perëndimore, rritja e vlerave të demokracisë, serioziteti për politikbërje të mira, respektimi i pavarësisë së institucioneve kushtetuese, e bën shtetin dhe shoqërinë, *“të jenë përgjegjëse ndaj publikut”*. (Piers Robinson, 2012:212). Shqipëria postkomuniste ende vazhdon të përballet me nevojën e thellimit të reformave në sistemin politik dhe shoqëror, veçanërisht në fushën e drejtësisë, për të krijuar klimën e shëndetshme ligjore e sociale në harmoni me njera-tjetrën.

Baza juridike dhe kodi moral i shoqërisë, drejtohen kundër abuzimeve me të drejtën njerëzore dhe ligjin, për respektimin e të drejtave të njeriut në Republikën e Shqipërisë. Brenda sistemit të drejtësisë probleme, ndërhyrja ndërkombëtare ende merr çmim të lartë, përballë ngadalsimit

tëreformave për shkaqe të brendshme politike dhe sociale. Njohja e praktikave ndërkombëtare dhe forcimi i lidhjeve juridike, është vlerësuar si parakushti kryesor për arritjen e standardizimit të politikave ligjzbatuese në rritjen e nivelit të jetësës dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Ndikimi i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (*OSBE*) përmes raport–progresit të përvitshëm, mundëson transparencën ndaj detyrimeve që ka sistemi i drejtësisë në raport me qytetarin në Republikën e Shqipërisë.

Periudha e tranzicionit është mbështetur nga paketa ligjore dhe nënligjore në harmonizimin e të drejtës njerëzore me sistemin e drejtësisë, të dobishëm për qytetarin dhe shtetin, mbështetur në të drejtën juridike penale, civile, administrative, përballë fenomeneve negative me luhatje në rritjen apo kufizimin e tyre. Përballja e qytetarit me sistemin e drejtësisë për abuzimet me të drejtën e tyre, më së shumti janë reflektuar në fenomene tipike të kriminalitetit si, dhuna mbi gratë dhe fëmijët, abuzimet seksuale, tentativat për vrasje, grabitja e pronës, presionet psikologjike, ndotja akustike dhe vizive, mitmarrja, mungesat zgjidhjeve ligjore, kushtet në mjediset e ndalimit, sigurisë dhe të vuajtjes së dënimit, të cilat në një sfond të përbashkët të analizës, sjellin një sistem ende të pastabilizuar dhe me mjaftë mungesa ligjore e logjistike.

Situata në Shqipërinë postkomuniste evidenton një kontradiktë themelore, e cila shfaqet midis sistemit të një drejtësie në reformim, institucioneve që mbrojnë të drejtën qytetare dhe krizës së besimit ndaj superstrukturës shtetërore. Korrupsioni në drejtësi, zvarritja e vendimeve gjyqësore, pamundësia e avokatisë së pavarur, thellojnë problemet në mbrojtjen e të drejtave njerëzore. Abuzimi me ligjin, keqpërdorimi i institucioneve në raport me të drejtën juridike vendore dhe ndërkombëtare, janë disa drejtime specifike të studimit.

Analiza dhe ballafaqimi me situatën sjellin mundësi për qasje të reja me vlera përmirësimi. Për këtë arsye, hulumtimi merr njëkohësisht karakterin e denoncimit, mbështetur mbi argumente dhe fakte. Duke shfrytëzuar literaturën, ballafaqimin me problemet e Progres Raporteve vjetore të Institucioneve Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut dhe Avokatit të Popullit, studimi evidenton sfidën para qytetarëve, pushtetit politik dhe shtetit.

Të qenit i lirë me të drejta të garantuara, sot përbën privilegj për çdo njeri që jeton me shpresën e respektimit të vetëvetes dhe normave etiko-morale, brenda sistemit të vlerave të formuara në periudhën e demokracisë. Të qenit i lirë me të drejta të garantuara, është rrëzimi i mureve në vetëdijen e njerëzve, kundër ndikimeve nga e kaluara, kundër presionit psikologjik dhe ndikimit

ideologjik e social të sistemit komunist, i cili vazhdon ende sot të tërheqë pas me forcë politikën, institucionet ligjvënëse-ligjzbatuese, duke krijuar situatën e pakëndëshme në jetën social-politike dhe ekonomike të popullit.

ABSTRACT

Human is free to choose his way of life in relation to the state, law, property and the social environment. Freedom and rights are highly valued in their recognition, respect or violation. Antihuman attitudes lead to ethnic, racial, ethno-cultural discrimination, to limiting barriers against the values of life. Humanitarian tendencies against social inequality and economic inequality are a precondition for avoiding conflict between man and the defects of the socio-political and legal environment, in relation to law, state, psycho-physical violence.

The study, "Recognition and respect for human rights in post-communist Albania", expresses the essence of the situation of protection of human rights in a constitutional and legal system under implementation. The analysis is based on the phenomena of the daily life of the individual and social strata, of specific phenomena and events that shake the relations between the state, the justice system and the relations with the citizen. Social and legal phenomena deserve the attention of institutions and structure of Civil Society, for more observations, studies, recommendations, legal interventions, denunciations, improving the legal basis according to UN standards, the European Organization of Human Rights and the Constitution of the Republic of Albania .

The state and the albanian society in 32 years have built relations with international arena, aiming at building a functioning democracy, reflecting on the improvement of psychology with influences from the past. They strive for greater space in respecting the values of human life. Relying on the Western experience, the rise of the values of democracy, the seriousness of good policy-making, respect for the independence of constitutional institutions, makes the state and society accountable to the public. Post-communist Albania still faces the need to deepen reforms in the political and social system, especially in the field of justice, to create a healthy legal and social climate in harmony with each other. The legal basis and the moral code of the society are directed against the abuses with human rights and the law, for the respect of human rights in the Republic of Albania. Within the troubled justice system, international intervention still comes at a

high price, in the face of slowing down reforms for internal political and social reasons. Recognition of international practices and strengthening of legal ties is considered as the main precondition for achieving the standardization of law enforcement policies in raising the standard of living and protection of fundamental human rights and freedoms. The influence of the Organization for Security and Co-operation in Europe (OSCE) through the annual progress report, enables transparency towards the obligations of the justice system in relation to the citizen in the Republic of Albania.

The transition period is supported by legal and sub-legal packages in the harmonization of human rights with the justice system, beneficial to the citizen and the state, based on civil and administrative Court of law, in the face of negative phenomena with fluctuations in their increase or limit. Citizens' confrontation with the justice system for abuses of their rights are mostly reflected in typical criminal phenomena such as violence against women and children, sexual abuse, attempted murder, robbery of property, psychological pressure, noise pollution and bribery, lack of legal solutions, conditions in detention facilities, security and sentencing, which in a common background of analysis, bring a system still unstable with legal and logistical shortcomings.

The situation in post-communist Albania highlights a fundamental contradiction, which appears between the reforming justice system, the institutions that protect civil rights and the crisis of confidence in the state superstructure. Corruption in the judiciary, procrastination of court decisions, impossibility of independent advocacy, deepen the problems in the protection of human rights. Abuse of the law, misuse of institutions in relation to domestic and international legal law, are some specific areas of study. Analyzing and dealing with the situation brings opportunities for new approaches with improvement values. For this reason, the research simultaneously takes on the character of a denunciation, based on arguments and facts. Utilizing the literature, dealing with the problems of the Annual Progress Reports of the International Human Rights Institutions and the People's Advocate, the study highlights the challenge before the citizens, the political power and the state.

Being free with guaranteed rights, today is a privilege for every person who lives with the hope of self-respect and ethical-moral norms, within the system of values formed in the period of democracy. Being free with guaranteed rights, is the fall of the walls in the consciousness of the

people, against the influences from the past, against the psychological pressure and the ideological and social influence of the communist system, which still continues to forcefully pull back the politics, the legislative-law enforcement institutions, creating the situation of unpleasant in the socio-political and economic life of the people.

Hyrje

Hulumtimi mbështetet në analizën e ngjarjeve dhe fakteve që dhunojnë të drejtat njerëzore në Shqipërinë postkomuniste, me objekt kundër padrejtësive morale, etike, sociale, ekonomike, juridike, në mbrojtje të interesave të individit dhe shoqërisë, të të drejtave shtetërore, të trajtuara në planin kombëtar. Analiza mbështet shmangien e ndikimeve nga e kaluara, kundër presionit psikologjik dhe ndikimit ideologjik e social të sistemit komunist, i cili ende ndikon mbi politikën, institucionet ligjvënëse e ligjzbatuese, duke krijuar situata të pakëndshme në jetën social-politike dhe ekonomike të popullit.

Karakteri i kufizuar historik i hulumtimit, ka të bëjë me ndikimin e trashëgimisë ligjore të sistemit komunist. Ajo në vitet e para të demokracisë, shkaktoj kaotik duke kufizuar perspektivën e një jetë tëshëndetshme të shoqërisë demokratike në zhvillim. Sistemi komunist e ndërtoi drejtësinë mbi ligje kushtetuese dhe institucione të forta, të patolerueshme, të cilat zhvilloheshin nën frymën e ideologjisë dhe të demokracisë popullore. Në mungesë të avokatisë, drejtësia mbi qytetarin ishte tërësisht e rrezikuar. Legjislacioni që përfshinte ndëshkimet për agjitacion e propagandë dhe internimet, ishin pjesa më e egër, e cila për shkak të mungesës së lirisë të ndërgjegjes, persekutoi dhe ndëshkoi me dënime ekstreme mjaftë figura publike e njerëz të thjeshtë.

Në kushtetutën e Shqipërisë komuniste të vitit 1976, drejtimi totalitar i shtetit ndihej i sigurtë në atë fazë zhvillimi për të faktorizuar praktikën ligjore në forcimin dhe mbajtjen e pushtetit, sipas filozofisë që buronte nga ideologjia e sistemit politik. Liritë dhe të drejtat e njeriut kushtëzoheshin nga sistemi. Për këtë shkak, gjatë 30 vjetëve në demokraci, jeta publike e ka pasur të nevojshme *“pranimin e një historie të balancuar”*, ku periudha komuniste të merrte pamjen reale. Ky veprim siguroi në një farë mase ekuilibrin social dhe politik të Shqipërisë postkomuniste. Tema delikate si: *“mohimi i të drejtave të njeriut, represioni, sistemi i burgjeve, kampet e internimit dhe të punës*

së detyruar, u bënë objekt i studimeve historike. Ato kanë të bëjnë me ruajtjen e kujtesës historike, për ndriçimin e historisë për brezat e ardhshëm". (Beqir Meta, Ermal Frashëri, 2018:7)

Në arkivat e MB deri në vitin 1990, figurojnë deri 25 mijë të burgosur politikë, të cilat sipas studjuesve pretendohet se janë më të mëdha. (30-34 mijë). Raporti i vitit 2016 të ISKK publikon *"deri në 26.768 burra dhe 7.367 gra; të vdekur në burgje 984 dhe 308 të tjerë me humbje të aftësive mendore. Rreth 5.577 burra dhe 450 gra vuajtën dënimin me vdekje"*. (Beqir Meta, Ermal Frashëri, 2018:29). Objekti politik i regjimit komunist ishte, *"Eliminimi i kundërshtarëve, gjyqet politike, sistemi i burgjeve dhe internimeve, si pjesë e mekanizmit shtetëror për të frikësuar, nënshtruar dhe kontrolluar shoqërinë"*. (Beqir Meta, Ermal Frashëri, 2018:9).

Objekti i dytë lidhej me, *"eliminimin apo neutralizimin e të gjithë atyre, të cilët ishin pengesë për planet e tashme dhe të ardhme të shtetit komunist, pra kundërshtarët politikë"*. (Beqir Meta, Ermal Frashëri, 2018:11). Në vitin 1979 u vendos masa e dënimit me internim *"për fëmijët mbi moshën 14 vjeç"*. (Beqir Meta, Ermal Frashëri, 2018:20). Sipas raportit të vitit 2016 të ISKK, *"në periudhën 1944-1990 të internuarit ishin 59. 009"*. (Cituar nga Beqir Meta, Ermal Frashëri, 2018:20).

Në sjelljen e situatës në kohë, nuk mund tëpretendohet arritja e gjithçkaje, vetëm nëpërmjet një studimi. Në thelb kjo është një nga çështjet kryesore të jetës, për të argumentuar të dhënat që ofron reflektimi i plotë dhe vlerësimi realist i filozofisë bazë të veprimit dhe efekteve të mbrojtjes së të drejtave njerëzore në jetën e individit dhe të shoqërisë.

Lirisë dhe të drejtave njerëzore u jepet virtyti dhe morali, duke i shndërruar ato në forcë të madhe të dobishme për ndryshim. Deformimet në praktikë i kanë dhënë lirisë koncept të kufizuar, por vështirë të gjenden individë që të mos pëlqejnë ekzistencën në liri. Të lirë duan të jenë fëmijët, të cilët ndihen të pakënaqur nga kufizimet e prindërve; nxënësit dhe studentët që bien në konflikt me moralin e mjedisit; femrat dhe meshkujt; klerikët, laikët, ateistët, politikanët, profesionistët, por lirinë e duan dhe diktatorët, demokratët, anarkistët, pacifistët, globalistët në interes të jetës dhe pikpamjeve të tyre. Të gjithë e duan në mënyrën e tyre dhe mundohen ta gjejnë atë.

Dëshira e pamatë njerëzore kërkon të dijë, çfarë është liria në vetëvete; si mund të kuptohet shprehja, *"të jesh i lirë"* apo *"të ndjehesh i lirë"*; cili është kufiri midis lirisë tënde dhe dhunimit të lirisë së tjetrit; cilat janë momentet në jetën e njeriut që ai dëshiron të jetë më shumë i lirë; në cilat raste liria personale dhunon lirinë e tjetrit dhe e kundërta; a duhet të mendojmë se ka një masë universale dhe absolute në jetë për të vlerësuar lirinë, apo ajo është koncept relativ, që

ndryshon sipas situatës, vendit, moshës, seksit, botëkuptimit fetar, politik etj. Kundërshtia mbart brenda pjesën progresiste, sepse mendimi logjik sot kërkon modelin më të dobishëm, kundër krizës që ekziston në sigurimin e lirisë dhe të drejtave praktike për njeriun.

***Në konceptin filozofik** “Shopenhaueri hedh dritë tek ai dallim që ekziston midis lirisë për të dëshiruar dhe lirisë për të vepruar. Liria për të vepruar është aftësia për të bërë diçka, nëse njeriu ka dëshirë ta bëjë. Kjo liri mund të frenohet nga pengesat e jashtme për të vepruar, nga ndrydhja e motiveve, ligjet apo kërcënimet me pasoja të ndryshme, nëse njeriu kryen një veprim të caktuar, apo nga dëmtimi i aftësive njohëse të subjektit. P.sh. të qenit në burg, të qenit nën kërcënimin e armëve apo dëmtimet e trurit, janë që të gjitha forma të mungesës së lirisë, të cilat e pengojnë njeriun të bëjë atë që do. Sipas kësaj, liria renditet në fizike, morale dhe intelektuale, si tre llojet e lirisë së veprimit”. (Arthur Schopenhauer, 2005:139).*

Ndoshta kjo është arsyeja që mendimi më i saktë në interes të vlerave të Lirive dhe të Drejtave Themelore të Njeriut, duhet të orientohet drejt të drejtave individuale dhe kolektive, duke arritur sundimin e pozitivitetit në realitetin shqiptar. Nënveftësimi i këtij kapitulli të jetës shqiptare, përbën kërcënimin e drejtëpërdrejtë për sigurinë publike dhe kombëtare. Në këtë analizë dhe afër realitetit shqiptar, jemi pranë konstatimeve, duke gjykuar me aftësi mbi qëndrimin intelektual, profesional, juridik dhe shoqëror. Rrëzimi i mureve psikologjik dhe pengesave që dhunojnë të drejtat njerëzore, që nxisin diskriminimin e individit, janë detyrim akademik, universitar, i njerëzve të studimit shkencor, për rregullat e një jetë të shëndetshme në liri.

Baza e ndërtimit dhe përmbajtjes së filozofisë së strukturës juridike kushtetuese dhe të drejtësisë, sot duhet të mbështetet në shqetësimet madhore, që shfaqen në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, larg kompromisit politik, injorues, pa vlera. Veçoria karakteristike bazohet në ekzistencën e ideve dhe gjenerimin e tyre në vazhdimësi, për të shmangur shterpësinë që karakterizon përpjekjet e institucioneve shqiptare në 30 vjet të ndryshimeve demokratike. Shmangia e elementeve demokratikë të reformave, duke i kthyer qëllim në vetëvete, me motive politike, sipas grupeve të interesit dhe nënshtresave sociale, kufizimet e kontaktit me organe ndërkombëtare, e kanë bërë mosbesues dhe skeptik opinionin shqiptar.

Sot baza ligjore e juridike e ndërhyrjeve, mbështetet në të drejtën ndërkombëtare, aktet ligjore e nënligjore, të cilat janë gjithpërfshirëse dhe unifikuese, mbështetur në Konventat Ndërkombëtare dhe institucionet më të rëndësishme vendimmarrëse në botë. Në këtë hapësirë të gjerë duhet të pranohet si çështje kryesore e jetës, për të argumentuar të dhënat që ofron reflektimi i plotë dhe vlerësimi praktik i filozofisë bazë të veprimit dhe efekteve të mbrojtjes së të drejtave njerëzore për

individin dhe shoqërinë. Kjo është arsyeja që mendimi më i saktë në vlerat e Lirive dhe të Drejtave Themelore të Njeriut, përfshin vlerat individuale e kolektive në mjedisin shqiptar.

Shqyrtimi i literaturës. Informacioni nga literatura studimore mbi çështjet teorike, metodike dhe teknike të akteve ligjore, nënligjore, administrative, trajtohet në mënyrë specifike nga përzgjedhja, ballafaquar me elementet pozitiv të dimensionit human të mbrojtjes së të drejtave të qytetarit. Bota dixhitale sjellëmundësi që qytetarët të shfrytëzojnë literaturën dhe përvojat, pa rekomandime, duke bërë ballfaqimin me to. Situata në studim ështëqasje konkrete e mjedisit juridik shqiptar, ballafaquar me Kushtetutën, Drejtësinë, Avokatin e Popullit, dokumentet themelore ndërkombëtare, prej të cilave burojnë aktet juridike të mbrojtjes së të drejtave njerëzore. Problematik e gjerëdetyron institucionet dhe individët, të hulumtojnë literaturë të mjaftueshme kombëtare e ndërkombëtare, duke plotësuar kuadrin e plotë të ndërtimit të sistemit të vlerave në shërbim të pages, humanizmit dhe lirisë së individit.

Duke qenë pranëproblemeve të mjedisit shqiptar, kontakteve me elementet veprues të drejtësisë, sipas burimeve tëliteraturës, studimi ndihet afër realitetit të brishtë në Shqipërinë postkomuniste. Ndikimi profesional kushtëzohet nga burimet dhe praktika, duke sjellë të dhëna interesante nga literatura e hershme dhe bashkëkohore, pa anashkaluar përvojën e institucioneve shqiptare.Në literaturën mbështetëse, mbahet parasysh përvoja e vendeve perëndimore dhe asaj amerikane, e cila me studime të shumta psikologjike dhe sociologjike, ka sjellë përvoja të prekshme, praktike, me përmbajtje të thjeshtë. Prej tyre gjenden hapësira përpunimi dhe veprimi në harmoni me kërkesat dhe kriteret e mjedisit shqiptar. Literatura e specifikuar juridike brenda kontekstit të integritetit të sistemit të drejtësisë me standardet bashkëkohore, diktuar nga nevoja e antarësimit në BE, kërkojnë një qasje të re, mbi idenë e integritetit dhe kërkesave tëmbrojtjes së të drejtave, në kushtedhe rrethana politike dhe sociale, që prishin pengesat e psikologjisë së kaluar. Kjo dikton studimin psikologjik dhe juridik në nënshtresat e tij, duke rritur dobinë dhe cilësinëjuridike për mbrojtjen e të drejtave të tyre.

Përzgjedhja i kushton vëmendje kategorizimit juridik dhe psikik të fenomeneve me ndikim në rritjen e dhunës ndaj të drejtës njerëzore, në ballafaqim me standardet bashkëkohore. Mekanizmat emocionale me ngarkesa negative tek qytetarëtdhe shtresat sociale, gjinitë, moshat, për shkak të mospërballimit të pasojave të dhunimit të të drejtave njerëzore, gjejnë pasqyrim të mjaftueshëm. Ato sjellin ndjesinë e kundërshtimit, mospranimit dhe përballjes së individit, me justifikimet e institucioneve përgjegjëse, të cilat duhet tëgarantojnëligjërisht të drejtat njerëzore.

Literatura juridike mbi trajtimin ligjor të të drejtave njerëzore sjellë vlerat e paradigmës së modelit të kërkimit shkencor, mbi një realitet tëballafaquar dhe të dobishëm. Rekomandimet modeste që burojnë nga literatura, në zbatimin e kërkesave të Deklaratës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, ndryshimeve nga përvoja pozitive dhe negative e institucioneve shqiptare, mundësojnë qasje të reja, të cilat mund të ndikojnë në mënyrë racionale në përmirësimin juridik për mbrojtjen e të drejtave të individit. Ato sjellin përvoja interesante për përsosjen e akteve ligjore dhe nënligjore, përshtatjen në mënyrë të përafërt në jetën shqiptare. Veçimi i vlerave të përvojës sëjashtme dhe përvojës shqiptare, janë arritje dhe shtysa për ndryshime.

Struktura e punimit. Prania e kapitujve të veçantë në këtë çështje, hapësirat boshe që krijohen në zbatimin e tyre, sjellin interesimin, seriozitetin dhe përgjegjësinë e institucioneve ligjzbatuese shtetërore, të cilat duhet t'i bëjnë ato fakt në jetën qytetare, në sigurimin e të drejtave mbi jetën, pronën, punën, nën mbrojtjen juridike prej shkelësve të ligjit dhe të të drejtave njerëzore. Aprovimi i ligjeve të posaçme që normojnëveprimtarinë e institucioneve të të drejtave dhe lirive të njeriut, reformimi i strukturave të drejtësisë dhe rendit publik, harmonizimi i dobive tëdemokracisë, janë disa sfida, të cilat i janë nënshtuar proceseve të transformimit. Veprimi “*në injorancë*” dhe veprimi “*nga injoranca*”, (Aristoteli, 2001:77), kanë shkaktuar hera-herës lëkundje të sistemit shoqëror dhe drejtësisë, duke frenuar ndryshimin. Parashtrimi në material i disa tipologjive të reja të formave të shfaqjes dhe reflektimit të shkeljeve mbi të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të cilat denoncojnëkorrupsionin e sistemit të Drejtësisë, të organit të akuzës, gjykatave, avokatisë, Avokatit të Popullit, apo rolit të asfiksuar të sindikalizmit dhe Shoqërisë Civile, janë momente të shoqëruara me statistika dhe shembuj, duke shfaqur anën e errët të padukëshme të shkelësve të ligjit në Republikën e Shqipërisë. Ballafaqimi me situatën sipas të dhënave tëbrendshme, të përfshira në Progres Raportet e Institucioneve Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut dhe të Avokatit të Popullit, janë pika e nxehtë e analizës studimore, e cila më shumë se sa trajtimi teorik, plotëson praktikën hulumtuese të studimit.

Në kapitullin hyrës, parashtrohen konceptet bazë nga burojnë barrierat që pengojnë zgjerimin e dimensionit social për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të individit. Përvojat janë të shumta. Në kapitullin me karakter historik, orientohemi në njohjen e burimeve të shkeljes së të drejtave, sillen disa qasje të reja të zhvillimit, me dukuri të reja të përvuara më parë. Mënyra e trajtimit tëpengesave nxit metodologjinë analitike dhe krahasuese, mbështetur në të dhënat e siguruar të deklaratave publike, raporteve të institucioneve, në interes të hipotezës kryesore në studim.

Pavarësisht opinionit të përgjithshëm mbi diversitetin midis shtetit, ligjit, strukturave juridike dhe individit, burimet historike vijnë me natyrë tjetër në zgjidhjen e problemeve. Në disa raste ato kanë ushqyer ekstreme si rrjedhojë e tradicionalizmit dhe në kundërshtim me ligjin. Një arsye më shumë, për analizën mbi shkaqet e thella kanunore, të cilat nuk përjashtojnë karakterin politik, religjioz dhe social, me ndikim kulturor, ekonomik, fetar, me tradita të nënshtruara prej proceseve të ndryshimit dhe ballafaqimit në kohën moderne. Konstatimet mbi pasojat mbi individë dhe familje të tëra, në disa raste marrin karakter tronditës në kufijtë jetik, për një popull të vogël siç është popullsia shqiptare, sepse “*drejtësia e veçantë ushtrohet midis grupeve që kanë ndershmëri (marrëdhënie) normale njerëzore*”. (Aristoteli, 2001:154). Vlerat metodike për gjetjen e rrugëve për kapërcimin e ndasive të tradicionalizmit, vazhdojnë si objekt studimi i praktikave për përsosjen e metodologjisë së zbatuar, për rritjen e dobisë së reformave në sistemin e drejtësisë, të emancipimit shoqëror, nivelit të edukimit me vlerat e standardeve të demokracisë dhe shtetit të qytetarit. Ato janë baza e integritetit shoqëror të qytetarëve të rinj, me mendësi të reja dhe ide progresiste. Rekomandimet ***në kapitullin hyrës të hulumtimit***, nxisin veprimtarinë e institucioneve bazë të shoqërisë, për përfshirjen shumëdimensionale në mbrojtje të të drejtave njerëzore, duke vlerësuar elementet objektive dhe subjektive, si shkak për asfiksionin e energjive pozitive të mendimit dhe qëndrimit qytetar. Ato i kundërvihen tendencave të frenimit, të imponuar nga struktura të përfshira në korrupsion, veçanërisht institucionet ligjzbatuese dhe publike kundër të drejtave njerëzore. Tranzicioni nuk mundi të minimizojë negativitetet e kohës dhe të mentalitetit të sistemit të mbyllur komunist, duke lejuar abuzimet mbi të drejtën e pronës, tjetërsimeve, diskriminimit social. Ato u shfaqën si parakusht për të merituar një sistem drejtësie të korrumpuar, deri antikombëtar. Ende politik nuk ka kuptuar thelbin e “*revolucionit politik, të revolucionit ekonomik dhe të revolucionit në komunikim*” (G. Feltham, Ralph, 2010:13), që kanë përfshirë botën dhe shoqërinë shqiptare, duke mbetur peng të ndikimeve të sistemit komunist. Trajtesa merr natyrë delikate mbi jetën social-politike, ekonomike dhe juridike shqiptare, e mbështetur në metodologjinë klasifikuese me tipologji ndryshe. Kjo hap kapitull interesant për studime të thelluara në të ardhmen. Tema që trajtohet në punimin studimor, merr karakter të rëndësishëm dhe aktual. Mbështetur në analizën konkrete, përfundimet përgjithësuese, e bëjnë atë specifik. Sjellja thjeshtë dhe qartë, jep thelbin e vlerave të dokumenteve ndërkombëtare, si ndihmesë konstruktive kundër interpretimeve anësore, duke orientuar drejt analizës në ballafaqim me dukuritë dhe fenomenet shqiptare.

Në kapitullin e dytë të hulumtimit, në mënyrë të detajuar është ofruar lehtësia për t’u kuptuar problemin. Ajo është sjellë në trajtimin teoriko-praktik me bazë filozofike, psikologjike dhe

juridike sipas ndikimit mbi legjislacionin fundamental të shtetit shqiptar, për të kuptuar më mirë aktet juridike që burojnë nga Kushtetuta. Edhe pse formalisht dokumentacioni është i arrirë, praktikisht ai nuk garanton mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Shqipëri. Si fenomen specifik i rëndësishëm, mbrojtja e të drejtave të njeriut merr dimension të gjerë, duke ndikuar në harmonizimin e jetës, si elemente tësigurisë dhe sovranitetit të shtetit. Një nevojë jetike, që sot nxit urinë e opinionit për drejtësi. Në material vlerësohet fakti i fenomeneve dhe dukurive negative mbi të drejtat njerëzore, të cilat nuk janë kufizuar vetëm brenda kuadrit juridik shtetëror, por janë parë me ndikimin në jetën sociale, tradicionale, etno-kulturore, të lidhura me sigurinë publike dhe kombëtare, të kushtëzuara nga detyrimet që Shqipëria si vend antar i NATO-s dhe antarsimin në BE. Si hapësirë e gjerë veprimi, detyrimet në të gjithëformat tentojnë të godasin korrupsionin, diskriminimin dhe kriminalizimin, si parakushte të thellimit të refomave nëjetën shqiptare. Kushtëzimet kanë dhënë mundësinë e trajtimit ***në kapitullin e tretë të studimit***, të disa elementeve specifik të reflektimeve, duke rritur natyrën studimore sipas disa përvojavendërkombëtare. Ballafaqimi me përvojën ndërkombëtare nëmbrojtjen e të drejtave njerëzore në mjedisin shqiptar, shfaqet si qëndrim kritik ndaj institucioneve shtetërore, të cilat kanë humbur orientimin mbi thelbin e dobisë që ka mbrojtja e të drejtave njerëzore për shtyllat bazë të demokracisë. Sipas konceptit të Aristotelit, “*është më keq të kryesh se sa të vuash padrejtësinë*”. (Aristoteli, 2001:158). Vizioni mbi koncepte filozofike sjellëdisa përfundime, që i japin përgjigje pyetjes kryesore sociologjike, mbështetur në elementet postmoderne, lidhjeve tëindividëve në komunitet, pranisësë diversitetit juridik dhe kulturor, të rrugëve të mundëshme të kapërcimit të pengesave dhe pranimin e qasjeve të reja përmes përmirësimit të sistemit të drejtësisë dhe edukimit qytetar. Analiza ballafaquese me fenomenet reale, japin tablonë mbi mbrojtjen e të drejtave të grave, fëmijëve, kundër trafikimit, shkeljes së të drejtave në paraburgim, të drejtën e informacionit, si elemente specifik, në harmoni dhe ballafaqim me Avokatin e Popullit, e cila rezulton si përvojë formale dhe me pak vlera në Shqipëri. Situara rrok tendencën drejt steriotipit të institucionit, ligjit dhe individit, në dezëharmoni me njeri-tjetrin, me veçoritë sjelljes dhe kulturës në mjedis me shumë probleme, duke shkarkuar ndikime të rënda psikologjike mbi individin dhe shoqërinë. Këndvështrimi i fenomeneve sociale me natyrëjuridike mbi shkeljen e tëdrejtave njerëzore, shkaqet e lindjes mes tyre, kërkojnë masat parandaluese, të cilat duhet tëmarrin natyrëinstitucionale dhe individuale në zgjidhjet pozitive të situatave. Në pamje të parë, këndvështrimi shfaqet si qëllim i thjeshtë por në thelbin e tij, ai sjellënjë problem të thellë politik dhe social me ndikim mbi shoqërinë, e cila realisht është e orientuar nërespektimin e të drejtave të njeriut. Në material kjo veçori shfaqet ***në kapitullin e katërt***, në dimension më kompleks, të detajuar dhe të konkretizuar, duke dhënënatyrën e pjesës praktike të studimit. Metoda dhe

metodologjia e studimit është qasje serioze, që sjellë karakteristikat kryesore të dukurive negative, paragjykimeve sociale, duke lehtësuar natyrën e kritikave mbi teorizimet e pambështetura në praktika studimore, kundër subjektivizmave në zgjidhjen e problemit. Në thelb qëndron metoda studimore drejt qasjeve në vlera promovuese të përvojave të mira, të cilat nuk mungojnë në praktikën juridike shqiptare. Metoda sjellë interesanten mbi sjelljen shtetërore dhe individuale, ballafaquar me ndikimin e sistemit mediatik në rastet e dhunës, diskriminimit apo në kërkim të drejtësisë. Përpyekjet për të paraqitur shpjegime plotësuese mbi referencat dhe termat e veçanta, janë të lidhura me ndikimet ndërkombëtare, tipike në mbrojtje të të drejtave të njeriut, duke sjellë vlerat e personaliteteve historike, që kanë lënë gjurmë duke u bërë pika referimi të qëndrimit moral e shoqërore, si faktorë të fuqishëm nxitës të motivimit qytetar, për të mbrojtur me çdo çmim të drejtat jetësore. Kjo pjesë mund të vlerësohet si pjesë praktike e studimit. Materiali bazë i shfrytëzuar për të sjellë diçka të re në rritjen e vetëdijes qytetare ndaj detyrimeve institucionale, veçanërisht ndaj pasojave që shkakton Pandemia. Ato janë kthyer në fushë betejë mes të drejtave njerëzore dhe detyrimeve institucionale për ruajtjen e shëndetit. Përmes ballafaqimit me situatën në Shqipëri, sillet mbështetja e argumentuar me karakter social-juridik të një kohe në ndryshim. Në këtë përmbledhje të strukturuar, studimi evidenton, vlerëson dhe respekton emancipimin shoqëror të mjedisit shqiptar, kushtet dhe rregullat e reja që vazhdojnë të përsosin marrëdhëniet me vetëveten, politikën dhe shtetin, të motivuar drejt forcimit të vlerave të demokracisë. Harmonia në rritje mes shtresave sociale dhe ndikimit të Shoqërisë Civile mbi entet ligjzbatuese të drejtësisë dhe sigurisë publike, janë hap pozitiv për përmirësime situatës dhe rritjen e mundësive të përfaqësimit Shqipërisë në rritje ndërkombëtare. Formimi i stereotipit të qytetarit të ditur, të kulturuar dhe komunikues, rritja e vetëdijes në mbrojtje të së drejtës, nxit klimën e shëndetshme sociale drejt shoqërisë së hapur dhe të emancipuar. *“Dëshmia themelore e ushtrimit të së drejtës dhe lirisë qytetare, është manifestimi social i grupimeve, që nuk e kanë pushtetin real. Levizje sociale me objekt të përcaktuar të modelit ekonomik dhe rimodelimit të demokracisë, kanë prezantuar forma jetese dhe mënyrë të menduari ndryshe nga pushteti dhe qeverisja”*. (Abazi, Bashkim, 2013:159). Ky fenomen nuk është vetëm në nivelin tonë kombëtar, por dhe rajonal e më gjerë. Në terminologjinë e përdorur është respektuar gjuha letrare shqipe, pa huazime fjalësh të huaja. Rekomandimet modeste në fund të studimit, mund të sjellin ndikime pozitive social-psikologjike, juridike dhe kulturore, të pranuar në realitetin shqiptar, i cili shkarkon ngarkesat negative mbi qytetarët. Vërtetimi i hipotezës kryesore sjellë vlerat praktike ndaj realitetit kontradiktor, përplasjeve sociale, të cilat sfidojnë të drejtat, humanizmin, solidaritetin dhe situatën paqësore në Shqipëri. Emancipimi i shoqërisë me standarde bashkëkohore sjellë hapësira të dobishme për ide të reja racionale të unifikuara. Ndryshimi dhe transformimi i thellë i shoqërisë

shqiptare sipas dobisë së reformës në Drejtësi, mbetet në të ardhmen detyrim kushtetues. Me korrektësi në marrëdhëniet proceduriale me temën, udhëheqësin shkencor, materialet referuese, vlerësimi në përgjithësi dhe në detaje të fenomeneve që shfaqen nëfushën delikate të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Republikën e Shqipërisë, me këtë studim është mundësuar sjellja përmbledhëse para Komisionit të Nderuar, si përpjekje modeste dhe kontribut me vlera përgjithësuese, një shtysë serioze në arritjet e ndryshimeve për standardizimin e jetës social-politike dhe juridike të mjedisit shqiptar.

KAPITULLI I I

IV. Lidhja Historike e të Drejtave të Njeriut me Kohën Moderne

Si kanë lindur të Drejtat e Njeriut? Çështja e njohjes dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, ka tërhequr vëmendjen e filozofëve, sociologëve, teologëve, politikanëve, juristëve, të cilët në studimet e tyre, kanë hulumtuar në epoka dhe kohë të ndryshme, duke evidentuar fenomenet sociale të rrezikshme, dukuritë më të spikatura të veprimtarisë njerëzore në kushte të ndryshme, duke evidentuar të padukshmen, që i ka bërë njerëzit të jenë të pakënaqur, skeptik, apo më tej, të ngrihen në lëvizje të ndryshme transformuese me karakter social dhe politik, për të mbrojtur të drejtat dhe jetën e tyre.

Duke analizuar mbi një të mesme të artë, që nga lashtësia deri në ditët tona, shoqëria njerëzore ka kaluar në disa sisteme politike, ku lufta midis autoritarizmit dhe lirisë ka qënë e vazhdueshme, duke ia lëshuar vendin hera herës njera-tjetrës. Kontradikta i ka hapur rrugën kaosit social. Produkti i saj përtej avancimit të realitetit, nevojave dhe domosdoshmërive të frymës liberale, ka sjellë dalje të situatës nga kontrolli. Hera herës autoritarizmi ka kaluar në diktaturë dhe tirani dhe hera herës liria ka degraduar vlerat e saj, duke shkuar drejt liberalizmit të pakontrolluar me të gjitha pasojat e tij. Në formën e saj më të lartë kjo situatë ka degraduar në anarki kolektive. E thënë me fjalë të thjeshta; të gjithë kundër të gjithëve, secili për vete, zoti për të gjithë.

Janë revolucionet borgjeze, që kanë inspiruar, ligjin për të Drejtat, që në vitin 1689. Pra, si nocion historik, Deklarata për të Drejtat e Njeriut dhe të Qytetarit, merr nxitje në vitin 1689. Ato marrin një karakter kushtetues, në rastin e Deklaratës së Pavarsisë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në vitin 1776. Sipas studimeve historike, mund të marrim si shembull revolucionin francez, i cili prodhoi ndryshimin e mendimeve, frymës, duke u mbështetur në iluminizmin vendas, të përfaqësuar nga Hygoi, Volteri, De Karti dhe filozofë të tjerë. Atëherë kjo frymë lirie kërkoi si

nevojë lëvizjen politike për të vendosur rregullin, duke e sanksionuar mendimin filozofiko-ideologjik në mendim dhe rregull politik.

Në rendin e Feudalizimit, në të cilin masa e gjerë e njerëzve paraqiteshin në jetën e tyre në kushte më të mira dhe të favorëshme se sa me robërit e rendit skllavopronar, pronarët e tokave (feudalët), nuk kanë mundur t'i vrisnin njerëzit apo shtresat e përbuzura, por duke qenë të lidhur me nevojat e punimit të tokës, dhe në varësi të drejtëpërdrejtë nga pronari feudal, njerëzit individualisht dhe familjarisht, ishin të imponuar të duronin gjithfarë detyrimesh, kufizimesh, presionesh, shantazhesh, grabitjesh, taksash e sipërmarrje të tjera feudale, të cilat çënonin rëndë dinjitetin dhe të drejtat njerëzore. Kjo ishte natyra e egër e rendeve sociale, të cilat në thelb ishin gjakësor, shfrytëzues, dhunues, me natyrë të theksuar antinjerëzore. Mbi gjithçka qëndronte prona, fitimi, pasurimi dhe diktati.

Ndryshimet rrëzuan përtokë kalbësinë e sistemit feudal, shoqëria filloi të merrte frymë lirshëm, por edhe pas këtij ndryshimi, gradualisht idealet e revolucionit filluan degradimin, duke krijuar lodhjen në rrugëtimin e tyre. Sot njerëzimi po paguan pasojat e propagandës, e cila në emër të liberalizmit, ka folur për fuqizimin e demokracisë.

Në këtë periudhë historike, respektimi i të Drejtave të Njeriut, ishte përgjithësisht më tepër ideal, sesa realitet, e lidhur kjo, *“me marrëdhëniet e qenieve njerëzore me rrethanat ku ai gjendet”*. (Kissinger Henry, 2015:356). Në sistemin skllavopronar, robërit jo vetëm që nuk gëzonin barazi me shtresat sociale, por trajtoheshin si skllavë, si sende që pronari, skllavopronari, mund të bënte çfarë të donte, deri në shitjen apo marrjen e jetës. Dukuritë e këtij rendi, janë çnjerëzore dhe antihumane. Lufta për të Drejtat Themelore të njeriut, fillon me përpjekjet për t'u njohur e drejta e jetës dhe e lirisë, të cilat kanë qenë dukuritë më të rëndësishme antihumane, kundër jetës në sistemin skllavopronar dhe feudal. Më vonë, revolucionet borgjeze të të drejtave elementare të jetës humane, iu shtohen të drejtat natyrore, siç janë: e drejta e barazisë, e drejta për sigurinë e jetës, e drejta për t'i bërë rezistencë shtypësit dhe pushtuesit etj.

I.1. Drejtësia mbështetet në barazinë para Ligjit

Njeriu si krijesë humane, duhet të jetë i barabartë përpara drejtësisë dhe ligjit, si të çdo nevojë tjetër që ka individi për të jetuar jetën e tij. Kushdo ka të drejtën të mbrohet, nëse i cënohet e drejta e jetës, familjes, pronës private dhe biznesit. Si kategori juridike, të drejtat e njeriut janë paraqitur me krijimin e shteteve dhe rregullave të para juridike, rrjedhojë e revolucioneve borgjeze, të cilët në thelb kanë proklamuar si ide, lirinë, barazinë dhe vllazërinë mes njerëzve.

Të Drejtat e Njeriut trajtoheshin si çështje e kompetenave të brendshme të një shteti, ku përjashtim bënë rastet e regjimeve diktatoriale dhe nevojave të ndërhyrjes humanitare në zona të krizave të mëdha dhe gjenocideve, me pasoja në jetën e popujve. Bashkësia ndërkombëtare, pasi u krijuan organizmat e përgjithshme me ndikim dhe karakter ndërkombëtar, si Lidhja e Kombeve apo më vonë OKB, i ka kushtuar me tepër kujdes mirëqenies dhe jetës së individit, si kusht i thekshëm për mbrojtjen e Paqes, Sigurisë, Stabilitetit dhe Demokracisë në rendin botëror.

Sot në shumë vende të botës shkelen brutalisht të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore, shtypen me dhunë dhe gjenocid të drejtat e pakicave etnike dhe fetare, praktikohet diskriminimi në masë. Këto dëshmojnë, me gjithë arritjet në sistemin e demokracisë, lufta për vendosjen në jetë të parimeve dhe të drejtave dhe lirive Themelore të njeriut, nuk është arritur akoma në standarde të provuara humane e paqësore. Pjesët e para, identike, të preambulave të Deklaratës së Përgjithshme të të Drejtave të Njeriut dhe të Pakteve Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut theksojnë se, *“njohja e dinjitetit që u përket të gjithë anëtarëve të familjes njerëzore si dhe njohja e të drejtave të tyre të barabarta e të patjetërsueshme përbën themelin e lirisë, drejtësisë dhe paqes në botë”*. Preambulat e Pakteve më tej vazhdojnë: *“këto të drejta burojnë nga dinjiteti që i përket çdo njeriu”*. (Marek Piechowiak, www.researchgate.net).

Të Drejtat e Njeriut kanë zënë vend në propagandimin me daljen në qarkullim të veprave dhe publikimeve të juristëve, politikanëve, filozofëve të shek. XVI-XVII. Madje, e gjithë kjo e shtyn opinionin të mendojë se, problemet që i krijon politikëbërjet e këqija, pasojat prej tyre i vuajnë vetëm popujt dhe njerëzit e thjeshtë. Për njëfarë kohe drejtësia shqiptare duhet trajtuar në gjendjen e saj të reanimacionit. Në situatë të ballafaquar në Shqipërinë postkomuniste, kjo vlerësohet si fatkeqësi për popullin që vuan pasojat e saj. *“Psikologjia e thellësive u përket mendjendriturve. Tek ata mendimi është i përkushtuar ndaj shpirtit dhe zemrës, vlerave dhe standardeve të pëlqyeshme etike. Ata e meritojnë konsideratën e lartë humane”*. (Abazi, Bashkim, 2013:89). Drejtësia shqiptare ka nevojë jetike për njerëz të tillë. Kapacitetet bashkëkohore të shoqërisë së etur për zhvillim dhe progres, do të jenë të asfiksuar, përse kohë në vend nuk do të funksionojë drejtësia.

1.2. Institucionalizimi dhe mbrojtja ligjore e të drejtave të Njeriut

Njohja e dinjitetit të lindur të të drejtave të barabarta dhe të patjetërsueshme të familjes njerëzore, është themeli i lirisë, drejtësisë dhe paqes në botë; mbasi mosrespektimi dhe përbuzja e të drejtave të njeriut, ka çuar drejt akteve barbare kundër civilizimeve, të cilat kanë dhunuar dhe çvlerësuar ndërgjegjen e njerëzimit. Krijimi i botës në të cilën njerëzit mund të gëzojnë lirinë e fjalës, të

besimit dhe lirinë nga frika e varfërisë, ende propogandohet si dëshira më e lartë e njeriut, për ta vlerësuar dhe jetuar jetën e tij.

Në kohën modernetë Drejtat e Njeriut mbrohen dhe duhet të mbrohen me dispozita juridike, të sigurisë dhe atyre humane, për të mos lejuar mbarsjen e situatave shpërthyes, të cilat i detyrojnë njerëzit në pikën e fundit të varfërisë dhe të pabarazisë, të ngrihen në revolta, kryengritje, kundër tiranisë dhe shtypjes. Përvoja botërore sjell raste të tilla, të cilat mund të parandalohen duke respektuar nevojën juridike të ndërtimit dhe zhvillimit të marrëdhënieve humane, mes individëve, komuniteteve dhe popujve të ndryshëm në botë.

Me miratimin e organizimit dhe të funksionimit të OKB, jeta planetare provoi faktin e veprimit dhe mbrojtjes së të drejtave njerëzore, bazuar në Kartën e Besimit mbi të drejtat themelore të njeriut, duke vlerësuar dinjitetin dhe vlerat individuale, barazinë gjinore, për ndërtimin e klimës së favorshme për nxitjen e përparimit shoqëror dhe përmirësimit të nivelit të jetës në liri të plotë. Në këndvështrimin historik të drejtat e njeriut u bënë pjesë themelore e demokracisë perëndimore. Paradigma filozofike dhe konceptuale u mbështet në vlerat e qënies humane për shoqërinë. *“Njerëzit janë krijuar të barabartë, duke mos e ngatërruar gjendjen natyrore të njeriut me gjendjen e luftës, dhe qeverisjet mbështeten tek ligji dhe jo tek forca. Ligjet miratohen nga përfaqësuesit e popullit, në emër të tij dhe qytetarët kanë “të drejta” të imunizuara prej ndërhyrjes së qeverisë”*. (William Reaper, Linda Smith, 1999:89). Duke studiuar literaturën e bollshme pas dokumenteve kryesore ndërkombëtare, shembull u bë koncepti në ligjin mbi të drejtat në Kushtetutën e SHBA.

Sipas Kissinger, *“Që nga fillimet e epokës moderne të shekullit të XVI, filozofët e politikës kanë debatuar lidhur me problemin e marrëdhënieve të qënies njerëzore me rrethanat ku ai gjendet. Hobsi, Loku dhe Rusoi, krijuan një portret biologjik-psikologjik të vetëdijes njerëzore dhe qëndrimet e tyre politike i bazuan tek kjo pikënisje. Themeluesit amerikanë bënë të njëjtën gjë. Ata e ndoqën evolucionin e shoqërisë me anën e faktorëve që “gjendeshin në natyrën e njeriut: zotësia e madhe e çdo individi për të arsyetuar, megjithëse me pasaktësi dhe “egoizmi” i tij i qënësishëm, nga bashkëveprimi i të cilave “formohen mendime të ndryshme”, si dhe larmia e aftësive të njeriut, nga të cilat “buron menjeherë zotërimi i sasive dhe llojeve të ndryshme të pronës” dhe sëbashku me to një “ndarje e shoqërisë në interesa dhe grupe të ndryshme”. Megjithëse këta mendimtarë ndryshonin në analizat e tyre mbi faktorë specifikë dhe në përfundimet që nxirrnin, të gjithë i krijuan konceptet e tyre në lidhje me njerëzimin, natyra e qënësishme e të cilit dhe përvoja me realitetin ishin të pafundme dhe të pandryshueshme”*. (Henry Kissinger, 2015:356).

Në këndvështrimin e diplomatit amerikan Kissinger, shfaqen disa dukuri të raporteve të njeriut me jetën amerikane, duke hedhur bazat për të ndërtuar marrëdhënie të tjera që garantonin liritë dhe të

drejtat themelore të qytetarit amerikan, përballë “*mendimeve ndryshe*”, “*sistemit politik*”, “*pronës*”, “*ndarjes së interesave*”, “*shtresëzimeve sociale*” etj. (Henry Kissinger, 2015:356). Konceptet filozofiko-politike u bënë mbështetje dhe shembull për vendet demokratike.

Shekulli i XX me dy luftra botërore, shkaktoi gjenocide mbi popujt, duke e diktuar jetën me anë të dhunës së fashizmit. Ato u dominuan nga fryma e nacionalizmit ekstrem, duke u shfaqur rrezik potencial për popujt dhe kombet. Fitorja mbi fashizmin, ishte fitorja e njeriut për jetën. Ndryshimet e pasluftës çuan në nevojën e ripërtëritjes së sistemit qeverisës, duke likujduar vatrat totalitare të dhunës. Modelet e vjetra ia lanëvendin modeleve demokratike paqësore. “*Totalitarizmi si formë diktatoriale e qeverisjes së centralizuar, që rregullon çdo aspekt të veprimtarisë shtetërore dhe private...*”, po i linte vendin sistemit demokratik. (Quentin Skinner, Makiaveli, 2018:82). Nevoja për largimin e modelit të degraduar të shtetit, largimi nga arbitrariteti shtetëror dhe mjetet e dhunës mbi njeriun, respektimi i të drejtës së pronës në zhvillimin ekonomik, hapën rrugën sistemit të demokracisë perëndimore, e cila në bazën filozofike të saj, vendosi mbrojtjen e të drejtave njerëzore.

Periudha e “*luftës së ftohtë*”, ishte ballafaqimi i ashpër midis luftës për të drejtat e njeriut dhe jetës ndryshe në vendet e sistemit komunist. Natyra e sistemeve brenda rendit botëror, nuk mund të pranonte kundërvënien në të gjithë format të sistemeve diktatoriale, ku jeta e njeriut merrte vlera minimale.

“Deri në fund të viteve 1980, fakti që Kina me ndryshim nga Evropa Lindore, nuk po demokratizohej dhe ofronte vetëm nivele të pamjaftueshme të mbrojtjes së të drejtave të njeriut ndaj popullit të saj, dhe kjo nuk kishte tërhequr shumë vëmendjen e ndërkombëtarëve. Informacioni rreth shkeljes së të drejtave të njeriut në Kinë, madje edhe kur ajo ndërmori reformën, u bë i disponueshëm pjesë – pjesë. Qeveria e Pekinit nuk mund të bënte progres me politikat e saj të dyerve të hapura dhe njëkohësisht të pengonte kontrollin e jashtëm mbi gjendjen e saj të brendshme. Për më tepër, reformat po kryheshin pikërisht në kohën kur organizatat e të drejtave të njeriut në Perëndim po rriteshin në numër dhe po fuqizoheshin. Amnesty Internacional, më prestigjiozja e organizatave joqeveritare transnacionale mbi të drejtat e njeriut, nxori raportin e saj të parë mbi gjendjen në Kinë, duke u përqëndruar në abuzimet kryesore, si arrestime arbitrare, përdorimin e torturës dhe burgime pa gjykim”. “Në 13 maj studentët fillojnë grevën e urisë në sheshin Ten An Men dhe më 20 maj shpallet gjendja e jashtëzakonshme. Në 3-4 qershor trupat ushtarake spastrojnë sheshin dhe hapin zjarr mbi demonstruesit. Sipas disa përllogaritjeve disa qindra vetë humbën jetën dhe mijëra të tjerë u plagosën. Pas kësaj në 5 qershor filloi dënimi ndërkombëtar i veprimit kinëz”. (Rosemary Foot, 2012:430, 432).

Shembulli i trajtuar jep pasqyrën e qartë të përplasjes së madhe kundër shkeljes së të drejtave njerëzore, të cilat ende mbështeten në sistemin politik antihuman dhe shfrytëzues. Këto përplasje politike dhe shoqërore vendosën ballë për ballë paqen dhe luftën, humanizmin kundër shkeljeve të të drejtave njerëzore, të drejtat e njeriut kundër dhunës, diskriminimit, aktit të dënimit me vdekje, kundër dhunimit të pronës dhe të drejtave të tjera të jetës në liri.

Konfliktet rajonale dhe tendencat e veprimit të terrorizmit ndërkombëtar kanë dhënë shkas për përsosjen juridike të mbrojtjes së jetës dhe të drejtave të njeriut, duke marrë shkas nga gjenocidet, luftat, krimet kundër njerëzimit, akteve të dhunës, shkeljes flagrante të të drejtës humanitare etj. Shembujt në ditët e sotme janë të pranishme.

“Indiferenca e komunitetit ndërkombëtar ndaj Ruandës ngarkoi me turp të jashtëzakonshëm KS të KB dhe vetë OKB. Në përgjigje të dështimit në Ruanda dhe të ndërhyrjeve humanitare në Kosovë dhe Timorin Lindor, sekretari i Përgjithshëm i OKB, Kofi Anan e nxiti AP të KB në vitin 1999 të shqyrtonte miratimin e një doktrine për ndërhyrjet humanitare. Megjithëse shumë shtete ishin pasive rreth një doktrine që mund të vendoste detyrime mbi to dhe të kufizonte sovranitetin e tyre shtetëror, Kanadaja një përkrahëse e veprimit paqeruajtës dhe humanitar të KB, sponsorizoi një komision ndërkombëtar. Pas konsultimeve të zgjeruara mbarbotërore, komisioni propozoi doktrinën, “Përgjegjësia për të Mbrojtur”. Siç deklaroi këshilltari për Sigurinë e presidentit Clinton, disa organizatave për të drejtat e njeriut që dëshironin që SHBA të ndërhynin në Ruanda për të ndaluar gjenocidin, veprimi do të ndodhë vetën nëse njerëzit “do të bëjnë zhurmë”. (Michaael Barnett, 2012:293).

Vlerësimi i përvojave ndërkombëtare krijon bindjen se, tendencat për të dhunuar jetën e njeriut janë të pranishme, jo vetëm në vende të ndryshme të botës, por brenda Evropës, Ballkanit, të cilat sjellin në vëmendje shkeljen e të drejtave njerëzore dhe lirisë, dhunën dhe gjenocidet e viteve 93-95 dhe 97-2001 mbi popullsitë paqësore në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

“Humanizmi ka lidhje me pretendimin se të gjithë individët kanë disa të drejta bazë të patjetërsueshme. Ai është baza për një angazhim të përgjithshëm për të mos i dalluar individët në bazë të kombësisë, fesë, etnisë së tyre ose tregues të tjerë”. (Rosemary Foot, 2012:551).

Në kontekstin e zhvillimeve historike, lindi nevoja e miratimit të Deklaratës, si përpjekje globale në mbrojtje të të drejtave njerëzore. Ajo përmban të programuara 30 (tridhjetë) artikuj, të cilët ndër vite janë përsosur, duke u mbështetur dhe zbatuar në marrëveshje dhe traktate ndërkombëtare, konventat njerëzore dhe ekonomike, të drejtave rajonale të njeriut sipas Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, të materializuara ligjërisht në kushtetutate shtetërore që janë bërë pjesë e miratimit të saj. Pjesë përbërëse e Kartës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut janë, Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale

dhe Kulturore dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, me dy Protokolle opsionale. Ato zhvillojnë në detaje të Drejtat e Njeriut.

Në strukturën e studimit janë trajtuar në harmoni çështje e nënçështje konkrete, duke u mbështetur në metodën e plotësimit të kërkesave të hipotezës kryesore, si thelbi i trajtimit hulumtues. Brenda kufizave të hipotezës kryesore dhe ndihmuese, artikujt e Deklaratës së të Drejtave të Njeriut dhe Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut, ballafaqohen me jetën social-politike në Shqipërinë postkomuniste, e cila në ndryshimin e sistemit politik dhe të pushtetit shtetëror në tre dekada, ka dhënë pasqyrën komplekse mbi jetën e qytetarëve shqiptarë. Ballafaqimi përballë me shkeljet ekstreme të të drejtave njerëzore, korrupsionit politik, shantazhimeve, dhunës, vrasjeve politike dhe të zakonshme, dhunimit të krijesave të dobëta, burgosjeve për krime të pavërtetuara, rrëmbimeve dhe zhdukje individësh, arrestimeve etj. Jeta e qytetarëve shqiptarë ka kaluar në situata delikate, ku shpesh vlerat reale të demokracisë janë vënë në pikëpyetje nga shteti dhe pushteti.

Studimi i artikujve kryesorë sjellë mundësi dhe qasje të reja në arritjen e ndërveprimit të thelbit juridik të jetës shqiptare me të drejtën e saj për liri, votë, të drejtë, vlerësim të të drejtave qytetare dhe shtetërore, pushtet, të drejtë pune, ruajtjen e vlerave të familjes, kontribut humanitar dhe social, të drejtat gjatë vuajtjes së dënimit, të gjitha këto si hapësira juridike me bazë humane, të sanksionuara në Kushtetutën e Shqipërisë. Ana historike e dimensionit juridik të të drejtave njerëzore, shërben si domosdoshmëri e ndërtimit juridik të jetës së shoqërisë shqiptare. Zhvillimi i jetës brenda fenomeneve, dukurive sociale dhe politike, shoqërojnë individin dhe shtetin përballë të drejtave njerëzore. Ballafaqimime marrëdhëniet politike, shoqërore dhe ekonomike, sjellë dinamikën e jetës sipas parimeve dhe normave bashkëkohore, në raport me ligjin, shtetin dhe të drejtën njerëzore. Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut shfaqet për mjedisin shqiptar si dimension human për të ruajtur ekuilibrin e jetës.

Në ballafaqim me kërkesat e Konventës Evropiane të të Drejtave të njeriut, parashtrohen disa elementetë veçantë, të cilët janë pika referimi të ndryshimit demokratik të jetës shqiptare. Baza e të drejtës njerëzore parasheh, *të drejtën e barazisë, lirisë nga diskriminimi, skllaverimi, të barazisë para ligjit, të drejtës së gjyqimit, privatësisë, mbrojtjes ligjore, të lëvizjes së lirë, e drejta e pronës, martesës dhe krijimit të familjes, e drejta e fjalës, tubimit, zgjedhjes dhe pjesëmarrjes në qeverisje, e drejta e sigurimit shoqëror, shëndetsor dhe sindikalizmit, e drejta e arsimimit, kulturore, shoqërore etj.* (Raporti Vjetor i Avokatit të Popullit, 2019,2020:5). Ato janë kthyer në bazëjuridike dhe social-politike të të drejtave njerëzore.

Futja e elementeve të tillë nëpraktikat juridike tëzhvillimit shkencor, të sistemit të edukimit dhe arsimimit, është hapësira që garanton progresin kombëtar, vlerësimi që i bëhet sistemit të jetës njerëzore, baza e mbështetjes së progresit për paqe të qëndrueshme, barazi dhe humanizëm. Edukimi mbi këto parime themelore, i bën njerëzit të jenë të lirë, të barabartë në të drejtat e tyre, tërespektojnë ndërgjegjen njerëzore dhe tëmos bëhen shkak për dhunimin e të drejtave të të tjerëve. Nëse këto të drejta dhe liri respektohen pa kufizime racore, nacionale, gjinore, gjuhësore, të besimit fetar, të të drejtës së mendimit politik, shoqëror, të drejtës së pronës, aftësive dhe konkurrencës së ndershme, atëherë njeriu gëzon statusin jetësor, politik, juridik dhe social, duke rritur mëvetësinë në jetën e tij.

Përmbledhja në kujtesën e të drejtave më të spikatura në Deklaratën Themelore të të Drejtave të Njeriut, në mënyrë të përmbledhur, nxit ambicjen e studimit më të thelluar të tyre, duke u ballafaquar me mjedisin e jetës. Njeriu dhe qytetari në Shqipëri, gëzon të drejtën t'i sigurohet një rend shoqëror kombëtar juridik dhe kushtetues, në harmoni me të drejtën juridike ndërkombëtare, për t'u bërë pjesë reale e vlerave fundmentale ndërkombëtare. Në çdo 4 vjet në Shqipëri veprojnë këto institucione për promovimin e parimeve në jetën social-politike të popullit, me aktivitete qendrore për problemet kryesore në mbrojtje të të drejtave të njeriut. Funksionet legislative të Avokatit të Popullit janë të orientuara në mbrojtjen, promovimin dhe garantimin e të drejtave të njeriut në Republikën e Shqipërisë, duke vendosur kontakte direkte me qytetarët dhe institucionet ligjvënëse e ligjzbatuese.

I.3. Drejtësia, baza morale e juridike për mbrojtjen e të drejtave njerëzore

Ndryshimet politike globale, ndikojnë në psikologjinë njerëzore. Ngjarjet tronditëse dhe pasojat janë kthyer në shtrat inkubacioni dhe justifikimi, për të hedhur tinëzisht në tregun e filozofisë politike dhe shkencave shoqërore e juridike, *“ide të reja zhvillimi”*, në emër të *“të drejtave të njeriut, të sigurisë njerëzore, asaj kolektive”*, (Abazi, Sulejman, 2018:72), duke u mbështetur në garancitë që jep modeli kushtetues i sistemit politik.

Pranohet se, nxitimi drejt një bote globaliste reflekton mungesa thelbësore në zhvillimin e shoqërisë, të cilat tashmë duket se kanë sfiduar konceptin tradicional të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe të sigurisë publike e kombëtare, duke i afruar asaj si primar, rolin e individit dhe jo të shtetit, të vlerësuar si të domosdoshëm për stabilitet kombëtar, rajonal dhe global. Orientimi dhe lëvizja konceptuale e botës, po zhvillohet nga botëkuptimi shumëdimensional në fushën e sigurisë

së jetës. Siguria e lirisë nga nevojat dhe lirisë nga frika për individët, është mënyra më e mirë për të rregulluar balancat e mungesës së sigurisë për mbrojtjen e të drejtave njerëzore në shkallë globale. Mosrespektimi është kërcënim për sigurinë njerëzore. Ato janë treguesi i paralajmërimit, për parandalimin e konflikteve sociale mes njeriut dhe shtetit.

Realiteti botëror po i pranon ato me imponim, si pjesë e synimeve të politikanëve, oligarkëve, presidentëve, filozofëve, doktrinarëve, gjeneralëve, historianëve, shkencëtarëve, ndonjëherë dhe e njerëzve të thjeshtë, duke u përballur në situata të vështira, të shkaktuara nga pandemia në shkallë globale dhe korrupsioni moral e material në të cilën është zhytur jeta njerëzore. Që në vitin 1512, Nikolo Makiaveli do të përfshihej nga kjo dilemë. Ai theksonte se, *“natyra e njeriut është ambicioze dhe dyshuese”*, (Makiaveli, N: 2018:201), në shkallë të tillë, sa që shumica e njerëzve, *“nuk do të bënin kurrë asgjë të mirë, nëse nuk do të lindëte nevoja”*. (Makiaveli, N: 2018:257). Nga ana tjetër ai këmbëngulte që njerëzit lejohen, *“të hidhen nga një ambicje tek tjetra”*, (Makiaveli, N: 2018:290), duke sjellë faktin që qyteti (nënkupton, shteti dhe shoqëria, shënimi im), të bëhet copash me shpejtësi, si dhe të humb rastin për t’u bërë i madh.

Ndërkohë që ruajtja e lirisë është kusht i domosdoshëm madhor, rritja e korrupsionit është fatale për lirinë. Sapo njerëzit egoistë apo interesat sektare fitojnë terren, dëshira për të nxjerrë ligje *“në emër të lirisë”*, bëhet e bezdisshme, fraksionet nisin të fitojnë pushtet dhe *“tiranja shfaqet sa hap e mbyll sytë në vend të lirisë”*. (Makiaveli, N: 2018:282). Kudo ku korrupsioni hyn në një masë të tërë qytetarësh, ata *“nuk do të mund të jetojnë në liri, përveçse për një kohë të shkurtër, ose asfare”*. (Makiaveli, N: 2018:84). Konstatimi filozofik i disa shekujve më parë, është aktual. Ai vepron me të njëjtën forcë në ditët e sotme, në mungesë të drejtësisë dhe pranisë së korrupsionit, mosrespektimit të të drejtave të njeriut, duke u shfaqur kërcënim për sigurinë njerëzore.

Karakteri aktual i hulumtimit dhe analizës mbi drejtësinë shqiptare në Shqipërinë postkomuniste dhe kapitullit për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, do të vlejë për aq kohë, sa ajo do t’i shërbejë perspektivës për rritjen e standardeve bashkëkohore të interesit publik dhe të qytetarit shqiptar. Mospërputhja midis qëndrimeve shtetërore, ligjit, drejtësisë, sigurisë publike dhe individit, ushqen klimën e paqëndrueshme politike dhe sociale. Kapërcimi i ndasive për shkak të trashëgimisë komuniste, do të jenë objekt studimit i praktikave metodologjike të dobishme në të ardhmen.

Çështja e respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Shqipërinë postkomuniste është objekti kryesor i plotësimit nga ana e shtetit shqiptar të standarteve për tu antarësuar në BE. Ky është një objektiv politik dhe shoqëror me karakter strategjik. Përmes analizës shkencore dhe

ballafaqimit, studimi orientohet drejt mundësive për thellimin e reformës politiko-sociale sipas standarteve evropiane. Bazë mbetet zbatimi i kërkesave të Traktatit të Amsterdamt 1999, ku, *“çdo shtet evropian që respekton parimet e lirisë, të demokracisë, të respektimit të të drejtave të Njeriut dhe lirive themelore, të drejtat e shtetit ligjor, mund të aspirojë për t’u bërë shtete antar i BE”*. (Lisbeth Aggestam, 2012:522).

Në Shqipërinë postkomuniste, liberalizmi ka kaluar caqet që i nevojiten demokracisë. Kjo ka sjellë pasoja, të cilat po i paguan shoqëria njerëzore. Ngjarjet e sotme kanë marrë një natyrë interesante, në ballafaqimin me realitetin dhe parimet që normojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Rastet e luftimeve në Ballkanin Perëndimor apo sot në Ukrainë, ngjarje të tjera në rajone të ndryshme të botës, kanë shkaktuar dhunë dhe gjenocide, duke u shfaqur si fenomene midis kaosit dhe rendit. Nga diktati dhe imponimi shpesh situatat paraqiten në emër të demokracisë (rendit) dhe shpesh si diktaturë (kaosi).

Pse shkaktohet kjo kontradiktë imanente brenda shoqërisë njerëzore? Brenda kësaj përplasje sociale dhe politike, janë vënë përballë liberalizmi dhe konservatorizmi, duke shtuar dilemën e rrezikut kryesor të persekutimit mbi individin dhe shoqërinë. Në kushtet e funksionimit të demokracisë dhe lirive themelore të njeriut, sot kërkohet t’i vihet fre pushtetit dhe ndikimit të disa faktorëve, që diktojnë dhe imponojnë mbi të drejtat njerëzore, mbi marrëdhëniet shoqërore dhe individuale, duke pranuar rregulla të reja që përpiqen të dhunojnë demokracinë.

“Njerëzit kanë pëlqyer dhe e kanë pranuar se, çfarëështë për dobinë e përbashkët, është edhe e drejtë”. (Aristoteli, 2001:218). Kjo është harmonia e dobishme, që normon ekuilibrin e marrëdhënieve juridike e sociale. Rregulla me tepëri nuk i duhen dhe nuk i vlejnë shoqërisë njerëzore, sepse është domosdoshmërisht nevoja për ekuilibrin e demokracisë, e cila çon në prosperitet, në zhvillim të pandërprerë organik. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, nuk përcaktohen aq shumë nga sistemi, por nga e drejta që jeta dhe natyra i kanë dhuruar njeriut. Çdo gjë që siguron zhvillimin normal në të gjitha drejtimet, ekonomike, politike, sociale, psikologjike, shëndetsore, arsimore, kulturore, standardit të jetesës etj, duhen përkrahur dhe mbështetur. Gjithçka që imponohet nga jashtë për interesa të ngushta të çastit nga superstrukturat politike, janë kundërvënie ndaj natyrës së të drejtave njerëzore. Liria e vërtetë është e lidhur me këta faktorë, të cilët i shërbejnë jetës së njeriut. Në Shqipërinë postkomuniste shpesh ato janë vënë në shërbim të fuqive politike, që diktojnë kundër vlerave të demokracisë. Analiza e situatës me problemet e hapura dhe të fshehura, tregon se në Shqipërinë postkomuniste njerëzit ende nuk ndihen të lirë.

Sipas trajtimit të lirë në hulumtimin dhe shtjellimin e problemit, duke abstraguat mbi vlerat ideale të demokracisë dhe të lirisë njerëzore, duhet të pranojmë se, në çdo kohë dhe në çdo vend çfarë përfaqësojnë ato përballë diktaturave dhe imponimit?

Kjo është kërkesa humane, që përkon me natyrën njerëzore. Evolucioni në natyrë dhe në shoqëri vepron duke hequr elemente të tepërta që dhunojnë të tërën. Me anë të frymës liberale, është luftuar diktatura dhe dhuna, për të lejuar të zbatohet ajo që është racionale, e cila hap rrugën vendimeve të drejta mbi jetën e njeriut, kundër imponimit me dhunë të frymës konservatore, që nuk lejon hapësira lirie. Me këtë situatë jeta shqiptare është përballur shumë herë. Shmangiet nga parimet bazë, kanë çuar në këto situata. Kjo ka ndodhur edhe në Shqipëri, ku liderët kanë eliminuar njeri-tjetrin, duke shkelur dhe dhunuar rregullat në demokraci. Këta lider nuk kanë qenë që në embrion demokratë, liberalë, paqësorë, por të indoktrinuar përcollën në sistemin e demokracisë ato qëndrime dhe bindje konservatore, duke e deformuar atë. Shumë prej figurave të tilla në demokraci, kanë përfunduar në autoritaristë mbi njeriun e thjeshtë dhe shoqërinë. Si tek individët, por dhe në shoqëri, proceset e evolimit kthehen e rikthehen, duke lënë pasojat e tyre. Absolutizimi që këto fenomene, nuk mund të ndodhin në sistemin e demokracisë, sepse bien në kundërshtim me dialektikën e saj.

Shpjegimet që realizojmë në këtë hulumtim, kanë si objekt zbulimin e kontradiktave të brendshme të sistemit të jetës sociale, politike dhe të drejtësisë, për të kuptuar vlerën reale të lirisë në sistemin tonë demokratik.

Së pari, në jetën sociale dhe politike në Shqipërinë postkomuniste, u shfaq konflikti midis asaj që shkruhej dhe propogandohej, dhe asaj që ndodhi në realitet. Kundër koncepteve idealiste mbi demokracinë, shumë korniza ligjore që plotësonin kuadrin ligjor kushtetues, u shkruan sipas përvojave të vendeve të tjera, ndonjëherë dhe të kopjuara, pa pasur lidhje organike me thelbin e jetës shqiptare. Nëse një kushtetutë, legjislacion apo qoftë dhe një ligj sillet i kopjuar, ai sillet si mish i huaj, një transplant i huaj, të cilin trupi i shoqërisë e flak në një moment të caktuar. Flakje të tilla në Shqipëri kanë ndodhur, duke shkaktuar ngrerç social dhe juridik. Shpesh në jetën sociale politike shqiptare është dalluar mënyra e zgjidhjes popullore të problemeve, më shumë se sa në vetë bazën ligjore dhe juridike. Kjo traditë e fituar mbi të drejtën nga përvoja e gjatë, është një mësim për jetën e sotme. A mund të flitet për një liri njerëzore të pranuar, e cila mbështetet në një legjislacion të kopjuar?

Së dyti, demokracia dhe liria njerëzore në Shqipëri është e shkëlbuar rëndë, duke dhunuar të drejtën e saj më të spikatur, të drejtën e votës së lirë të individit. Sistemi dhe kodi zgjedhor

mbeten të organizuara me ligj, duke dhunuar votën e lirë të qytetarëve. Si mundet populli të votojë dhe partia formon listën e përfaqësuesve të tij? Mbi çfarë baze funksionon diktati dhe formalizmi mbi atë që është shkruar si liri me tepëri, duke mos pasur aspak liri të vërtetë? Për përfaqësimin e tij në organet e larta, populli mund të flasë si të dojë, mund të kundërshtojë apo të mbështesë këdo, por në fund të fundit ata që do ta përfaqësojnë, do të caktohen nga lista e partisë. Kjo merr natyrën e lirisë formale, e cila funksionon vetëm sipas fuqisë së parasë. Njerëzit e pasur nuk tentojnë të depërtojnë në organet e shtetit, por ata me mbështetje financiare çojnë në këto institucione njerëzit e tyre, ata që do t'i shërbejnë interesave të tyre. Ky mekanizëm në Republikën e Shqipërisë është një fakt. Kontradikta shfaqet e hapur midis të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe anës formale të respektimit të tyre në praktikë, mbi një bazë juridike të lëkundur, të diktuar dhe kontrolluar nga pak njerëz.

Problemet që shfaqen në nivelin e kontradiktave kanë të bëjnë me mosndryshimin e thelbit të lirisë dhe demokracisë. Nëse ka formalizëm midis nevojës së shkruar të tyre dhe pengesave të zbatimit konkret të akteve që mbështesin vlerat e demokracisë dhe të lirisë reale, kjo nuk duhet të jetë fytyra e vërtetë e shoqërisë njerëzore. Opinioni e di që në parlamentin e Shqipërisë, deputetët nuk kanë kredenciale nga populli, nuk janë njerëzit më të mirë për përfaqësim, por janë ngritur në nivele të tilla me prapavija politike dhe financiare. Brenda kostumit të tyre të përfaqësimit, ngrohen elemente negativë që kultivojnë njerëz të korruptuar, në konflikt interesi, deri diktatorë të ardhshëm. Dëshira për të grumbulluar sa më shumë pushtet në duart e tyre, për të mos pranuar opozitë reale, lufta kundër mendimit ndryshe, krijimi i neopotizmit politik, pa paraqitur vlerat reale të njerëzve të lirë, kjo situatë prodhon autoritarizëm dhe diktaturë.

Në demokracinë shqiptare dominon mendimi politik individual. Kompromentimi i një klase politike të korruptuar, e pozicionon atë të gjendet në të njëjtën anë, kur është fjala për të dhunuar lirinë e popullit dhe të individit. Në këto kushte, si mund të jetë njeriu shqiptar i lirë, nëse atij nuk i garantohen shumë elemente jetësor, që kanë të bëjnë me minimumin jetik dhe të drejtën për t'i shërbyer jetës së tyre?

Këtu fillon funksioni real i demokracisë dhe lirisë për individin. Kanë kaluar 32 vite në sistemin e lirë demokratik dhe ende në Shqipëri nuk është llogaritur, pranuar dhe shpallur kjo vlerë që garanton jetën qytetare. Liritë dhe të drejtat e njeriut bazohen në radhë të parë në lirinë dhe pavarësinë ekonomike. Ky është rreziku më i madh kundër të drejtave, i cili shfaqet në sistemin e korruptuar, veçanërisht në drejtësi. Konformizmi i drejtësisë me pushtetin politik, sjellë krizën e besimit ndaj drejtësisë. Korrupsioni dhe padrejtësia, janë rreziku kundër sigurisë publike dhe

kombëtare, nxitës të konflikteve të brendshme, të njësistemitë kalbur që rrënon gradualisht jetën e shoqërisë shqiptare. Politika i dikton sistemit të drejtësisë, duke dhunuar nga maja e piramidës të drejtat e njeriut. Kështu, politikat gjyqësore kanë vazhduar të mbështeten mbi kritere politike dhe jo mbi interesin publik të qytetarëve. Ç'rënjosja e korrupsionit në drejtësi dhe pavarësia e sistemit, përbën sfidën më të rëndësishme për sigurinë e shtetit dhe shoqërisë. Drejtësia po ndëshkon vetëveten, në mungesë të vullnetit të mirë për t'i shërbyer pavarësisë dhe dinjitetit të saj, duke e shkarkuar përgjegjësinë dhe pasojat mbi qytetarin e thjeshtë shqiptar.

Rreziku i autoritarizmit dixhital, nxit simptomat e veprimit me karakter ushtarak, policor, ekonomik, i cili nuk është zgjedhje, por vlerësohet si domosdoshmëri strategjike, edhe pse shkel të drejtat njerëzore. Ai thellon krizën e besimit tek politika, duke krijuar rreziqe sistematike për qeverisjen dhe sigurinë kombëtare. Edhe nëse ka pika të forta, ai është bërë delikat për sistemin politik dhe sistemin e drejtësisë në Republikën e Shqipërisë. Rëndësi merr përpunimi dhe përsosja e metodologjisë së studimit të çështjeve thelbësore, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të cilat reflektojnë direkt në fushën e sigurisë publike dhe atëkombëtare, përmes raporteve që krijohen midis individit-qytetar, nëpërmjet gnoseologjisë, si disiplinës filozofike, drejt mundësive, vëllimit psikologjik, vërtetësisë dhe kritereve të njohjes së tyre.

Tabela nr. 1: Ankesat e qytetarëve për institucionet shtetërore dhe Avokatin e Popullit

Nr.	Institucionet shtetërore	Ank.	Avokati i Popullit	Nr. Ank.
			Llojet e ankesave (viti 2019)	
1.	Këshilli i Ministrave	56	Kufizimi i lirisë së personit	330
2.	Ministria e Drejtësisë	330	E drejta e prones	235
3.	Min. Shëndetsisë	149	E drejta e mbrojtjes së punës	103
4.	Ministria e Brendshme	119	E drejta mbi sigurimet shoqërore	63
5.	Ministria e Arsimit	49	Ndihma ekonomike	74
6.	Ministria e Infrastrukturës	47	Procedurat gjyqësore	50
7.	Ministria e Financës	23	Mbrojtja e konsumatorit	51
8.	Ministria e Turizmit	23	E drejta për strehim	47
9.	Ministria e Mbrojtjes	9	E drejta për informim	35
10.	Ministria e Bujqësisë	4	E drejta për kujdes shëndetsor	31

11.	Ministria e Kulturës	3	E drejta për arsim	54
12.	Pushteti Vendor	297	Të tjera	275
13.	Gjykatat	47		
14.	Prokuroria	75		
15.	Institucionet e Pavarura	19		
16.	Institucione të tjera	134		
17.	Shuma	1384		1348

Burimi: Raporti vjetor i Avokatit të Popullit, Tiranë 2019

Sipas të dhënave problemet delikate qytetarët i kanë në lidhje me këto institucione në raport me drejtësinë. Vlerësimi i ankimeve rezulton në 68.7 % drejtuar institucioneve qendrore dhe vetëm 21.3 % institucioneve vendore. Kjo vërteton shkallën e besueshmërisë së qytetarëve dhe vetë rolin e pamjaftueshëm të vendimmarrjes së pushtetit vendor në interesin publik. Në totalin e ankimeve 33 % e tyre i drejtohen Ministrisë së Drejtësisë dhe asaj të Brendshme. Vetëm 9 % e ankesave janë për çështje shëndetsore.

Sipas të dhënave nga mungesa e zbatimit të kriterëve të drejtësisë dhe ballafaqimi me situata me probleme, në Republikën e Shqipërisë kontrata e qytetarit me shtetin ka pësuar krisje në raport me interesat publike. Kjo reflektohet në Raportin vjetor të Avokatit të Popullit për vitin 2019, mbi ankesat e qytetarëve drejtuar institucioneve të shtetit për të drejtat e tyre.

Për vitin 2019 janë evidentuar 1348 ankesa. Vendin kryesor e zenë kufizimi i lirisë së personit dhe ankesat mbi të drejtën e pronës. (330+235, në total afro 42 % e ankesave). Ankesat për mbrojtjen e të drejtës së punës zenë gati 8 % të ankesave të përgjithëshme. Vërehet tendenca e ankimeve të qytetarëve nga institucionet qendrore dhe më pak në pushtetin vendor. Ata i drejtohen drejtësisë dhe rendit publik, duke sjellë në vëmendje problemet në shkeljen e të drejtave njerëzore prej dy institucioneve. Ankesat në institucionet qendrore (Ministritë dhe Avokatin e Popullit) zenë 2140 raste, ose 78 %, ndërsa në pushtetin vendor, gjykata, prokurori, institucione të pavarura dhe institucione të tjera vetëm 592 raste, ose afësisht 22 %. Qytetarët i mbajnë shpresat tek institucionet qendrore dhe më pak ndaj institucioneve të tjera dhe pushtetit në bazë.

Ankesat më të shumta mbi shkeljen e të drejtave i janë drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, pushtetit vendor, Ministrisë së Shëndetësisë, të Punëve të Brendshme dhe Kryeministrisë. Në raport me numrin e përgjithshëm të ankesave për vitin 2019, *(gjithësejt 1361 ankesa të rregjistruara)*, institucioneve kryesore u janë drejtuar 951 prej tyre, gati 70 %. Raporti i vlerësimit të ankimimeve rezulton në 68.7 % për institucionet qendrore dhe 21.3 % atyre vendore. Në total 33 % i drejtohen Ministrisë së Drejtësisë dhe asaj të Brendshme. Vetëm 9 % janë për çështje shëndetsore. Sipas vlerësimit, trajtimi duhet bërë për disa nivele sociale, disa prej të cilave janë më të shfaqura ndaj dhunës, diskriminimit, duke dhënë pamjen e plotë të kërkesave në rritje për t'u bërë ballë fenomeneve. (Të dhënat sipas Raportit vjetor të Avokatit të Popullit, Tiranë 2019).

I.4. Roli i sigurisë kombëtare në mbrojtjen e të drejtave njerëzore

Republika e Shqipërisë është demokraci parlamentare, kushtetuese. Kultura kombëtare në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, është epruveta ku proceset dhe simbolikat e jetës, bashkohen për të krijuar një botëkuptim të ri për realitetin ndryshe në jetën social-politike të vendit. Pavarësisht ndikimit të kanuneve, pleqësive, traditës zakonore, ligjeve të reja kombëtare e ndërkombëtare, koha po provon mospërshtatjen e modeleve të përgjithshme jashtë kontekstit të traditës, e cila ka rrënjë të thella në vetëdijen njerëzore dhe psikologjinë e veprimit të saj.

Nga vende të zhvilluara, edhe pse kanë ndjekur rrugë të përcaktuara dhe mbështetura nëimazhet dhe vlerat e demokracive perëndimore, edhe pse nuk kanë mbetur prapa sistemit ligjor dhe juridik ndërkombëtar, ato vazhdojnë të ndeshen me probleme serioze dhe delikate në fushën e mbrojtjes së të drejtave njerëzore. Sipas këtij modeli, Shqipëria postkomuniste e ka zgjedhur rrugën drejt qasjeve të reja. Mbështetja e brendshme shoqërore për këto sisteme, ka qenë e padiskutueshme, por kjo nuk ka shmangur pyetjet që trajton analiza e ballafaqimit mbi realizimin e konstrukteve juridike dhe shoqërore që zbaton kodi i të drejtave të njeriut në Shqipëri, sipas standardeve bashkëkohore të demokracisë perëndimore.

Ende mungojnë studimet e thelluara social-psikologjike, mbi pasojat në mosrespektimin e të drejtave të njeriut, si bazë e funksionimit të sistemit shoqëror në demokraci. Korrupsioni, lidhjet klanore, feja, kultura, vlerat, traditat, veprimi i kulturës me rritje të vonuar etj., janë shkak i

ndikimeve me karakter publik. Identiteti i shtetit është i prekur drejtpërdrejtë nga numri i rasteve të denoncuar nga institucionet ndërkombëtare dhe vendore, mbi shkeljen e të drejtave njerëzore, të cilat shkaktojnë pasiguri sociale me ndikime në sigurinë publike dhe kombëtare. Përsa kohë shfaqen këto fenomene, shteti dhe siguria do të kërcënohen nga faktorë të tjerë joshitetërore, të cilat luftojnë për mbrojtjen e të drejtave njerëzore, pa marrë parasysh se sfera e sigurisë duhet të përballlet me fenomenin dhe pasojat e saj.

Shqipëria postkomuniste në sistemin e demokracisë, ende nuk ia ka arritur të ndërtojë psikologjinë e vlefshme për mbështetjen dhe forcimin e vetëdijes qytetare në drejtimin e shtetit dhe respektimin e koncepteve të sigurisë publike dhe kombëtare. Klasa politike pretendon në fitoren e demokracisë, duke harruar që Shqipërinë e kanë braktisur mbi 2 milionë njerëz, si forca energjike e fuqisë kombëtare. Arsyeja e braktisjes nuk është vetëm ana ekonomike, por mendimi konstant mbi mungesën e drejtësisë dhe pasigurinë e jetës në Shqipëri.

Shembull: Republika e Shqipërisë është model i keq në botë, në masivizimin e emigracionit ($\frac{1}{2}$ e popullsisë). Në 27 vite nuk është parë dhe nuk ekziston mundësia e riatdhesimit. Ata janë pjesë aktive e fuqisë kombëtare. Në raportin e OKB-së, *“Shqipëria renditet në vendin e 116-të për popullsinë më të palumtur në botë”*, (<https://siu.scan-tv.com/shqiperia-vendi-me-i-palumtur-ne-rajon>) shkak i braktisjes së vendit, si element i patrajtuar në kushte specifike. Ky fakt nuk është dashamirës ndaj planifikimeve burokratike të politikës. Justifikimet janë thjeshtë propagandë partiake në interes të pushtetit politik.

Rëndësia e trajtimit të problemit qëndron në ndihmesën që duhet të jap shteti nëpërpunimin dhe përsosjen e metodologjisë së studimit të mbrojtjes së të drejtave të Njeriut dhe ndikimeve që ato japin në fushën e sigurisë në raportet me individin-qytetar, nëpërmjet gnoseologjisë, si disiplinë filozofike që parashtron mundësitë, vëllimin e çështjeve psikologjike, të vërtetësisë dhe kritereve të njohjes së tyre. Si vepron kjo mendësi dhe a është e mundur njohja thellë e psikologjisë së individit-qytetar në raport me kërkesat e psikologjisë shoqërore dhe çështje të tjera të mbrojtjes së të drejtave dhe sigurisë kombëtare? A janë të plota detyrimet që rrjedhin nga Kushtetuta dhe Dokumenti i Strategjisë së Sigurisë Kombëtare, duke i parë gjërat të ndërthuruara në kohë dhe në perspektivë, nga efektet negative që përcjellin në mjedisin shqiptar?

Themeli i suksesit individual është liria për të zgjedhur mënyrën e jetesës dhe jo afërsia me qeverisjen dhe pushtetin politik. Sot kontrata e qytetarit me kombin, shtetin dhe fuqinë kombëtare ka pësuar krisje dhe pasiguri. Është qëndrim naiv mendësia mbi planifikimet strategjike sipas

koncepteve që koha i ka lënë pas. Me objektiva të qarta, kemi detyrimin akademik, intelektual dhe kombëtar të gjejmë rrugët më të mira drejt mjeteve dhe mundësive që gjenerojnë elemente të fuqisë kombëtare dhe t'i përshtatim ato në funksion të qëllimit. Propaganda dhe simbolet, parrullat dhe thirrjet populiste nuk do të kenë pritshmëri pozitive në ndryshimin psikik të individit sipas dëshirës së politikës. Këtu kemi prekur një problem delikat, mbi të cilin burojnë elemente të rëndësishëm të fuqisë kombëtare. Në raport me jetën, tokën dhe natyrën, njeriu po rrezikon ekzistencën e tij.

Çështjet kryesore që garantojnë mbrojtjen e të drejtave të njeriut, kanë të bëjnë me seriozitetin në trajtimin ligjor të tokës, sigurisë njerëzore, mjedisit, ekonomisë, burimeve të akumulimit, burimet dhe hapësirat ujore, kundër dhunimit dhe keqpërdorimit, të cilat në kompleks janë pasuri individuale e kombëtare, janë baza e jetës dhe sigurisë së saj, janë garanti ku shteti dhe qytetari kanë mbështetur kontratën mes tyre. Baza e veprimit në Shqipëri për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të individit, do të mbetet garantimi i sigurisë njerëzore. *Keqpërdorimi i tokës dhe pasurive natyrore, janë katastrofa më e madhe që po shkarkon efekte negative në sigurinë njerëzore.* (Abazi. Sulejman. 2019:101). Shëndeti publik rëndohet sistematikisht, energjia më vitale e kombit (rinia) emigron jashtë.

Mjafton dhunimi i hapësirës detare, mjafton një fatkeqësi natyrore, katastrofë në ekosistem, një reagim qytetar, përplasje politike, dhe së fundi goditja nga pandemia, për të kuptuar *“fuqinë reale dhe seriozitetin”* e politikës dhe shtetit në sigurinë e jetës publike. *“Masivizimi i emigracionit, mosndalja e hemorragjisë demografike dhe pamundësia e riatdhesimit, në perspektivë do të kërkojnë shkaqet dhe përgjegjësitë mbi shkeljen e të drejtave njerëzore. Lëvizjet urbane mbeten të pakontrolluara. Ato diktojnë mbi sigurinë njerëzore. Raportet mes tendencave, ndryshimeve në psikologjinë e individit, mbeten një fushë social-psikologjike e pastudiuar.* (Abazi. Sulejman, 2019:94).

Çështjet e sigurisë në raport me të drejtat njerëzore marrin karakter të gjerë. Kategoritë filozofike i japin kuptim sigurisë, si energji mbi të drejtat njerëzore dhe territorin. *“Koncepti duhet të reformohet, të ristandardizohet në raport me shfaqjen e kërcënimeve dhe rreziqeve, duke i rikonceptuar sipas efektivitetit në parandalimin e tyre”.* (Abazi. Sulejman, 2019:104). Koha dëshmon se këto dy elemente, janë vënë përballë njëra-tjetrës. Ato po modelojnë kontradiktën midis të drejtave të njeriut, natyrës dhe pasurive nëntokësore (tokës, mineraleve, naftës, ujit, bioteknologjisë etj.).

Lëvizjet demografike të pakontrolluara, janë burim konfliktesh të brendshme. Konflikti politik mes qytetarëve thëllon përçarjen, si rrezik i fshehur me efekte prapavepruese. Mundësia e rikthimit të konflikteve të brendshme është kërcënim i drejtpërdrejtë i sigurisë publike. Dezinformacioni në opinion po shton rrezikun ndaj sigurisë. Ndotja masive e mjedisit mbetet synim terrorist. Rritja e konflikteve sociale shfrytëzohet prej strukturave të krimit, duke u kthyer në kërcënim serioz për prishjen e ekuilibrave religjiozë. Mosrespektimi i ligjeve dhe shkelja e të drejtave njerëzore, po kthehet në kërcënim ndaj rendit kushtetues. Përhapja dhe pamundësia e mbledhjes së armëve dhe municioneve, sjellin rreziqe të përditshme. Shqipëria vazhdon të përballet me kërcënime dhe rreziqe të vërteta, të cilat dhunojnë jetën e brendshme të qytetarëve dhe interesat kombëtare, qoftë dhe “*në mënyrë të pjesshme*”. (Abazi. Sulejman, 2019:73).

Me këtë paraqitje të fenomeneve dhe dukurive negative, nuk po sjellim diçka të re, sepse sfidat në fushën e të drejtës kanë qenë dhe janë të pranishme. Në paraqitjen komplekse duhet të ruhet balanca për zbatimin e ligjit dhe respektimin e të drejtave të njeriut, sipas konventave ndërkombëtare. Pranimi i kushteve juridike që garantojnë të drejtat njerëzore, nxit detyrimet për shtetin shqiptar. Papërshtatshmëria e ligjeve aktuale për të vepruar nëformat e reja të aktiviteteve antishoqërore, mbi shkeljen e të drejtave, si dhe mangësitë e ligjeve ekzistuese penale, krijojnë sfidën për sigurinë e jetës sociale dhe publike të qytetarëve shqiptarë.

Shembull: Sipas të dhënave, vitet e fundit krimi kompjuterik ka tregues në rritje. Sipas raportit të Prokurorisë së Përgjithshme, gjatë vitit 2016 janë hetuar 147 raste të kësaj vepre penale, me 11 persona të dënuar. Po këtë vit, janë konstatuar 64 ndërhyrje të paligjshme, 54 raste të mashtrimit kompjuterik, me 7 persona të dënuar. Sipas të dhënave zyrtare, 74% e procedimeve janë kryer në Tiranë dhe vetëm 6 % në Shkodër dhe në Vlorë dhe 80% e të pandehurve janë me arsim të mesëm, ku 95% e tyre rezultojnë të padënuar më parë. (Raporti Prokurorisë së Përgjithshme RSH, 2016, (burimi: <https://www.itproportal.com/news/cybercrime-is-now-a-global-worry/>).

E krahasuar në kohë, në Shqipëri lufta kundër krimit kompjuterik është në fillesat e saj. Sistemi bankar shqiptar, nga sistemet e para të kompjuterizuar plotësisht në vend, është më i rrezikuari, pasi përfitimi nga ndërhyrja në këto sisteme është më i madh. Domosdoshmëria e bashkëveprimit të ngushtë me institucionet ndërkombëtare si, Europoli dhe Interpoli, shkëmbimi i informacioneve mbetet aspekti kryesor, sepse në shumë raste krimi kibernetik lidhet drejtpërdrejtë me krimin e organizuar ndërkombëtar dhe dhunon të drejtën njerëzore. Duke e konkterizuar aq sa pranohet në studim, (programet konkrete u takojnë institucioneve përgjegjëse), çështja e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Shqipëri, mund të rishikohen në dy drejtime kryesore:

Së pari; Siguria njerëzore dhe ajo publike duhet të reflektonjë masat konkrete të protagonizmit mjedisor që lidhen me pronën, të drejtën e punës, në dobi të rritjes së fuqisë kombëtare. Është domosdoshmëri kombëtarizimi i të drejtave universale, të cilat burojnë dhe reflektojnë në jetën e brendshme të shoqërisë dhe të shtetit.

Së dyti, plotësimi i infrastrukturës ligjore juridike, nuk ka të bëjë vetëm me zhvillimin e mendimit dhe të kulturës, por me rritjen e mundësive në zbatimin e koncepteve bazë të garancive mbi jetën dhe territorin ku banon popullsia shqiptare. Parashikimi sjell detyrat për institucione të tjera ekzekutive, të cilat me politikëbërje të studiuara, mund të investojnë fondet buxhetore në jetën shqiptare me qëllime të shumëfishta.

KAPITULLI I II

II. Të Drejtat e Njeriut në mjedisin Social-Politik Shqiptar

Njeriu nuk ka hequr dorë nga lufta. Supershtetet shformëzojnë dhe delegjitojnë qëndrimet, për shkak të konfliktit të interesave. Përballë tyre, kombet dhe shtetet e vegjël ndihen të përbuzur, të shtypur, të dhunuar. Mosmarrëveshjet kanë sjellë konfliktin në vetëdijen dhe psikologjinë e popujve. Parashikimi është i vështirë, përballë aksioneve politike dhe ushtarake, duke dobësuar pavarësinë e popujve. Mekanizmat humanitare të ndihmës, përdoren për diktat dhe pranime pa kushte. Dilema e mijëvjeçarit të ri, shfaqet në procesin e globalizimit, (ecën me të), si konflikt përfshirës dhe përjashtues. Këto nuk janë hamendje mbi teori ripërtypëse, si të njohura dhe të trajtuara më parë, me tendenca drejt vlerave të kapëcyera në kohë. Pandemia e vërtetoi këtë, e po kështu së fundi lufta në Ukrainë.

Popujt dhe kombet janë pjesë e Historisë. Ata nuk duhet të lejojnë risjelljen shkatërruese ndaj territoreve të sunduara në skajshmëri, që po i nënshtrohen proçesionit të rindarjes, kundër ribërjes dhe kundër përplasjes me përplasje. Intensiteti i jetës po përplas ashpër simbolet, kombet dhe popujt, pa ndryshuar rendin e energjisë së nevojshme për të. Nxitësit botëror mundohen ta kalojnë në heshtje tronditjen e rendit planetar. Asgjë nuk është asgjësuar, ndërsa fillimi i shekullit të XXI

ka hedhur shikimin në transformimin e radhës. Në konceptin filozofik dhe praktik për jetën planetare, *“drejtësia gjendet vetëm midis atyre, ku marrëdhëniet reciproke të të cilëve kontrollohen nga ligji. Ligji gjendet vetëm midis atyre, të cilët janë të prirur për padrejtësi”*. (Aristoteli, 2001:147). Në funksion të qëllimit, sot në bazën e ndryshimit të raporteve dhe të marrëdhënieve sociale po ndikojnë ndryshimet teknologjike dhe forcat e reja prodhuese, të cilat në përballje kanë nevojë për rregulla të reja loje.

II.1. Koncepti filozofik dhe psikosocial i mbrojtjes së të Drejtave Njerëzore

Pas vitit 1992 në Shqipërinë poskomuniste u vendos sistemi i pluralizmit politik dhe u fituan gradualisht me bazë ligjore të drejtat dhe liritë e individit. Parimi i sigurisë politike u normëzua, duke e kaluar peshën tek siguria dhe liria e individit, në shoqëri të lirë dhe të hapur demokratike. Gjatë periudhës “92-97”, sigurisë politike filluan t’i kufizoheshin dhe t’i mungonin treguesit cilësorë, si përvoja e pamjaftueshme e shtetndërtimit në kushte të tjera, mungesa e pjekurisë demokratike, të cilat ndikuan tek treguesit e tjerë të jetës social-politike dhe ekonomike të individit dhe të shoqërisë. Vendi u përfshi në kriza të njëpasnjëshme. Efektet negative vazhdojnë të ndihen edhe sot. Periudha e tranzicionit kërkoi nevojën e rivlerësimit të masave për përballimin e kërcënimeve të ndryshme ndaj të drejtave njerëzore, sigurisë individuale politike, ekonomike, sociale dhe mjedisore.

Në pamje tjetër, u transformua drejtimi nga i centralizuar shtetëror partiak në trajtimin e të drejtave, lirive themelore dhe të sigurisë, në një koncept të ri që mbështetej në të drejtat e njeriut-individ. Sistemi i edukimit në një shoqëri të hapur, ushqen ndjenjën e atdhedashurisë në qëndrimin qytetar ndaj të drejtave për të jetuar të lirë dhe të sigurtë. Këtu reflekton vetëdija kombëtare e qytetarit, vlerat e besimit ndaj të drejtave, ligjit, shtetit, kundër ndasive dhe diferencimeve sociale, të cilat burojnë nga pabarazia në trajtimin e të drejtave njerëzore.

Kundër etikës kombëtare, sot shëndeti moral i shoqërisë shqiptare pak e pranon realitetin, ku e drejta kushtetuese dhe ligjore, të drejtat dhe liritë themelore individuale, ushqejnë krizën e besimit përballë cënimit të sigurisë. Në edukimin qytetar mbi konceptet e mbrojtjes së të drejtave njerëzore, disa koncepte bazë mbi nocionin, përmbajtjen, parimet dhe misionin e mbrojtjes së tyre në shkallë kombëtare, duhet të bëhen pjesë programore në sistemin arsimor të edukimit qytetar dhe juridik. Ato duhet të rekomandojnë njohjen e fjalorit të domosdoshëm, që shoqëron konceptin bazë të mbrojtjes së të drejtave njerëzore, pjesët përbërëse të saj, si pjesë integrale të edukimit

qytetar në shoqërine e hapur demokratike. Sundimi i të drejtës ligjore garanton bashkërendimin për mbrojtjen e tyre brenda shtetit demokratik. Ai garanton respektin që shoqëria demokratike i rezervon zbatimit të ligjeve dhe punës së institucioneve demokratike ligjzbatuese, të nënshtruara ndaj kontrollit juridik të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Konceptet bazë filozofike, psikologjike e juridike, mbështeten në marrëdhëniet, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, në vijueshmëri ligjore të harmonizuara me veprimtari në institucionale juridike dhe strukturave të drejtësisë dhe sigurisë. Ato duhet të shërbejnë si elemente të edukimit qytetar, të cilët japin hapësira të gjera për mbështetjen dhe funksionimin e tyre. Shëndeti moral i shoqërisë shqiptare pak e pranon realitetin, sipas të cilit, e drejta kushtetuese, e drejta individuale, përballë neglizhencave të cënimit të tyre, ushqejnë krizën e besimit në opinionin qytetar dhe persekutojnë psikologjikisht individin.

Individi duhet të dijë dhe të respektojë të drejtën “*e përgjimit*”, interceptimin e komunikimeve me individë dhe rrjete të dyshimta, luftën kundër sulmit kompjuterik që cënon të drejtat e tij, kontrollin e letrave personale të dyshimta, ndjekjen e dokumenteve fonologjike dhe fotografike si prova materiale etj., të cilat janë veprimtari institucionale të garantuara me akte ligjore e nënligjore, që nuk cënojnë të drejtën personale. Respektimi i konceptit nuk ka të bëjë me aktin formal. Të drejtat e njeriut dhe liritë janë kategori universale të patjetërsueshme. Nëse këtu abuzohet, shoqëria ndodhet përballë kërcënimit shoqëror e shtetëror. Kur individ i përfshihet në rrjetet e trafikimeve, materialeve të rrezikshme biokimike, terrorizmit, kur ai cënon të drejtat e individëve të tjerë, atëherë në këtë rast, aktet ligjore që rregullojnë dezëharmoninë sociale, ekonomike dhe politike, hyjnë në veprim. Sa të përgjegjshëm janë qytetarët shqiptarë për këtë?

Këto dukuri kundër jetës dhe shëndetit moral të shoqërisë, i nënshtrohen vullnetit të shumicës dhe institucioneve ligjzbatuese në mbrojtje të të drejtave njerëzore. Edhe pse në pamje sjellja institucionale figuron si shkelje e të drejtës personale, ato duhet të denoncohen, bllokohen dhe njerëzit që merren me to duhet t’i nënshtrohen drejtësisë para ligjit. Praktika ndërkombëtare sjellë shembuj të pranisë së akteve ligjore për kufizim të drejtash, kur është fjala për sigurinë shtetërore dhe qytetare. Edhe siguria publike, është shumë afër mbrojtjes së sigurisë kombëtare (*shtetërore*) dhe është vështirë të ndahen konceptualisht. Mundësitë në këtë fushë, më së shumti përcaktohen si përkufizime të të drejtave dhe lirive të individit për interes të sigurisë kombëtare dhe asaj publike.

II.2. Të drejtat njerëzore, individi, edukimi dhe pritshmëritë.

Në parim, mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut nëpërmjet institucioneve juridike të Drejtësisë dhe elementeve të sigurisë kombëtare dhe asaj publike, rezultojnë në masat e lejuara, që pushtetet legale mund të veprojnë kundërt lirive dhe të drejtave, në mbrojtje të tyre dhe në interes të sigurisë shtetërore e individuale. Liria e të shprehurit në Konventën Evropiane, ndër të tjera kufizohet në interes të “*integritetit territorial ose të sigurisë publike*”, sipas të cilave bëhet e ditur publikisht ndërthurja brenda tyre, e koncepteve bazë juridike të sigurisë. Sipas kësaj, disa liri dhe të drejta njerëzore, (*publik orden*), mund të kufizohen në interes të rendit kushtetues, të edukimit qytetar dhe shtetit demokratik. Problemi trajtohet i orientuar veçanërisht në misionin e sistemit arsimor të mesëm dhe universitar, në funksion të familjarizimit me çështjet e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duke prekur një dimension delikatë të kohës së sotme në Shqipërinë postkomuniste. Kështu:

- U trashëguua sistemi arsimor i ngarkuar ideologjikisht dhe politikisht. Ai gradualisht kaloi në sistemin e reduktuar programor, si nevojë e unifikimit të moralit të doktrinë së mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe të integritetit evropian, i papërgatitur të përballonte ndryshimet.
- Mendimi i sunduar nga konfliktet emocionale mbi sukseset e reformimit të shoqërisë në fushën e të drejtave njerëzore, sjellja psikike me simptoma interesi kundër solidaritetit me ligjin dhe individin, u orientua drejt sistemit arsimor të zhveshur nga kultura dhe edukata qytetare mbi demokracinë. Idetë nuk mungojnë, sepse vijnë nga përvojat, dështimet, problemet në rritje për t’i bërë gjërat mirë, por në fakt shpesh janë bërë disa gjëra keq.
- Trashëguam logjikën dhe metodën autoritariste, të cilat thelluan mangësitë në edukim mbi të drejtat njerëzore. Ato u karakterizuan nga diktati dhe ndërhyrjet e individëve të veshur me pushtet, duke cënuar lirinë e mendimit në doktrinat përfshirëse dhe përjashtuese në sistemin edukativ. Adaptimi dhe përshtatja e koncepteve të reja të kulturës qytetare mbi të drejtat njerëzore u shfaqën të vonuara.
- Në kërkim të modelit të edukimit në mbrojtjen e të drejtave njerëzore, sjellja e qytetare iu nënshtrua formave dhe metodave të nxitura nga dhuna psikologjike dhe deformimi mediatik, duke i dhënë hapësirë kronikës së zezë.
- Programet psiko-pedagogjike nuk e orientuan në kohë shkollën në krijimin e strategjisë së edukimit në kohë dhe hapësirë, për të zgjeruar ndikimin pozitiv përmes rritjes së njohurive

teorike e metodike në fushën e të drejtave njerëzore. Mbrojtja juridike e të drejtave të njeriut dhe nxitja e klimës së besimit, kanë nevojë për kontributin e qytetarëve.

Këto pritshmëri burojnë nga shkalla e njohjes së qytetarëve mbi mbrojtjen e të drejtave të tyre. Në këtë aspekt, pak gjëra mund të jenë të pranishme, me të cilat mund të pranojmë vlerat që përcjellin dokumentet fundamentale kushtetuese dhe ligjore e nënligjore në opinionin shqiptar. Formalisht sundimi i të drejtës ligjore, garanton bashkërendim nështetin demokratik. Por kemi dhe një kategori tjetër. *“Midis identitetit të pandryshueshëm në diktaturë dhe identitetit të çliruar në demokraci, sipas konceptit të lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, ekziston e pashmangur qenia e pavarur”*. (Abazi Bashkim, 2013:182). Këto qenie të pavarura janë protagonistët kryesor të ngritjes së zërit kundër pabarazive, shkeljeve dhe diskriminimit. Një arsye më shumë pse kjo kategori njerëzish në Shqipërinë postkomuniste u ndjenë të lirë, të barabartë dhe të drejtëpërdrejtë. Sundimi i të drejtës, të lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, është respekti që shoqëria i rezervon individit përballë zbatimit të ligjeve prej institucioneve, të nënshtruara ndaj kontrollit civil.

Lejimi i shkeljeve dhe privilegjeve ndaj individëve të veshur me pushtet dhe vendimmarrës në jetën politike e juridike, është dhunimi ndaj respektimit të së drejtës ligjore qytetare, për t'u përfshirë masivisht në mbrojtjen e të drejtave të tyre legjitime dhe politikëbërje. Reformimi i programeve në interes të sistemit të edukimit për mbrojtjen e të drejtave njerëzore, është sfidë e fortë për sistemin politik në Shqipërinë postkomuniste. Kultura qytetare që buron nga sistemi i edukimit për respektimin e të drejtave njerëzore, barazisë para ligjit, kushtëzon veprimtarinë e shtetit demokratik.

II.3. Pandemia dhe të drejtat e njeriut sipas Konventës Evropiane

Ndikimi i situatës pandemike me pasoja në shkallë globale, tashmë është bërë ritual i përditshëm i organizimit dhe administrimit të jetës së njeriut, duke diktuar format e jetës jashtë të zakonshmes, të motivuar ekstremisht nga nevoja e ruajtjes së saj. *“Ndryshimi i diktuar nga koronavirusi duket një vuajtje e vështirë për t'u përballuar, edhe pse njerëzimi ka kaluar edhe më keq”*. (Umberto Galimberti, 2020, Shqiptarja.com). Në situatë kritike, jeta po kthehet brenda qënies humane në garë mbijetese, ku fobia, ankthi, durimi, këmbëngulja e përballimit të vetë karentinimit apo karentinimit të detyruar, imponon ecjen e ngadalshme të jetës përmes presionit psikologjik, mes optimizmit dhe pesimizmit mbi të ardhmen.

- Çfarë po ndodh dhe çfarë do të ndodhë me njeriun në botë, në raport me të drejtat e tij për jetën?!
- A jemi në gjendje dhe të përgatitur, për ta përballuar situatën psikologjike me pasoja ekstreme?!
- A duhet të besojmë se jeta jonë nuk do të jetë më si më parë?!

Dilema ka marrë përmasa globale. *“Kujtonim se kontrollonim gjithçka, ndërkohë që nuk kontrollojmë asgjë”*. (Umberto Galimberti, 2020, Shqiptarja.com). Perceptimi i njeriut për jetën dhe mjedisin që e rrethon, nevoja e detyrueshme për të vendosur raporte të reja me vetëveten, jetën brenda familjes dhe marrëdhëniet sociale, po diktohet nga faktorë të tjerë, të cilët brenda natyrës psikologjike imponojnë ndryshimin. Atëherë, çfarë duhet bërë? *“Nuk ka asgjë për të bërë, ka vetëm për të pësuar”*. (Umberto Galimberti, 2020, Shqiptarja.com). Konstatimi është fatalitet. Dimensioni shpirtëror që nxit virtytet më të mira njerëzore, në këtë kohë ka pësuar krisje të fortë. Njeriu ndihet i pasigurtësepe është mënjeluar ndjenja e dashurisë, paqes dhe solidaritetit njerëzor, duke i dhënë përparësi interesit. Njerëzit e prekur nga coronavirusi ia dorëzojmë spitalit, duke u mohuar dashurinë tonë për të fuqizuar forcën e shpirtit kundër të keqes.

Në dilemë janë vënë drejtpeshimi psikologjik, karakteri dhe personaliteti i njeriut, jeta e tij, duke imponuar pa dëshirë kërkesa të tjera *“të egra dhe të pamëshirëshme”*, (Umberto Galimberti, 2020, Shqiptarja.com), siç është vetë natyra e virusit vrasës Covid-19. Në kushtet e terrorit psikologjik, të frikës ndaj vdekjes, po vlerësohet më shumë ana e jashtme e jetës sesa bota shpirtërore, e cila duhet të jetë atribut i fuqishëm i edukimit shpirtëror, akademik dhe shoqëror.

Sipas Konventës Evropiane, “Shtetet kanë një detyrim të përgjithshëm sipas KEDNj-së për të marrë masat e duhura për të mbrojtur individët nga përhapja e Covid-19 dhe infektimi i shmangshëm dhe nga vuajtja e pasojave të tij. Këto detyrime dalin kryesisht nga Nenet 2 (E drejta e jetës), 3 (Mbrojtja nga trajtimi çnjerëzor dhe poshtërues) dhe 8 (E drejta për respekt ndaj jetës private dhe familjare)”. “E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj. Askujt nuk mund t’i merret jeta qëllimisht, me përjashtim të rastit kur zbatohet një vendim gjyqësor me vdekje, pas dënimit për një krim për të cilin ky dënim është parashikuar me ligj”. (<https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2020/20/covid-guide-alb.pdf>).

Sot kemi humbur lidhjen konkrete me dhimbjen, negativitetin dhe me fundin e jetës së njeriut. Një arsye më shumë për t’u shfaqur zbuluar, përballë të keqes që ka kapur jetën e njeriut. Dilema po përballlet me mosbesimin, pamundësinë, deri në dorëzimin përpara të keqes, duke u ballafaquar në vetëdije me aftësitë e botës moderne, zhvillimi teknologjik i të cilës nuk mund ta justifikojë

situatën e rrezikut ndaj jetës. Njeriu me mundësitë teknologjike dhe inteligjencën po eksploron kozmosin. Çfarë e pengon që ai ta ketë jetën të sigurtë në tokë? “...jemi në gjendjen në të cilën i gjithë evoluimi ynë, teknologjia, globalizimi, tregu, me pak fjalë gjithçka me të cilën mburremi, dhe e quajmë përparim, papritmas e gjen veten duke u marrë me ekzistencën bazike njerëzore....përballë të papriturës”. (Umberto Galimberti, 2020, Shqiptarja.com)

Çdo ditë e më shumë njeriu po kupton dhe po bindet se, jeta e njerëzimit është futur në perceptim të ri, drejt ndryshimit sasior dhe cilësor, drejt “hapit të madh”, nëse do ta vlerësojmë në mënyrë racionale si të tillë. Kjo sot është detyra e shoqërisë dhe Pedagogjisë Humane, e cila në kushte të reja imponimi duhet t’i kapërcejë parametrat pedagogjik të strukturës së zakonshme të edukimit dhe arsimimit të brezave. Me sa duket, duhet të besojmë që në këtë kohë frika ndaj së panjohurës është rritur, së bashku me frikën e sjelljes dhe imponimit të paplanifikuar të perceptimeve të reja të jetës dhe sjelljes tonë në të ardhshmen.

Dimensioni social në këtë rast ka marrë hapësira më të mëdha. Virusi ka ndikuar në transformimin e sjelljes njerëzore, ndrydhjen e traditave mbi jetën, në tentative për të gjetur mundësi objektive për të kapëcyer pasojat e izolimit. Në shumë raste, njerëzit kanë filluar të ndihen të huaj me njeri-tjetrin. Mbyllja e mjediseve me karakter social, jep ndikime negative në prishjen e raporteve mes jetës familjare dhe sociale, duke ngushtuar njëkohësisht mënyrën e të menduarit. Edhe pse në shoqëri të zhvilluar dhe me përparësi teknologjike, shtresat sociale po thellojnë hendekun e marrëdhënieve mes tyre, duke i shkarkuar pasojat në shmangien e veprimtarive sociale, edukative, argëtuese, përballëpasojave që tkurrin sistemin arsimor pedagogjik.

Mungesa e komunikimit midis shtresave shoqërore, po rrit nivelin e varfërisë. i izoluar, njeriu po mbetet pa punë. Sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar, përqindja e njerëzve të papunë ka arritur në 10.4%, një sinjal i fortë ky, që e ka bërë njeriun të mendojë për fundin e një epoqe dhe nevojën e përfshirjes në epokën e re të jetës së njerëzimit, “me ndryshime themelor në të gjithë ekonominë botërore”. (By Lora Jones, Daniele Palumbo&David Broën, <https://www.unic.ac.cy/da/2020/05/08/coronavirus>)

Jeta e njeriut përballet me kufizime, të cilat në shumë raste rezultojnë të diktuar me dhunë, që cënuan rëndë të drejtat njerëzore. Vlerësimi vjen nga Forumi për të Drejtat e Njeriut në Evropë, i cili u fokusua tek impakti mbi të drejtat e njeriut në kushtet e veprimit të Covid-19. Bota u zu e papërgatitur për të trajtuar pasojat e pandemisë. Vendet e Ballkanit Perëndimor nuk bëjnë përjashtim. Pandemia ka prekur shumë nga të drejtat dhe liritë e njeriut që mbrohen nga Konventa

Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Kjo ka ngritur mjaft probleme të vështira ligjore. Elementet më të spikatura të situatës kufizuese kanë natyrën e tyre aktive:

“Karantina”, është termi që përdoret për të përshkruar masat e marra ndaj individëve të caktuar ose anëtarëve të grupeve të caktuara të cilët janë identifikuar si të tillë, që vuajnë nga virusi ose të cilët dyshohen të jenë bartës faktikë ose të dyshuar të tij. Njerëzit në karantinë kufizohen në brendi të hapësirës së kufizuar, nuk lejohen të largohen prej aty për asnjë arsye deri sa të kalojë rreziku për të tjerët. Karantina shkon përtej kufizimeve të *“mbylljes brenda”* dhe mund të përbëjë kufizim të lirisë, në varësi të shumë faktorëve.

“Mburoja”, (ose mbrojtja) përshkruan praktikën e mbrojtjes së individëve klinikisht të prekshëm nga Covid-19, të cilët, nëse infektohen, rrezikojnë të sëmuren rëndë. Ata këshillohen nga ligji të mbrojnë vetëveten prej njerëzve të infektuar. Kjo ka të bëjë me distancimin fizik dhe social, duke shmangur daljet në mjediset e jashtme. Ndryshe nga masat e distancimit social, mbylljes brenda dhe karantinës, mburoja (mbrojtja) përgjithësisht bëhet për mbrojtje personale individuale.

“Distancimi social”, përshkruan udhëzimet që minimizojnë kontaktet, e rrjedhimisht rrezikun e transmetimit përmes kontaktit. Organizata Botërore e Shëndetësisë rekomandon distancën prej së paku një metër mes individëve në shtëpi. Udhëzimet për distancim social në Evropë dallojnë mes shteteve nga një deri në dy metra. Individët dhe bizneset mund të marrin gjoba për mosrespektimin e distancimit social.

Pandemia ka rritur nivelin e vetëvrasjeve. Pasojat do të kenë efekt të gjatë në jetën e njerëzve. Përveç mbylljes dhe bllokimit, përjetohet dhuna në familje, papunësia, pasiguria, paragjykimet dhe stereotipi. Efektet e padëshirueshme të pandemisë tek njerëzit me sëmundje mendore dhe për shëndetin mendor të popullatës në përgjithësi, mund të përkeqësohen nga frika, vetëizolimi dhe mungesa e kontakteve fizike. *“Rreziku i vetëvrasjes mund të rritet për shkak të stigmës ndaj individëve me Covid-19 dhe familjeve të tyre”*. (Suicide risk and prevention during the Covid-19 Pandemic). Vetësakrifikimi si rasti i pestë në spitalin Infektiv të Tiranës, është dëshmi e traumës psikike të njeriut në kufijtë e depresionit akut dhe vetëvrasjes. Njerëzit për një kohë të gjatë mbajtën kontakt me këshillat virtual të mjekut të familjes. Vetëkurimet u orientuan në banesa pa marrë parasysh koston e lartë për buxhetin familjar. Frika e përballjes me spitalin është ende e pranishme, duke e konsideruar atë si vend të infektuar. Njeriu po konfirmon me këtë rast pasigurinë e tij, frikën dhe dilemën mbi jetën.

Kjo është sfida që shoqëron shtetin shqiptar. Populli dhe institucionet u gjenden të papërgatitur, duke dhënë mësimin e madh në vlerësimin e solidaritetit kombëtar, dinamikës së institucioneve, të strukturave të emergjencës civile, shëndetit publik dhe programeve shkencore, që e përshtatin shtetin dhe popullin me zhvillimet e reja, që imponon beteja e parë e luftës bakterologjike. Është koha të ndryshohet për të gjetur zgjidhjet e së nesërme dhe jo për t'u marrë me të sotmen, e cila ka përënduar. Duke u ballafaquar me situatën e pandemisë, e cila preku jetën e njeriut, me presionin e saj mbi individin dhe shoqërinë, merr vlera parimi Lutërian për të mbrojtur jetëndhe lirinë. Reagimet ndaj kufizimeve vërtetuan njëkohësisht besimin ndaj masave kufizuese, si hapi i parë kundër të keqes në horizont. Në fund nuk do të kujtohen ata që shkaktuan fatkeqësinë, por heshtja e njerëzve që humbën lirinë dhe u pajtuan me skllavërinë. Sot në jetën njerëzore asgjë nuk është më e rrezikëshme sesa përkulja dhe nënshtrimi, përballë dhunës dhe diskriminimit kulturor. Askush nuk mund të ushtrojë diktat mbi vetëdijen individuale e shoqërore. Njeriu do të përballë me fatkeqësinë e tij, ditën që ai do të pranojë të heshtë dhe të nënshtrohet. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, janë të shenjta.

II.4. Të Drejtat e Njeriut në Shqipëri, përballë situatës së Covid-19

Shkelja e të drejtave njerëzore në periudhën e pandemisë, është një fenomen që meriton vëmendje në analizën shkencore të situatës, sepse me veçoritë e saj karakteristike, ajo ka sjellë disa dukuri të reja, të cilat dalin jashtë kuadrit të miratimeve dhe qëndrimeve juridike ndërkombëtare, duke marrë karakter të theksuar kombëtar. Në kushtet e përballjes me koronavirusin e ri (COVID-19), Organizata Botërore e Shëndetësisë e shpalli atë në nivelin e pandemisë, për shkak të përmasave të përhapjes dhe pasojave ekstreme mbi jetën e njeriut. Shoqëria njerëzore e vetëdijshme e detyruar të kufizojnë disa nga liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, e motivuar nga kujdesi për parandalimin dhe minimizimin e pasojave në shkallë globale.

I ndodhur në këto kushte, shteti shqiptar parashikoi gjithashtu një sërë kufizimesh dhe masash, të cilat ndikuan në kufizimin e lirisë duke imponuar distancimin social, si dhe të lirisë ekonomike të individëve dhe subjekteve private, duke parashikuar masa administrative për shkeljen e tyre. Fenomenet e reja që u shfaqën në këtë periudhë delikate, marrin rëndësi në trajtimin e tyre specifik, përballë të drejtave të qytetarëve, duke u ballafaquar me Kushtetutën dhe të drejtën juridike.

Të drejtat e njeriut janë të drejta dhe liri themelore, pa të cilat njerëzit nuk mund të jetojnë si qenie njerëzore me dinjitet. Ato përbëjnë bazën e lirisë, drejtësisë dhe paqes. Respektimi i tyre mundëson emancipimin dhe progresin e plotë të individit dhe shoqërisë. Individët janë persona që gëzojnë të drejtat njerëzore, të sanksionuara në ligjin themelor të shtetit dhe në vlerat morale të shoqërisë. Të drejtat e liritë themelore të njeriut në Shqipërinë postkomuniste u vendosën në fokus të veçantë në Kushtetutën e saj, duke garantuar sigurinë morale, materiale, procedurale, të cilat në çdo kohë janë themeli i sigurisë së brendshme dhe asaj ndërkombëtare.

Përveç vlerësimit dhe renditjes së të drejtave e lirive themelore të shtetasve shqiptarë, nenet kushtetuese kanë krijuar mbështetjen për hapësira ligjore në mbrojtjen e të drejtave dhe respektimin e tyre. Parashikimi për shmangien e kufizimeve apo cënimeve të të drejtave njerëzore, ka lënë hapësirë për të vepruar në raste specifike me rezerva ligjore për interesa publike dhe të sigurisë kombëtare, duke mos prekur thelbin e të drejtave në respektim të kufizimeve të KEDNJ-së, si garanci ndërkombëtare.

Duke mos i afirmuar të drejtat njerëzore në karakterin e tyre absolut, është lënë hapësirë ligjore për kufizimet, si shprehje e respektimit dhe zbatimit të ligjit në interes të shtetit dhe të shoqërisë. E drejta e organeve të drejtësisë për të marrë vendime mbi këto kufizime, mbështete në aktet nënligjore, të cilat në çdo rast mbrojnë të drejtat e njeriut edhe në kushtet e ndëshkimit ligjor. Standardi që kufizon liritë dhe të drejtat e njeriut, parashtron kërkesat e mbrojtjes së tyre në mënyrë ligjore. Kufizimi i të drejtave themelore të njeriut është një interes publik dhe kombëtar, i cili reflekton në mbrojtjen e të drejtave të shumicës. Sipas këtij koncepti themelor, kufizime të tilla kushtetuese mund të bëhen vetëm me ligj; për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve në raport me kushtet dhe rrethanat që e diktojnë atë, pa cënuar thelbin e lirive dhe të drejtave njerëzore, si dhe pa tejkaluar kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Në ballafaqim me zhvillimet në situatën e pandemisë, shumë shtete të fuqishme si, SHBA, Italia, Gjermania, Anglia, Spanja, Brazili, India, Rusia etj, u goditën ashpër nga virusi, duke u gjendur të papërgatitur për t'i dalë të keqes përpara. Paralelisht, shteti shqiptar e çensuroi situatën në mënyrë ekstreme, duke anashkaluar pasojat psikologjike, sociale dhe ekonomike. U nxit formalisht niveli i panikut dhe pasigurisë në masën qytetare. Përdorimi i mjeteve ekstreme të kufizimit, mbyllja e detyruar në mjediset shtëpiake, mbyllja e bizneseve, ndalimi i qarkullimit në çdo orë të ditës dhe natës, vështirësitë në furnizimin minimal të popullsisë etj., sipas akteve

administrative dhe mbështetjes policore e ushtarake nëzbatim, imponuan situatë krejt tjetër nga sa mund të konceptohej nga opinioni qytetar.

Situata bindi opinionin se, asgjë nuk do të jetësi më parë, por shumë rregulla jetese do t'i nënshtroheshin ndryshimit. Të shoqëruara me panik dhe presioni psikologjik mbi qytetarin, shumë masa shtetërore administrative dhe kufizime, në mungesë të përvojës për të trajtuar situata të veçanta, u përfshinë kundërvënien e hapur apo indirekte ndaj të drejtave njerëzore, duke e cënuar rëndë lirinë e individit.

Nxjerrja e ligjeve dhe dekreteve në kohë të shkurtër, ndryshimet kushtetuese dhe në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, në kundërshtim me ligjet e mëparëshme, të imponuara dhe pa marrënë konsideratë se çfarë mendonin njerëzit për jetën e tyre, krijuan një situatë të rëndë psikologjike. Pasojat e veprimit të virusit vrasës bindën shumëshpejtë opinionin publik dhe institucionet ligjvënëse e ligjzbatuese mbi nevojën e masave adekuate dhe të shumëllojshme, në interes të minimizimit të efekteve negative mbi jetën e njeriut, duke qenëtë pafuqishëm për të vepruar me masa të tjera parandaluese nëpërhapjen e tij.

Kundërshtimi i masave nga njerëzit, (si dhe në rastin e tubimeve apo veprimtarive të tjera sociale dhe familjare), mendohet se në Shqipëri ka ndodhur si diçka spontane e vullnetit të politikbërjes, por e krahasuar me vendet e tjera në rajon dhe në Evropë, qëndrimi është tentuar të mbahet në shkallë kombëtare, i cili kërkon një trajtim më të studiuar nga organet qeveritare. Ato nuk mund të mohojnë apo të dhunojnë në mënyrë të njëanshme të drejtat e njeriut dhe liritë edhe në kushte pandemie.

“Kufizimet e vendosura ndaj të drejtave dhe lirive themelore të njeriut sikurse është dhe liria e tubimit, nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ) (Kushtetuta e R. Shqipërisë, 1998: Neni 17), e interpretuar nëpërmjet Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), duke paravendosur si kusht që këto kufizime të jenë proporcionale me gjendjen që e ka shkaktuar nevojën për vendosjen e tyre”. (Raport Avokati Popullit PDF, 2020:116)

Situata kërkon zgjidhje të mesme, kunë luftën kundër pasojave, duke mos trajtuar shkakun dhe natyrën e vërtetë të gjendjes, të merret në konsideratë opinioni dhe vlerësimi qytetar. Kjo do të ndikonte pozitivisht në edukimin dhe krijimin e kulturës së nevojëshme, të pranimit dhe zbatimit të kufizimeve në mënyrë të vetëdijëshme, në interes të ruajtjes së jetës dhe shëndetit publik. Për shkak të akumulimit të pakënaqësive me ndërthurje komplekse sociale, shëndetsore e financiare, qëndrimit të njëanshëm të institucioneve, falimentimit të sistemit shëndetsor përballë nevojave të përballimit të pandemisë, shoqëria dhe vetë institucionet ecën në rrugë të panjohura.

Pavarësisht dhunës dhe diskriminimit ligjor kundër të drejtave njerëzore, qytetarët të ndërgjegjësuar në shumë raste harruan të drejtat e tyre, duke kaluar në fazë tjetër, kalimi dhe nënshtrimi në periudhën e sakrificës për të siguruar jetesën dhe mbijetesën. Përballë realitetit, njerëzit shfaqen skeptik:

- Çfarë lidhjesh dhe raporte krijohen në ekuivalencën midis jetës, mbijetesës dhe të drejtave njerëzore?
- Pse duhet mbajtur akoma njeriu dhe jeta nën kontroll, në kushtet kur institucionet më të larta shëndetsore ndërkombëtare që garantojnë të drejtën e shëndetit publik, nuk janë në gjendje të ofrojnë zgjidhje?
- Kujt i intereson kjo situatë, e cila në raport me të drejtat dhe liritë e individit, e ka kthyer mjedisin social në skllavëri të diktuar?

Vetëm thjeshtë të mendohet se si po i kundërvihen situatat dhe qëndrimet të drejtave njerëzore, në mënyrë arbitrare dhe të pakonceptueshme, është e papranueshme. Njerëzit përballen çdo ditë me konceptin e, “*fundit të botës*”, duke menduar se kjo situatë, do të godasë pa mëshirë jetën e tyre. Larg fatalitetit, situata meriton të shpjegohet, për të marrë kuptimin real të ndikimit mbi jetën e njeriut në raport me të drejtat e tij. Në fakt veprimi i virusit në shkallë globale, po e realizon gradualisht këtë, duke e tkurrur dhe rrudhosur jetën në tokë. Ajo po realizohet në heshtje, hapur dhe fshehur, me dhunë dhe diktat, e pranuar gjithashtu nëpërkulje të pavullnetshme të individit, përballë fuqisë imponuese dhe vrasëse të Covid-19.

Efektet e pandemisë nuk duhet parë si fenomen apoliptik i shkatërrimit prej katastrofës së përgjithëshme, e cila interpretohet qëllimisht për të rritur presionin psikologjik të kapitullimit të njerëzimit përballë saj. Fenomeni duhet parë e vlerësuar në dimensionin tjetër njerëzor. Në presionin e përgjithshëm psikologjik, njerëzimit po i kërkohet sipas kushteve dhe rregullave të tjera, krejt ndryshe nga sadhe si kanë jetuar deri tani. Jeta njerëzore që po lemë pas, po zëvendësohet me rregulla të reja loje, për shkak të degradimit në ndikimin e fenomeneve të reja sociale. Është koha që njeriu të përshtatet me një jetë tjetër, e cila do të jetë ndryshe nga më parë. Po imponohet situatë tjetër social-politike, psikologjike, kulturore, me frikën e asgjësimit në çdo moment nga armiku i padukshëm, me ndryshimin e traditës, izolimin, ndryshimin e mënyrës së jetesës, arsimimit, me përfshirjen masive on-line etj.

Situata imponon hapësira ndryshimi dhe kufizimi të padiskutueshme të të drejtave dhe lirive individuale, të imponimit të inteligjencës artificiale, të vaksinave, etj. etj. Koha dhe sistemi po imponohet me dukuri të reja, që formalisht mund të vlerësohen si antihumane, por njeriu është i

detyruar të mësohet dhe përshtatet me to. Në mënyrë të imponuar në këtë situatë të veprimit të pandemisë, paketa ligjore që pësoi më shumë ndryshime, është pikërisht transformimi me ligj i shumë akteve dhe nën akteve ligjore e administrative, të cilat e shkarkojnë peshën e tyre mbi të drejtat njerëzore në jetën e individit dhe të shoqërisë.

Kalimi në një tjetër mënyrë jetese me ndikimet psikologjike e sociale, do të kërkojë shumë kohë, por njëkohësisht do të shkarkojë mbi individin dhe shoqërinë kosto të madhe, e cila do të shoqërohet me pasojat e përshtatjes në raport me ndryshimin e marrëdhënieve shoqërore, të forcave të reja prodhuese, të ndërtimit të marrëdhënieve të reja ekonomike e financiare dhe të prurjeve të teknologjisë, të cilat në një farë mënyre vendosin rregulla të reja mbi shoqërinë njerëzore.

Pasojat do të shkarkohen mbi brezin e ri të kohës. Kursi politik kontradiktor midis frymës konservatore dhe asaj neolibérale (globaliste) në sistemin politiko-social global, ndjekin zhvillimet dhe përplasjet me ndikim global, duke iu drejtuar mjeteve imponuese inteligjente për ti dhënë jetës së njeriut një natyrë tjetër nga më parë. Bota në mënyrë të pavullnetshme nën këtë presion psikologjik, është e detyruar të kthejë vëmendjen dhe të mbajë frymën, përballë ndryshimeve të pritshme që mund ti bëhen rendit botëror. Synimet drejt këtij rendi të paraprirë nga pandemia dhe frika e luftës së fundit në Ukrainë, në mundësinë e zgjerimit të konflikteve ushtarake, nxisin dyshimet mbi të vërtetën e tyre, duke diktuar rregulla të reja mbi konceptet post-moderne të veprimit të parimeve të filozofisë politike, dijes, besimit dhe ekzistencës së jetës së qënies humane.

Përballja e urtësisë së filozofisë dhe filozofisë së moralit, me filozofinë e marrëzisë që dikton jetën me anë të presionit psikologjik, synojnë “*vdekjen*” e republikës së të drejtave në demokraci të Platonit, duke i hapur rrugën revolucionarizimit të teknologjisë dhe marrëdhënieve të reja në prodhim. E përfolur në nivelet më të larta të politikës globale, sipas koncepteve të formuara mbi një sinoptikë të madhe politiko-filozofike, shoqërore dhe ekonomike, orientimi i rendit botëror synon zbatimin e doktrinës së globalizmit, grumbullimin masiv të parave dhe të drejtimit e kontrollit të botës nga një qendër e vetme. Nuk mund të flitet më për teori konspirative, por njeriu po përballlet me një praktikë konspirative e diktuar nga ngjarjet me ndikim global, e cila po tenton të ndryshojë rrënjësisht jetën e tij.

Synimi drejt botës globale si fenomen për të siguruar energji dhe territor, territor-minerale dhe para, për të mbështetur nanoteknologjinë, mund të vendosë rregulla të reja në funksion të gjithçkaje. Përzgjedhja e rracave inteligjente, ka nxitur manjatët e pasurisë t’i drejtohen pa droje

frenimit të rritjes demografike të popullsisë së botës. Prodhimi dhe shpërndarja e ilaçeve të personalizuar sipas llojit të virusëve, individit, kodit të tij gjenetik dhe efekteve, shkakton pasiguri në jetën e njeriut, i cili mund të ndodhet në kontrollin dhe mungesën e informacionit. Përmes sistemit “on-line”, çdo gjë mund të jetë nën kontroll. Pasiguria diktohet nga institucione të cilat zotërojnë paratë, ligjin, forcën, kontrollin, duke shkaktuar frikën dhe terrorin psikologjik të asgjësimit. Procesi i ndryshimit nisur dekada më parë, ka gjetur mbështetjen e teknologjisë në superstrukturën e politikbërjes. Nuk janë të rastësishme nxitja e homoseksualizmit, martesave të të njëjtit seks, nxitja e dëshirës për të mos u martuar, apo martesat në moshë të mëdha dhe tendencat për të mos lindur fëmijë etj.

Këto koncepte kanë zënë vend në gjeneratat e reja, (përfshi Republikën e Shqipërisë) dhe janë kthyer në faktorë veprues, si pjesë e procesit të kontrollit mbi rritjen e popullsisë. Një pjesë e këtyre ndikimeve janë të përfshira në paketën universale të të drejtave të njeriut në shkallë globale, të cilat edhe pse konsiderohen të tilla, ndikimet negative të tyre nuk kanë të bëjnë me respektimin e të drejtës njerëzore, portë përdorimit të tyre për të realizuar qëllime të tjera me ndikime dhe ndryshime globale.

Kjo botë që po ndryshon po imponon rregulla të reja. Në kushtet e imponimit, është e vështirë të kuptohet sot se, në sistemin e edukimit qytetar ku zë vend edukimi mbi të drejtat njerëzore, Pedagogjia Moderne po ia lë vendin Pedagogjisë Humane, e cila e mbështetur mbi teknologjinë e avancuar, po merr një natyrë krejt tjetër në edukimin dhe formimin mësimor të gjeneratave të kohës. Kështu, ndryshimi i formave të edukimit dhe të arsimimit, ka filluar të japë efektet e para të traumave psikologjike mbi dobishmërinë e sistemit arsimor në nxënës e studentë. Brezi i kohës po e ndjen, sepse i ra radha të përballet me imponimet e situatës së Pandemisë, duke e detyruar atë të përshtatet me gjithçka të ndryshuar në sistemin arsimor.

Shembull: Para 50 vitesh, Hygoi vlerësohej nëpërmjet leximit dhe analizës së romaneve të tij, duke u bërë i njohur për opinionin përmes diskutimeve të hapura mësimore, ku në mënyrë racionale trajtoheshin të gjitha vlerat që përfaqësonte krijimtaria e tij. Në kohën e sotme janë në qarkullim shumë filma për veprën e Hygoit, të cilët çdo herë lënë diçka mangut nga figura e shkrimtarit dhe pedagogut të ndritur. Vetëm për romanin “*Të Mjerët*”, regjizorët e filmave kanë dashur të thonë diçka, por kurrë nuk kanë arritur të trasmetojnë vlerat që mund të përcejllë romani në auditorët mësimore, në studiot mediatike, në aktivitete të tjera të promovimit. Mungesa e trajtimit të mendimit filozofik të shkrimtarit, lë mangësi në brezin e kohës, të cilat i faturohen ndryshimit teknologjik me mungesa në përgjegjësinë morale dhe shoqërore.

Në këtë situatë shfaqet një frymë e re filozofike, e cila le hapësira boshe dhe nuk i shkon plotësisht për shtat trajtimit moral dhe juridik të çështjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave njerëzore:

- Nëse e reja po depërton, atëherë çështja shtrohet, kush e organizon, kush e ushqen me ide, kush e drejton dhe çfarë qëllime duhet të arrihen në raport me të drejtat e njeriut?
- A ka garanci jeta njerëzore për mbajtjen nën kontroll të situatave të rënda psikologjike që shkaktohen prej super informacionit, mungesës së kontrollit dhe efekteve shkatërruese?
- Çfarë mund t'i thuhet dhe t'i kërkohet një nxënësi apo studenti në kuptimin real të jetës, të cilët mund të rrijnë me orë të tëra me video dhe emisione të padobishme për edukimin?
- Cilat mund të jenë raportet filozofike të jetës së njeriut dhe edukimit të tij qytetar, midis të drejtave njerëzore, diktaturës së ligjit dhe lirisë së pakontrolluar?

Situata komplekse që dikton ndryshime, mund të sjellë reagime mbi pakënaqësinë e njerëzve ndaj pabarazisë. Historia ka treguar se botën nuk e shkatërrojnë diktatorët, por tiranët. Në situata kaotike, historia ka sjellë në skenë diktatorët që kanë imponuar rregullat shoqërore, ligjin dhe shtetin si etapa apo periudha kalimtare, duke përdorur mjetet e dhunës, për t'i vendosur gurët e themelit të shoqërisë në vendin e tyre. Kapërcimi dhe stabilizimi i situatave kaotike, kanë imponuar kalimin në stadi të tjera politiko-shoqërore dhe ekonomike, duke hedhur vështrimin mbi rritjen e standardit të jetesës së qytetarit dhe të drejtave të tyre humane. Historia njerëzore na tregon se, në jetën globale kështu ka ndodhur çdo herë. Ndryshe nga diktatorët e ligjit dhe të shtetit, sunduesit tiranë i kanë imponuar ligjet shoqërore vetëm për të tjerët, duke e përjashtuar veten nga detyrimet. Mësimet e historisë vlejnë për kohën që jetojmë dhe ndryshimet e mëdha që po i imponohen jetës njerëzore. Të drejtat dhe liritë themelore të individit po çënohen seriozisht.

Nëse do të shikohen ngjarjet me praninë dhe ndërveprimin e të gjithë shteteve më të fuqishme të botës, marrëdhëniet midis tyre nëse do të shikohen me kujdes, krijohet përshtypja sikur ato zhvillohen secila më vete, kur në fakt nënshtresa e tyre politike dhe shoqërore është e përbashkët. Në situatën e kaosit për shkak të Covid-19, SHBA u përfshi në situatën e zgjedhjeve presidenciale. Për herë të parë situata elektorale del nga kontrolli duke reaguar me dhunë mbi Kapitol. Vështirë të kuptohet se çfarë ndodhi realisht brenda demokracisë amerikane, ku të drejtat njerëzore janë të vlerësuara në shkallën më të lartë.

Mosnjohja e shkaqeve të fenomeneve dhe mungesa e analizës në raport me ligjin dhe të drejtat, e detyron njeriun që çdo herë të shfaqë mendim apo qëndrim të kundërt. Nëse mungojnë analizat shkencore të fenomeneve, në vlerësimin e të drejtave përballë detyrimeve, përherë do të shkelen

kriteret e thelbit dialektik të paradigmës shkencore. (metodës dhe metodologjisë). Kjo mund të pranohet vetëm si vlerë e demokracisë për mendimin ndryshe. Një vlerë kjo e sistemit demokratik amerikan. Në situatën brenda jetës social-politike shqiptare, mjaft çështje që lidhen me shtetin dhe ligjin pësojnë deformime në opinionin publik për shkak të mungesës së informacionit dhe të ndikimeve nga e kaluara. Pushteti i shumicës dhe pakicës shoqërore nuk janë e njëjta gjë. Tjetër gjë në rastin konkret është pushteti i pakicës, e drejta e pakicës, e drejta që ajo ka për të pasur pushtet. Opozita nëpërmjet pushtetit ka të drejtë të kontrollojë shumicën, duke pasur të drejtat kushtetuese që e realizojnë këtë funksion, siç mund të jetë jeta parlamentare, Kontrolli i Lartë i Shtetit apo institucioni i Avokatit të Popullit. Kontrolli duhet të shtrihet deri brenda elementeve të Sigurisë Kombëtare, ku mazhoranca drejton, pakica kontrollon. Kjo paradigmë politike që mbështetet në liritë dhe të drejtat njerëzore, zakonisht funksionon në vendet e zhvilluara ekonomike, të lehtësuara nga mirëqënia ekonomike, por jo nga një luftë e brendëshme, siç ndodhë në Republikën e Shqipërisë.

Situata e krahasuar në Amerikë është një reflektim për të gjithë jetën globale. Ajo me zhvillimet e saj nxit studiuesit por dhe njerëzit e thjeshtë që të mendojnë për diçka të re, e cila në këtë periudhë ka nisur të reflektojësi njëlëvizje revolucionarizuese, me refleksione dhe ndikime të dallueshme midis shteteve, kombeve, racave, besimeve, midis interesave shoqërore, kushtetutës qëndrore dhe shteteve të ndryshme. Situatë që dikton riciklimin demokratik të kushtëzuar nga jo më shumë se dy mandate në drejtimin e SHBA. George Washington e donin president të përjetshëm, por ai e ndryshoi duke plotësuar mandatin vetëm 8 vite dhe duke i dhënë vlerë demokracisë amerikane. Po kështu kërkohej presidenca për Abraham Linkoln, i cili goditi skllavopronarinë dhe racizmin. Goditet Xhon Kenedi, i cili ishte kundër frymës raciste në shoqërinë amerikane. Zgjidhet presidenti me ngjyrë, Barak Obama, si kompromis i madh historik etj. Amerika e kërkon demokracinë dhe respektimin e të drejtave njerëzore, por brenda saj ka probleme e kontradikta, të cilat nuk kalojnë pa lënë gjurmë në jetën planetare. Procesi që ka filluar në këtë situatë në SHBA, nuk mund të ndalet. Nuk është problemi vetëm i reagimit prej një ndërhyrje brutale të një polici ndaj një njeriu me ngjyrë që i kushtoi jetën. Problemi është gjendja reale e Amerikës në raport me liritë dhe të drejtat themelore të njeriut. Pas kësaj janë kryer vrasje të tjera. A duhen elementet normalizues për ta shuar frymën e konfrotimit? Vetëm reformat mund ta realizojnë këtë. Të drejtat dhe liritë e njeriut, të shoqëruara me mjete ekonomike, politike, juridike, financiare mund të zbutin situatën. Fasadat apo simbolikat nuk janë më të vlefshme. Çështja është e hapur dhe e thjeshtë, kur pabarazia është e pranishme.

Në çështjet e gjeopolitikës dhe interesave amerikane, jeta shqiptare shikon me shpresë se çfarë mund të përfitojë nga vlerat e demokracisë amerikane, për të rritur standardin e jetesës dhe të respektimit të vlerave njerëzore. Investimi periodik i institucioneve amerikane në ndihmë të përmirësimit të standardit demokratik, veçanërisht në reformimin e sistemit të drejtësisë shqiptare, është një hap pozitiv me vlera. Në një shoqëri me standarde demokratike, jeta e qytetarit merr kuptim të vërtetë, sepse në themelin e saj funksionon harmonia në respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Por jo vetëm kaq. Në kontributin amerikan në fushën e sigurisë kombëtare, shihet qartë synimi për të krijuar një stabilitet politik dhe shoqëror, duke ngushtuar hapësirat e veprimit të terrorizmit, krimit të organizuar, korrupsionit dhe fenomeneve të tjera të cilat dhunojnë jetën qytetare. Ky kontribut i rëndësishëm është një hap më përpara në shmangien e mbetjeve të psikologjisë dhe botëkuptimit të sistemit të kaluar, prej të cilit shumë qytetarë vuajnë pasojat e persekutimit deri në ditët e sotme.

KAPITULLI I III

III. Mbrojtja e të Drejtave të Njeriut në mjedisin Social-Politik Shqiptar

Përfshirja në ndryshimet dhe zhvillimet e jetës globale kanë dhënë ndikime në veprimtarinë e institucioneve shtetërore ligjzbatuese në mbrojtje të të drejtave njerëzore, por njëkohësisht kanë rritur kërkesat e qytetarëve ndaj institucioneve për mbrojtjen e të drejtave të tyre. Ndryshimet e thella kushtetuese dhe reformat në zbatim po sfidojnë realitetin, duke synuar reagimin jo vetëm ndaj institucioneve shtetërore, por trokitjen në drejtësinë ndërkombëtare, duke i dhënë një imazh tjetër pozitiv qytetarit shqiptar.

Kundër koncepteve tradicionale të marrëdhënieve me drejtësinë shqiptare, qytetarët e shikojnë si mundësi për të arritur qëllimet e tyre, në raport më të drejtën civile, administrative dhe penale. Ndryshimi në natyrën e vet psikologjike jep efekte pozitive në garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duke përmirësuar situatën në fushën e Sigurisë Kombëtare, si domosdoshmëri objektive për stabilitetin social- politik, juridik, kombëtar dhe rajonal.

Përmirësimi i koncepteve mbi drejtësinë ka krijuar një botëkuptim të emancipuar, i cili nuk është më vetëm pronë e të drejtës shtetërore, por një armë e fortë në duart e qytetarëve për të mbrojtur të drejtat, duke i shërbyer sigurisë njerëzore në R. e Shqipërisë. Botëkuptimi shumëdimensional në mbrojtjen e të drejtave njerëzore dhe koncepteve mbi sigurinë kanë krijuar një psikologji më të qëndrueshme mbi sigurinë e lirisë nga nevojat që dikton jeta njerëzore dhe lirisë nga frika që imponon ajo për shkak të shkeljes së të drejtave të tyre. E përgjithësuar si praktikë për individët, ballafaqimi me legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar po shihet si mënyra më e mirë për të rregulluar drejtpeshimin e interesave të tyre në mungesë të harmonisë për ruajtjen e vlerave të jetës së njeriut.

Mosrespektimi i të drejtave të njeriut, është kërcënim për sigurinë njerëzore. Ato janë tregues të mekanizmave për paralajmërimin e hershëm të këtij fenomeni, me qëllim të parandalimit të zhvillimit të shoqërisë në kaos, padrejtësi dhe pabarazi. Para viteve '90, parimi politiko-ideologjik, e vlerësonte njeriun si kapital të çmuar, duke e mbështetur këtë në një sistem vlerash që buronin nga filozofia dhe ideologjia e kohës. Sistemi politik njëpartiak dhe Kushtetuta, edhe pse i vlerësonte formalisht të drejtat e qytetarëve shqiptarë si nocione bazë të zhvillimit të shoqërisë, në dukje kjo përmbante filozofinë e vlerësimit në mbështetje të rolit të shtetit dhe ligjit, si garant i sigurisë individuale e kolektive, i sigurisë ekonomike dhe sociale, por që në fund të fundit me ligj, sistemi komunist i hoqi individit dhe shoqërisë të drejtën e sigurisë politike vetjake.

Pas viteve '90, në fillimin e periudhës së tranzicionit, situata solli zhvlerësimin e konceptit të të drejtave njerëzore të mbështetura në elementet e sigurisë shtetërore, duke afruar për Republikën e Shqipërisë një vakum ligjor të sigurisë individuale dhe njerëzore, me pasoja kërcënuese ndaj jetës së individit, sigurisë ekonomike dhe sociale, të cilat për disa vite rresht iu faturuan kritikës ndaj periudhës komuniste. Koha deri në plotësimin hap pas hapi të legjislacionit kushtetues për mbrojtjen e të drejtave njerëzore, u shoqërua me një valë të pakontrolluar emigracioni legal dhe ilegal.

III.1. Ndryshimet Kushtetuese dhe ndikimet Psikologjike në Shqipërinë Postkomuniste

Kalimi gradual për ndryshimin e psikologjisë shoqërore, në rrugë juridike ndoqi rrugën e tij, duke kaluar në dy faza: Tentativa për të ndërtuar kushtetutën në vitin 1995 (e cila me referendum popullor dështoi); ndërtimi dhe miratimi i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në vitin 1998.

Sfidat e reformave në fushën e drejtësisë dhe të mbrojtjes së të drejtave njerëzore, shfaqen shumëdimensionale për të garantuar rrugën e integritit, të cilat sot diktojnë vendimmarrje të reja politike dhe social-ekonomike. Populli shqiptar ka nevojë për shtetin e së drejtës. Rrethanat e kërkesave ndërkombëtare për ndryshime të thella institucionale, diktojnë. Fakti që jemi pjesë e një rajoni me probleme të spikatura psikologjike dhe ideopolitike të mbartura nga sistemi komunist, përpjekjet e pamjaftueshme që bëhen në fushën e të drejtave njerëzore, nuk ofrojnë optimizëm për çfarë është arritur deri tani, duke e ballafaquar gjendjen reale, jo në këndvështrimin e analizës dhe ballafaqimit të mirëfilltë, por shumë më tepër sesa kaq.

Drejtësia është një nga shtyllat kushtetuese më problematike në jetën social-politike shqiptare. Papërshtatshmëria nuk qëndron tek njerëzit. Mëkatari i parë është ligjvënësi. Parlamentarizmi shfaq paaftësinë drejt mjedisit të sigurtë, me përplasje politike dhe prishje të balancës së pushteteve, thërrmim të unitetit qytetar. Parlamentarizmi ndjek ç'organizimin e organizuar, duke e mbajtur shoqërinë shqiptare në tension. Kundër drejtimit me *“dorë të hekurt”*, ligjet duhet të ndërtohen në harmoni me problemin. Pasojat e periudhës janë të rënda.

Për shumë arsye të parashtruara me përgjegjësi profesionale në këtë studim, vlerësimi i kërcënimeve të brendshme, të cilat shfaqen si rrjedhojë e shkeljes së të drejtave njerëzore, në mungesë të harmonisë midis realitetit dhe thjeshtësisë së masave të planifikuara në perspektivë, detyrimeve që ka shteti dhe shoqëria ndaj një jete të shëndetshme sociale të qytetarëve, krahasuar me shtetet e tjera të rajonit dhe më gjerë, institucioneve kushtetuese në Republikën e Shqipërisë, do t'i duhet të bëjë shumë për të arritur nivelin e standardeve të parashikuara në dokumentet themelore ndërkombëtare. Formalizimi në plotësimin e detyrimeve ndaj të drejtave themelore të jetës, është me pasoja.

Pas vitit 1998, koncepti juridik mbi të Drejtat e Njeriut në Republikën e Shqipërisë mori një dimension më të gjerë, duke respektuar jo vetëm nevojën e brendshme për të ndryshuar psikologjinë e trashëguar nga sistemi komunist, por të krijuar një bazë të shëndetshme juridike në mbarëvajtjen e jetës së qytetarëve. Arritjet e Republikës së Shqipërisë si vend anëtar i NATO-s dhe si vend aspirant për t'u antarësuar në BE, në fushën e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në këto vite, shfaqen si përpjekje e vlerësuar institucionale në parametra programorë, të cilat i nënshtrohen realizimit të tyre hap pas hapi, nën përgjegjësinë e institucioneve kushtetuese, të cilat ndjekin realizimin në planin e brendshëm dhe atë me detyrime ndërkombëtare.

Duke respektuar metodologjinë studimore shkencore mbi kushtet, rrethanat politike, synimet analizën dhe përfundimet, krahasueshmërinë, të dhënat dhe pritshmëritë, përfundimet dhe rekomandimet në këtë studim mund të jenë një ndihmesë serioze në përmirësimin e punës së institucioneve shtetërore dhe të qëndrimit qytetar mbi jetën dhe të drejtat njerëzore e humane. Problemet e shtruara në mënyrë objektive dhe analitike në referencë me progres-raportet e institucioneve të ndryshme ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, mund të jenë një rast i shpalosjes së kurajos profesionale e qytetare, duke tërhequr vëmendjen e institucioneve shtetërore, kundër shumë praktikave të ndjekura deri tani.

Çështjet e mbrojtjes së të drejtave njerëzore, nuk mund të jenë dhe të trajtohen thjesht si qëllim në vetvete, të shkëputura nga kompleksi i problemeve që ato lindin në procesin e vijueshmërisë së jetës së qytetarëve shqiptarë. Kundër formalizmit për të qenë në rregull me procedurat dhe parashikimet e planifikuara dhe të kushtëzuara të sistemit politik, të diktuar nga partneriteti dhe nevoja e antarësimeve, synimet, objektivat dhe pritshmëritë, do të vazhdojnë të mbeten detyrime kushtetues me karakter kombëtar, në interes të forcimit të jetës sociale, të klimës paqësore e humanitare, për mbrojtjen e të drejtave të jetës në një shoqëri demokratike.

Shtrimi i problemeve në këtë material studimor, pavarësisht pretendimeve institucionale që shpesh shfaqen me bujë për efekte propogandistike të pushtetit politik dhe partiak, në fund të fundit tërheqin vëmendjen mbi sfidat e shoqërisë dhe të shtetit në fushën e mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve, të cilat nuk mund të maten dhe vlerësohen vetëm me stereotipin e dokumenteve, planeve, programeve dhe veprimtarive treguese të publikuara deri tani. Ato kërkojnë kthimin e vëmendjes për të marrë në konsideratë detyrimet që burojnë nga vlerat demokratike të neneve që burojnë nga Deklarata Themelore e të Drejtave të Njeriut, nga Konventa Evropiane, nga detyrimet e OSBE dhe Kartës së Helsinkit etj. Kjo është përgjegjësi e institucioneve shtetërore që garantojnë qetësinë, sigurinë dhe paqen në jetën e qytetarëve shqiptarë.

Nëse në vlerësimin e kërcënimeve që burojnë në planin e brendshëm të sigurisë, prej shkeljes dhe dhunimit të të drejtave njerëzore, nuk do të jetë objekt i rishikimit, atëherë kjo mund të jetë sfida më e madhe e sistemit të brishtë demokratik në këto 30 vite në Republikën e Shqipërisë. Me këtë konstatim, nuk po sillet në këtë studim diçka e pazakontë, përveç faktit që, ballafaqimi me situatën shfaqet me probleme.

Kjo problematikë përfshihet në sfondin kushtetues dhe juridik në nenet e Kushtetutës, në kapitullin për të drejtat e njeriut. Edhe pse ato konsiderohen “*të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik*”, (Kushtetuta e R. Shqipërisë,

2017:8), fakti dhe përvoja e gjatë 30 vjeçare, kanë vërtetuar formalitetin dhe shkeljet sistematike, të cilat kanë cënuar rendin publik dhe elementet e sigurisë kombëtare. Institucionet publike synojnë të përmbushin detyrat, duke respektuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut me politikëbërje tëdobishme, sipas parimit, *“të gjithë janë të barabartë përpara ligjit”*. (Kushtetuta e R. Shqipërisë, 2017:9). Përfshirja e gjinisë, racave, besimit fetar, etnisë, gjuhës, bindjeve politike, fetare, filozofike, ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësisë prindërore, janë dimension i rendit kushtetues, të mbivendosura në standardet demokratike dhe nevojën e thellimit të reformave.

Të drejtat e liritë themelore për shtetasit shqiptarë, vlejnë njëloj edhe për të huajt dhe personat pa shtetësi, me përjashtim të rasteve kur kushtetuta e lidh në mënyrë të posaçme me shtetësinë shqiptare, ushtrimin e të drejtave e të lirive të caktuara. Këto të drejta vlejnë për personat juridikë, për aq sa përputhen me qëllimet e përgjithshme dhe thelbin e të drejtave, lirive dhe detyrimeve. Sipas konceptit juridik, kufizimi i të drejtave dhe lirive mund të vendosen, *“vetëm me ligj për interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve”*. (Kushtetuta e R. Shqipërisë, 2017:12). Kufizimet nuk çenojnë thelbin e të drejtave dhe lirive, duke mos tejkaluar në asnjë rast kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Në Republikën e Shqipërisë *“jeta e personit mbrohet me ligj”*. (Kushtetuta e R. Shqipërisë, 2017:9). I njëjti koncept juridik funksionon për lirinë e shtypit, radios, televizionit, kundër çensurës mbi mjetet e komunikimit. Koncepti juridik garanton të drejtën e informimit, lirinë e ndërgjegjes dhe të besimit fetar, mospërdormin dhe ndalimin e torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues, kundër punës së detyruar. Të gjitha kategoritë e tjera të të drejtave janë të paracaktuara me ligj, sipas primeve themelore ndërkombëtare. Koncepti juridik parashikon gjithashtu kufizimet e të drejtave, të cilat marrin vlerë vetëm në rastin e veprimtari të vendimeve të gjykatave shqiptare, sipas natyrës penale, civile apo administrative të veprimtarisë antiligjore të njeriut.

Objekti themelor i këtij trajtimi është shmangia e individëve shoqërisht të rrezikshëm për jetën, pronën dhe sigurinë e të tjerëve. Në konceptin e heqjes apo të kufizimit të lirisë dhe të drejtave, individi gëzon ato të drejta individuale që respektojnë anën humane të tij, përmes instrumentit juridik të avokatisë. Kushdo mund të quhet i pafajshëm, deri në momentin sa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Koncepti juridik kushtetues parashikon të drejtat e mbështetura në vendimet e gjykatave shqiptare, duke respektuar hierarkinë në interes të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut.

Tërësia e koncepteve juridike, jep natyrën e mbështetjes ligjore kombëtare e ndërkombëtare të kushtetueshmërisë, e cila në mjedisin social-politik jep ndikime psiko-sociale në jetën e individit dhe shoqërisë. Efekti psikologjik bazohet në klimën e besimit të qytetarit ndaj shtetit dhe institucioneve, që garantojnë dhe janë shtyllat bazë të rendit kushtetues. Prej kësaj buron koncepti filozofik dhe psikologjik i Kushtetutës dhe detyrimet e institucioneve ligjzbatuese për të garantuar një jetë të shëndetshme të qytetarëve, familjeve, komunitetit dhe të shoqërisë.

III.2. Institucioni i Avokatit të Popullit, risitë e reja të përballjes me Drejtësinë

Shqipëria ka korniza ligjore kryesisht sipas standardeve Europiane dhe ka ratifikuar shumicën e konventave të të Drejtave të Njeriut, por zbatimi i mekanizmave të mbrojtjes së këtyre të Drejtave duhet të kthehet në proces të thellë reformimi, i lidhur me shumë institucione qendrore e vendore ligjzbatuese, që garantojnë këto të drejta.

Mbrojtja e të drejtave të njeriut përballë korrupsionit dhe terrorizmit në të gjitha format.

Panorama e raportimeve dhe punës së Avokatit të Popullit jep mesazhin që vlen për institucionet, të cilat mbrojtjen e të drejtave njerëzore duhet ta vlerësojnë si pjesë të qenësishme të sigurisë publike dhe kombëtare. Të kthejmë sytë dhe vëmendjen nga Siguria Njerëzore, për të forcuar burimet e sigurisë, energjinë për jetën e shoqërisë dhe të shtetit .Pandemia tregoi mungesën e seriozitetit, përgjegjshmërinë në dekada të institucioneve përgjegjëse të sigurisë dhe mungesën e shtetit social. Të ndihemi të detyruar të përfshijmë në elementet kryesore të Sigurisë, kujdesin për jetën e njeriut, për të drejtat e tij, për tokën, detin, lumenjtë, pyjet, për natyrën dhe dobinë e saj të pazëvendësueshme për jetën tonë.

Të drejtat njerëzore janë vënë përballë ushtrimit të presionit psiko-social në të gjithë format, të diktuar nga struktura shtetërore dhe joshtetërore, nga institucione private. Ato kanë shfrytëzuar pabarazinë sociale, epërsinë e pasurisë, aftësinë për të korrptuar dhe shantazhuar, duke tentuar të krijojnë një klimë pasigurie në jetën publike. Përvoja e historisë jep mësimet konkrete për këtë çështje. Ligji i hekurt i oligarkisë është teori politike, e zhvilluar për të pohuar, “*sundimin nga një elitë, ose oligarkia*”, i pashmangshëm si “*ligji i hekurt*” brenda çdo organizate demokratike, pjesë e “*nevojave taktike dhe teknike*” të saj. Fuqia brenda tyre është deleguar tek individë të zgjedhur, të lidhur me interesat e partisë. “*Evolucioni historik tallet me të gjitha masat profilaktike, që janë miratuar për parandalimin e oligarkisë.*” Partitë dhe organizmat financiarë drejtohen nga “*klasa udhëheqëse*”, si rrogëtarë, drejtues, zëdhënës ose strategë politikë. Larg të qenit “*shërbëtorë të*

masave”. (Abazi, Sulejman, Strategjia Kombëtare, 2019:201). Kjo klasë udhëheqëse ndikon mbi pushtetin. Qëllimi kundër tyre është i pamundur, sepse demokracia përfaqësuese në Shqipëri ende rezulton një fasadë, që legjitimon sundimin e kësaj elite.

Duke respektuar të drejtat dhe detyrimet kushtetuese në Shqipërinë postkomuniste, është me vend që në hulumtim të paraqiten disa dukuri specifike të veprimtarisë së **Avokatit të Popullit**, si institucioni qendror kushtetues, që ndjek në proces veprimtarinë institucionale dhe qëndrimin qytetar në raport me mbrojtjen e të drejtave njerëzore. Nuk është me interes të shpjegohet, se çfarë është dhe çfarë përfaqëson ky institucion. E rëndësishme është sjellja e disa dukurive specifike të misionit, për ta kuptuar atë si elementin bazë të orientimit ligjor për mbrojtjen e të drejtave njerëzore dhe interesit publik.

Sipas parimeve të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara të përfaqësuar në rezolutën 48/134, datë 20.12.1993, janë parashikuar standardet ligjore në Republikën e Shqipërisë, për të garantuar një sistem efektiv të mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut. Është kjo rezolutë baza e veprimtarisë ligjore të Avokatit të Popullit për të monitoruar funksionimin e Institucioneve Kombëtare për Promovimin dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut”. (Raporti Vjetor i Avokatit të Popullit, 2019:5).

Në mbështetje të parimeve ndërkombëtare, në çdo 4 vjet në Shqipëri veprojnë institucione për promovimin e tyre në jetën social-politike të popullit, të konkretizuara gjatë vitit 2019 me 11 raste të aktiviteteve qendrore për problemet kryesore në mbrojtje të të drejtave të njeriut. Funksionet ligjore të Avokatit të Popullit orientohen në mbrojtjen, promovimin dhe garantimin e të drejtave të njeriut në Shqipëri, duke vendosur kontakte direkte me qytetarët dhe institucionet ligjvënëse e ligjzbatuese. “Gjatë vitit 2019 janë administruar 145 ankesa për shkelje të të drejtave nga strukturat ose punonjësit e Ministrisë së Brendshme dhe Policisë së Shtetit. Numri i ankesave është pothuajse i njëjtë me ato të një viti më parë”. (Raport i Avokatit të Popullit, 2018:146)

Për mbrojtjen, garantimin dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve objekt ka qenë futja e rregullave të reja për inspektime dhe rekomandime për administratën publike. Për vitin 2019 “janë trajtuar 46 ankesa dhe 8 raste të ankesave mbi kushtet e varfërisë”. (Raporti Vjetor i Avokatit të Popullit, 2019:5).

Po kështu, “Gjatë vitit 2019 janë paraqitur 212 ankesa individuale që lidhen me të drejtat e të burgosurve, nga të cilat për 113 është përfunduar hetimi administrativ dhe 99 janë ende në shqyrtim. Nga rastet e përfunduara 75 kanë rezultuar të pabazuara në ligj, 30 janë zgjidhur në favor të ankuesit gjatë shqyrtimit, 4 kanë rezultuar jashtë kompetence dhe 4 kanë përfunduar me rekomandim përgjithësues drejtuar Drejtorisë së

Përgjithshme të Burgjeve dhe dy institucioneve shëndetësore jashtë sistemit të burgjeve”. (Raporti Vjetor i Avokatit të Popullit, 2019:5).

Për periudhën janar-dhjetor 2019, Institucioni i Avokatit të Popullit ka adresuar në total 213 rekomandime, 122 drejtuar organeve të Administratës Publike, duke përfshirë atë qendrore dhe vendore. Jeta e qytetarëve shqiptarë përballet me shkeljet e organeve të rendit, të cilat përdorin forcën e tepërt për arrestime të protestuesve pjesmarrës në mitingjet opozitare. Janë pranuar mbi 12 ankesa të qytetarëve për ushtrimin e dhunës dhe dëmtimeve nga përdorimi i gazit lotësjiellës. (Raporti Vjetor i Avokatit të Popullit, 2019:6). Janë të pranishme rastet e lëndimeve të rënda nga përdorimi i lëndëve kimike. Mosndëshkimi për sjelljet e policisë mbeten problem i hapur i drejtësisë dhe institucioneve ligjzbatuese.

Kushtetuta kërkon që autoritetet të informojnë menjëherë personat e ndaluar dhe të zbatojnë të drejtat, duke shprehur ligjërisht akuzat ndaj tyre. Marrja në pyetje e qytetarëve të ndaluar shpesh herë bëhet pa praninë e avokatit. Ligjzbatuesit jo gjithnjë i respektojnë kërkesat dhe ankesat ndaj tyre janë të pranishme. Shërbimi për Punë të Brendshme dhe Ankesat (SIAC) pranuan 1,211 ankesa me shkrim deri në gusht të vitit 2019, krahasuar me 1,978 raste të tilla ankimi në vitin 2018. Shumica e ankesave janë për mos respektim të të drejtave individuale, veprime arbitrare, përdorim dhune, shpërdorim detyrë dhe shkelje të procedurave nga punonjësit e policisë. Për këtë shkak, janë rekomanduar 116 oficerë policie për procedura disiplinore. Gjatë vitit 2019 u referuan dy raste për ndjekje penale për tre oficerë të akuzuar për arbitraritet dhe falsifikim dokumentash. (Burimi i të dhënave, Raportet e A.P. 2018,2019).

Institucioni i Avokatit të Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike. Si institucion kushtetues apolitik, ai është i pavarur në ushtrimin e detyrës së tij dhe gëzon imunitetin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Paraqet para Kuvendit të Republikës së Shqipërisë raportin vjetor me çështjet më të rëndësishme në fushën e mbrojtjes së të drejtave njerëzore. Moszbatimi dhe diskriminimi i të Drejtave të Njeriut mbeten sfida më e vështirë për drejtësinë në Shqipëri. Edhe pse Progres-Raporti i Komisionit European për Shqipërinë ka vlerësuar në vitin 2019 progresin e moderuar në disa fusha të të drejtave të njeriut, institucionet shfaqin rezervat, ballafaquar me situatën konkrete social-psikologjike të qytetarëve.

Progres-Raporti i fundit i Komisionit European dhe ekspertët, shfaqin shqetësimin për dhunën ndaj fëmijëve, grave e vajzave, abuzimeve me të drejtën dhe pronën, dhunën gjinore apo kundër

personave me aftësi të kufizuar, rastet e diskriminimit të komunitetit Rom dhe Egjiptian, të minoriteteve apo të personave LGBT, të cilat përfaqësojnë shtresëzimet sociale më të ekspozuara ndaj shkeljeve, duke kërkuar mbrojtjen ligjore të tyre. Vrejtjet e KE janë bërë publike për vitin 2020 e në vazhdim. Ajo i kërkon Shqipërisë përmirësimin e mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijëve dhe personave të dhunuar për shkak të gjinisë, si dhe të konsolidojë legjislacionin për të miturit.

Shembull: Prej vitit 2013, kur pushteti politik u ndërrua në Republikën e Shqipërisë, qeveria e re shkeli në mënyrë flagrante të drejtat njerëzore nëpërmjet akteve ligjore e nënligjore, penale dhe administrative, duke burgosur dhe izoluar njerëz të thjeshtë për mospagim të faturave të energjisë elektrike dhe të ujit. Veprimet shtetërore u kryen në kushte paralajmërimi por edhe ekzekutimi, në kundërshtim me Konventën e të Drejtave të Njeriut dhe lirisë së shprehjes së mendimit dhe të barazisë sociale, në punë, dhe në jetë. Përballë kësaj reprezalje administrative, kundërshtimet dhe mospëlqimet u shfaqën në masë.

Punësime me favore interesash personale, përfaqësimi i rinisë në parti politike, marrja e kartës së antarësisë, u shfaqën si disa detyrime individuale nga struktura partiake e shtetërore, si kushte për të dhënë votën për partinë në pushtet. Për individin, nëse është i punësuar si nëpunës zyrtar, ai është i detyruar t'i përgjigjet shtetit, të votojë, të mohojë të vërtetën dhe vetëveten, të mos protestojë apo të kërkojë të drejta në kundërshtim me presionin shtetëror. Në të kundërt, individit përjashtohet nga puna apo largohet nga grupimi politik. Aty ku gjërat bëhen në mënyrë të fshehtë, pa transparencë për opinionin, nga përvoja tregojnë se, ato i nënshtrohen planifikimeve të studiuar nga militantizmi partiak. Veprime të tilla nën hundën e institucioneve të drejtësisë, janë në mospërputhje me Konventën e të Drejtave të Njeriut, si abuzim dhe shkelje e hapur dhe e fshehtë e të Drejtës së individit mbi privatësinë në qëndrimet personale dhe publike, duke i imponuar mbi atë çfarë ai duhet të bëjë mbi jetën, punën dhe qëndrimin e tij.

Fenomeni politik dhe efektet sociale, çkurajoj në dëshirën e njerëzve për të vepruar të lirë, për të respektuar dinjitetin dhe vullnetin e tyre. Ky qëndrim frenon dëshirën për humanizëm dhe demokraci të harmonizuar me të drejtat e njeriut, që garanton jetën e lirë. Me këto mënyra, politika frenon zhvillimin kulturor të shoqërisë, duke nxitur konfliktin, korrupsionin, duke dëmtuar imazhin e shoqërisë në jetën e brendshme dhe ndërkombëtare. Në raport me të drejtat njerëzore, ka gjëra që dihen dhe nuk shfaqen, që njerëzit janë të privuar të flasin apo të denoncojnë, për shkak të presionit psikologjik nga segmente shtetërore dhe kriminale, me ndikime negative mbi qytetarin.

Në mjedisin e rënduar psikologjik, qytetarët e kanë të vështirë të veprojnë. Ata mund të ndihen të pambrojtur nga ligji, shteti apo institucionet e sigurisë së jetës. Kur në shoqëri nuk funksionon Ligji dhe e Drejta, individit mund të paguajë jetën për çdo qëndrim që mund të ndërmarrë për të mbrojtur të drejtat e tij më elementare njerëzore. Ka raste të vendimeve të padrejta të Gjykatave shqiptare, të cilat individë dhe familje të tëra i kanë paguar me çmime shumë të shtrenjta, kundër jetës së tyre, sigurisë, pronës dhe të drejtës personale e publike. Janë të shumta rastet, kur antarë të korruptuar të gjykatave, organit të akuzës apo mbrojtjes, në kushtet e mitmarrjes, kanë ndikuar në vendime të padrejta gjyqësore, duke shkatërruar thelbin e funksionimit të shoqërisë. Ato shkatërrojnë në themel dhe tjetërsojnë të drejtën e pronës, që i kanë dhënë shkas vetëgjyqësisë që kanë kushtuar me dhjetra jetë njerëzish të pafajshëm, duke nxitur situatë të kriminalizuar brenda shoqërisë. Për shkak të shkeljes së të drejtave, dhunës, diskriminimit, duke përdorur institucionet e shtetit, opinioni shqiptar terrorizohet në jetën e tij.

Duke studiuar raportet e Avokatit të Popullit, institucionet janë vënë përballë qytetarit, duke shfaqur mosrespektin ndaj tij, veçanërisht në kufizimin e lirisë individuale, mbi të drejtën e pronës dhe e drejta në marrëdhëniet shoqërore të punës. Tre drejtimet më të ndjeshme në jetën e njeriut, kanë të bëjnë në marrëdhëniet me shtetin përballë drejtësisë, pronës, biznesit. Niveli më i lartë i ankesave të qytetarëve mbi kufizimet e lirisë së personit, sjellin në vëmendje konfliktin e qytetarëve me drejtësinë dhe rendin publik. Çështja e mosrespektimit të ligjeve në Shqipëri është një nga problemet më specifike përballë lirive dhe të drejtave themelore të njeriut.

Këto fenomene kanë lidhje kauzale nga qeverisja në qeverisje, sipas ndërrimit të pushtetit, duke mos nxjerrë përgjegjësinë për shkeljet sistematike, duke anashkaluar njëkohësisht kritikën dhe qëndrimet konstruktive të progress-raportëve vjetore mbi respektimin e të drejtave të njeriut, në ballafaqim me legjislacionin shqiptar. Njerëzit e thjeshtë shikojnë me shpresë faktorin ndërkombëtar, trupin diplomatik, për ndërhyrjen e tyre ndaj politikës dhe kundër korrupsionit politik, moral dhe financiar të politikës dhe administratës shtetërore.

III.3. Raportet me sistemin e drejtësisë për mbrojtjen e të drejtave njerëzore

Në hulumtime më të zgjeruara të dokumenteve zyrtare, në këtë çështje ka një qasje konkrete, të drejtëpërdrejtë, e cila jep pasqyrën e qartë të respektimit të të drejtave njerëzore të qytetarit në raport me ligjin. Situata ka të bëjë me qytetarin përballë organeve të rendit publik dhe të

Drejtësisë shqiptare, e cila përfaqësohet në mënyrë direkte me objektet, kushtet, trajtimin, logjistikën dhe marrëdhëniet me institucionet.

Kushtet e burgut në qendrën e paraburgimit. Kushtet e dobëta fizike dhe mungesa e kujdesit mjekësor, veçanërisht për shëndetin mendor janë probleme serioze, krahas mbi popullimit dhe korrupsionit. Kushtet fizike në mjediset e paraburgimit në disa ambiente të ndalimit policor jashtë Tiranës dhe qendrave tjera kryesore urbane, janë treguesi kryesor i ballafaqimit të sistemit të drejtësisë me mbrojtjen e të drejtave njerëzore të individëve në paraburgim. Sipas studimit të të dhënave dhe tabelës përmbledhëse të mëposhtme në nivel shtetëror, të gjendjes së dhomave të shoqërimit dhe të sigurisë të personave të ndaluar nga policia e shtetit, të dhënat janë të diskutueshme, ballafaquar me të drejtat njerëzore sipas standardeve ndërkombëtare dhe të pranura nga shteti shqiptar. Ende mbetet shumë për të bërë.

Sic shihet në tabelën e mëposhtme, në total në 46 drejtori dhe komisarate në shkallë vendi janë në dispozicion 353 dhoma të shoqërimit, me një sipërfaqe të përgjithshme 4598 m², me një mesatare 13 m² për çdo individ. Në total pranë këtyre komisarateve janë 95 dhoma të sigurisë me një kapacitet 127 persona, shumica e të cilave nuk kanë mjedise të ndara për femra dhe për të mitur. Duke vlerësuar të dhënat, gati në 50 % të mjediseve policore nuk plotësohen kushtet minimale të jetesës dhe vetëm në 30 % të tyre janë në funksion mjedise për femra dhe minorenë. Duke vlerësuar raportet vjetore të institucioneve ndërkombëtare dhe vendore, situata në mjediset e ndalimit dhe të sigurisë shkon drejt përmirësimit.

Tabela nr. 2: Gjendja e mjediseve policore të ndalimit dhe sigurimit

Nr.	Qarku	Dhoma shoqërimi			Dhoma të sigurisë		
		Mjedise	Sasia	Sipërfaqe	Mjedise	Sasia	Kushtet
1.	Tiranë	21	104	1035	19	29	-
2.	Durrës	9	33	504	8	8	+
3.	Elbasan	12	43	482	7	12	-
4.	Korçë	9	31	496	6	6	+
5.	Gjirokastrë	9	29	464	8	9	+
6.	Berat	5	12	54	3	7	-

7.	Vlorë	4	11	132	6	9	-
8.	Dibër	7	22	228	9	11	-
9.	Shkodër	5	16	214	14	14	+
10.	Lezhë	9	35	585	4	6	+
11.	Kukës	4	14	164	4	6	+
12.	Fier	5	24	240	6	10	-
13.	Shuma	99	374	4598	94	131	-6; +6

(Burimi i të dhënave në tabelë, <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports>, Raporti i Avokatit të Popullit PDF, Aneks-1, 2020:179-187).

Objektet që administrohen nga Ministria e Brendshme, përveç lehtësirave rajonale në Tiranë, në disa qytete si në Durrës, Gjirokastrë, Kukës, Fier dhe Korçë, shfaqen me probleme. Të burgosurit shpesh futen në grevë urie për kushte të papërshtatëshme. Qeveria shqiptare ka lejuar hera-herës grupe ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, median dhe organe ndërkombëtare për monitorim të pavarur në mjediset e paragurgimit dhe burgjet shqiptare. Procedurat që ballafaqohen me të drejtat njerëzore janë të dukshme. Ato kanë të bëjnë me, ***Arrestimin ose paraburgimin arbitrar; Paraburgimin paraprak; Mohimin e gjyqimit të drejtë publik dhe Procedurat Gjyqësore; Tortura dhe Vdekje nga keqtrajtimi policor; Gjendja e burgjeve për vuajtjen e dëmimeve; etj.***

Ballafaquar me këto elemente të veprimit të drejtësisë, të pandehurit kanë të drejtë të jenë të pranishëm në gjykimin e tyre dhe të konsultohen me avokatin. Ligji u siguron të pandehurve kohën e duhur dhe lehtësira për të përgatitur mbrojtjen. Ata përballen me dëshmitarët kundër tyre dhe paraqesin dëshmitarë dhe prova për mbrojtje. Ata nuk mund të detyrohen të dëshmojnë ose rrëfejnë fajin dhe kanë të drejtë ankese. Për të mbrojtur të drejtat e të pandehurve dhe qasjen e provave kundër tyre, akuza aplikon me gjykatësin-dëgjues dhe kërkon gjykimin e çështjes. Shpesh gjykatësit kanë mbajtur seanca gjyqësore në zyra, duke demonstruar mungesë transparence dhe profesionalizmi. Kjo mënyrë mundëson korrupsionin. Për këtë problem zyra e Avokatit të Popullit i trajton rastet e papajtueshmërisë së qytetarëve me vendimet gjyqësore.

Gjithashtu të drejtat e njeriut shkelen nga ndërhyrjet e paligjshme në intimitetin, familjen, shtëpinë ose korrespondencën, apo me rastet e trafikimit të qenieve njerëzore, edhe pse ndaj

këtyre shfaqjeve ka një ndërgjegjësim më të lartë nga institucionet ligjzbatuese. Shqipëria trajtohet një vend i origjinës dhe tranzitit për personat, kryesisht gratë dhe fëmijët për qëllime të shfrytëzimit seksual. Fëmijë shqiptarë, veçanërisht Romë dhe Egjiptianë etnikë, vazhdojnë të trafikohen jashtë për lypje të detyruar. Gjithashtu, të paraburgosurit shpesh marrin lëndime, në raste të veçanta deri në torturë. Shumë prej shkeljeve janë kryer kundër militantëve politikë të arrestuar. Keqtrajtimi, ushtrimi i dhunës fizike dhe psikologjike konsiderohen shkeljet më të rënda që mund të kryhen ndaj personave të privuar nga liria.

Këto veprime shkatërrojnë personalitetin dhe dinjitetin e viktimës, vështirësisht për t'u rehabilituar. Nga të dhënat e fundit të vitit 2019 në kapacitetet zyrtare, numri i të burgosurve shfaqet alarmant. Në IEVP Tepelenë 15 persona mbi kapacitetin, në Elbasan 5, në IEVP Peqin 4, në Durrës 5, Kukës 6, Tropojë 7, Fushë-Krujë 72, Instituti i të Miturve Kavajë 10, në Korçë 11, në Berat 12, në Lushnjë 13, në Fier 14, në Reç 15, në Rrogozhinë 16, në Krujë 98, në “*Jordan Misja*” 17 etj. Në total rezultojnë mbi 320 persona të burgosur mbi kapacitetet zyrtare të institucioneve të vuajtjes së dënimit. (Raporti vjetor i Avokatit të Popullit, 2019:27).

Programi dhe institucioni i parandalimit mbeten të pafinancuar. Ky institucion ka filluar aktivitetin e tij që në vitin 2004, vit në të cilin shteti shqiptar kreu programe parandaluese dhe vazhdoi të përgjigjet kryesisht për OJQ-të dhe Organizatat Ndërkombëtare me aktivitete të tilla. Ndërtimi i kurrikulës së re arsimore përfshiu tematika të tilla parandaluese. Në po këtë vit në Shqipëri u miratua Korniza Strategjike e përmirësuar në këtë kohë me Planin Kombëtar të Veprimit, i cili përshkruan një qasje gjithëpërfshirëse. Në vitin 2005 u përfundua Strategjia dhe Plan i Veprimit për Trafikimin e Fëmijëve.

Trajtimi në bllok i fenomenve specifike ka të bëjë me sistemin e drejtësisë dhe sigurisë publike, për të kuptuar raportet brenda jetës sociale, midis të drejtave të njeriut dhe drejtësisë. Por ka më shumë se sa kaq. Shtresëzimet e selektuara mbi penaltetin e individëve, situatat kriminale brenda burgjeve, përvojat e hidhura të revoltave, lejimit të përdorimit të drogërave, korrupsionit të personelit, tejmbushja, numri i lartë i burgjeve në raport me popullsinë, etj., sjellin panoramën e pakëndshme të sigurisë. Individit në Shqipëri nuk e ka të qartë sa është i sigurt në privatësinë e përdorimit elektronik dhe nevojën e informacionit në shërbim të sigurisë së jetës së tij.

Përballë shkeljeve, Shoqëria Civile shfaqet e paaftë të mbrojë të drejtat e njeriut. Ngjarjet që shoqërojnë jetën mediatike ndikojnë thekshëm në jetën publike dhe dobësojnë strukturën sociale

të shoqërisë. Individit është i trembur përballë “*kronikës së zezë*” në TV shqiptare, zhurmës mediatike dhe mungesës së transparencës. Në Shqipërinë postkomuniste pretendohet për demokraci, por në fakt vendi ka humbur mbi 2 milionë njerëz, (një shifër në rritje), të cilët vazhdojnë t’i drejtohen emigracionit. Sipas INSTAT-it, “*në shtatë vitet e fundit, nga Shqipëria janë larguar 330 mijë njerëz*”. Pas vitit 2011 është rritur emigrimi drejt vendeve perëndimore, Gjermanisë dhe Anglisë, “*të cilët kapin shifrën 52 mijë veta*”. Sipas të dhënave në vitin 2017, “*numri i të larguarve kap shifrën 39. 905 njerëz*”. (Raporti vjetor INSTAT në RSH. 2017).

“Ballkani po mbetet pa njerëz, popullsia e Shqipërisë pritet të t’kurret me 26% deri në 2050. Po plaken, po vdesin, po largohen”. Kështu titullohet artikulli i fundit i revistës së njohur “*The Economist*”, ku trajtohet fenomeni i t’kurrjes së popullsisë së vendeve të Ballkanit. “*Problemet e shumta të rajonit i shtyjnë njerëzit e rinj, të talentuar të largohen. Por ato nuk do të arrijnë të kapin pjesën tjetër të Evropës pa njerëz të rinj, të talentuar, që do të gjeneronin prosperitet. Në të gjithë Ballkanin, popullsitë po zvogëlohen dhe plaken, dhe nëse situata nuk ndryshon edhe më shumë do të largohen*”.

Tabela nr. 3: Reduktimet e mundëshme të popullsisë të shteteve të rajonit deri në vitin 2050

Nr.	Shtetet e Ballkanit	Sipërfaqja	Është	Mbetet	Humbja në % deri 2050
			2016 (34 vjeç)	2050 (44 vjeç)	
1.	Mali i Zi	15.000 km ²	620.029	601.430	-3 % (186.000)
2.	Kosova	10.887 km ²	1.798.506	1.602.000	-11 % (198.000)
	Maqedonia e Veriut	25.713 km ²	2.113.866	1.712.250	-19 % (401.630)
3.	Serbia	77.474 km ²	7.120.666	5.411.700	-24 % (1.708.960)
4.	Kroacia	56.538 km ²	4.290.612	3.260.850	-24 % (1.029.750)
5.	Shqipëria	28.784 km ²	2.895.947	2.142.990	-26 % (752.950)
6.	Bosnja	51.120 km ²	3.839.737	2.419.030	-37 % (1.420.700)
7.	Bullgaria	111.000 km ²	7.364.570	4.492.390	-39 % (2.872.180)

Burimi: sipas raportit të Bankës Botërore të vitit 2016, të publikuara në revistën “*The Economist*”, si dhe në adresën web: <https://www.eurospeak.al/news/sondazhe>

Pse duan të ikin njerëzit nga Shqipëria?! Qeveria Shqiptare është e interesuar përmes planifikimit social- inkurajues të nxisë të rinjtë të krijojnë familje, duke paracaktuar bonuse për shtesën demografike familjare. Ndihma ekonomike fillestare është ndihmesë me motive nxitëse, nëse do të vlerësohet fakti që, sot martesat po bëhen në moshë të rritur deri në 35 vjeç.

Pranimi i aktit njerëzor kërkon angazhim. Ai ka kosto kur familja rritet në numër me fëmijë, kur jeta nuk është e sigurt me punën e qëndrueshme. Studimet më të thelluara në këtë çështje shumë delikate që ka të bëjë me nevojën për dimensione më të gjera të të drejtave njerëzore,

“do të duhej të vendoseshin në bazën e politikës dhe të edukimit, duke shmangur mjaftë gabime dhe përmbysje, për t’i shpëtuar fataliteteve”. (Le Bon, Gustave, 2001:75).

Për këto kushte rinia dëshiron të largohet për jetë më të mirë ekonomike. Janë shifra alarmante që rregjistrohen, duke i shtuar problemet sociale.

KAPITULLI I IV

IV. Respektimi i Lirive dhe të Drejtave Civile

IV.1. Dukuritë Negative, të Dhunës ndaj të Drejtave Njerëzore

Në hyrje të këtij kapitulli ballafaqohemi me disa të dhëna statistikore të Avokatit të Popullit për vitin 2019, të cilat pasqyrojnë natyrën e shkeljes së të drejtave njerëzore dhe institucionet më të prekura nga ky fenomen, duke dhënë në thelb raportet midis shtetit, ligjit dhe qytetarit. Numri më i lartë i ankesave për shkeljen e të drejtave, i janë drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, pushtetit

vendor, Ministrisë së Shëndetësisë, të Punëve të Brendshme dhe Kryeministrisë. Në raport me numrin e përgjithshëm të ankesave të qytetarëve për vitin 2019, (gjithësej 1361 ankesa të rregjistruara), institucioneve kryesore u janë drejtuar 951 prej tyre, gati 70 %. (Raporti i Avokatit të Popullit, 2019).

Kjo vërteton se problemet delikate qytetarët i kanë me institucionet, ku përplasen drejtëpërdrejtë interesat e tyre në raport me drejtësinë. Raporti i vlerësimit të ankimeve rezulton në 68.7 % drejtuar institucioneve qendrore dhe vetëm 21.3 % institucioneve vendore. Kjo vërteton shkallën e besueshmërisë së qytetarëve dhe vetë rolin e pamjaftueshëm të vendimmarrjes së pushtetit vendor në interesin publik.

Në totalin e ankimeve 33 % e tyre i drejtohen Ministrisë së Drejtësisë dhe asaj të Brendshme. Vetëm 9 % e ankesave janë për çështje shëndetsore.

Sipas Standardeve të Partnerëve Evropianë në luftën kundër Korrupsionit, në vitin 2018 në Shqipëri mori hapësirë dokumenti mbi, “*Vlerësimin dhe Gjetjet mbi veprimtarinë e SHÇBA-së*”, e cila u vu në shërbim të qytetarëve për ankesat që ata rezervonin ndaj punonjësve të institucioneve të shtetit, veçanërisht në fushën e sigurisë publike. Duke vendosur në dispozicion një “*linjë të gjelbër*” (<https://shcba.gov.al/>, 2018:8), u lehtësua komunikimi në interes të mbrojtjes së të drejtave qytetare. Ky vendim i qeverisë shqiptare u mbështet në Ligjin 70/2014, “*Për Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në MPB*”, ligjin Nr. 95/2016 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Institucioneve për të Luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar*” dhe në ligjin Nr. 12/2018, “*Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe SH.Ç.B.A-së*” (i ndryshuar). (<https://shcba.gov.al/>, 2018:6).

Mbështetja në bazën juridike krijoi hapësira që duke ruajtur anonimitetin, qytetarët të reagojnë ndaj shkeljes së të drejtave të tyre dhe të ndihen të mbrojtur nga ligji dhe shteti. Të dhënat e mëposhtme japin një pasqyrë të funksionit të korrinzës ligjore, duke rritur përgjegjësinë e punonjësve zyrtarë të sigurisë publike në marrëdhënie me qytetarët.

Tabela nr. 4: Raporti i Shërbimit për Çështje të Brendshme dhe Ankesat e Qytetarëve
(linja e gjelbër, tel. 08009090)

Nr.	Funksionimi i Linjës së Gjelbër	Lloji ankesave	Të drejtëpërdrejta	Adresimi
-----	---------------------------------	----------------	--------------------	----------

<u>1.</u>	Telefonata dhe problem të qytetarëve brenda dhe jashtë objektit të punës së agjensisë. Dhënie e informacionit që u intereson qytetarëve.	Viti 2019, gjithësejt telefonata: 6322.	Pranë Qendrës së Shërbimit: 25.3%	Rekomanduar Drejtorisë së Standardeve Profesionale.
		Ankesa jashtë objektit të agjensisë: 1288 telefonata, ose 27.3 %	Me paraqitje të qytetarëve, 13.4%	Policisë rrugore: 39.6%.
		Ankesa brenda objektit të agjensisë: gjithësejt 1549 telefonata ose 72.6 %	Përmes adresës ankesa@shcba.gov.al, 15.6%	Strukturave të Rendit, 28.3%,
		Ankesa të pabazuara: 23 %. hetimi	Përmes postës: 10.1%	Strukturave të hetimit të krimit: 15.3%
		Ankesa të pabazuara: 77 %	Nga strukturat rajonale: 13.6.	Komisariateve: 12%, Strukturave të kufirit 3.8%
		Ankesa të paprovuara dhe të pabazuara, 23%	Përmes palëve të tjera: 15.1 % “Komisariati Digital”: 4.9%	Strukturës së forcave Operacionale: 1%
<u>2.</u>	Shuma	6322	97.4 %	100 %

Burimi: <https://shcba.gov.al/ep-content/uploads/2020/06/RAPORT-VJETOR-2019-SHCBA-PERF-UNDIMTAR.pdf>, tankesa@shcba.gov.al; PDF-f. 7-10, Tiranë 2020.

Analiza e të dhënave shpjegon tendencat e qytetarëve për zgjidhjen e problemeve të tyre, duke synuar institucionet qendrore dhe më pak në pushtetin vendor. Gjithashtu ata i drejtohen drejtësisë dhe rendit publik, duke vërtetuar edhe një herë që problemet më të shumta në shkeljen e të drejtave njerëzore reflektohen nga këto dy institucione.

“Nga pozitat kur të drejtat e viktimës nuk janë të mbrojtura me ligj, duke u shfrytëzuar vetëm si subjekt apo burim provash, deri tani të drejtat e saj janë njehësuar plotësisht me të drejtat e njeriut në tërësi. Në funksion të kësaj janë miratuar dhe fuqizuar shumë aktet juridike. Gjithësesi, mbetet aktuale nevoja për të përmirësuar statusin juridik të viktimave të krimit, veçanërisht në vendet që nuk kanë bërë sa duhet në këtë drejtim”. (Hoxha Dorian, Osmani Enkeleida, 2017:87).

Sipas vlerësimit, është me vend të trajtohen raportet e mbrojtjes dhe shkeljes së të drejtave njerëzore për disa shtresëzime sociale, disa prej të cilave janë më të ekspozuara ndaj dhunës, diskriminimit, duke dhënë një panoramë më të plotë të evidentimit të kërkesave në rritje për t'i bërë ballë këtyre fenomeneve.

Mbrojtja e të Drejtës së Grave, Vajzave dhe Fëmijëve. Historikisht femra shqiptare ka qenë e paplotësuar në jetën e saj. Kjo e bënte atë të ndjehej e fyer nga prapambetja që e reflektonte statusi shoqëror, politik dhe arsimor. Deri në fund të viteve '20, gruaja përshtatej brenda patriarkalizmit në kufijtë vrasës. E ngujuar kudo, ajo ishte thjeshtë një riprodhuese djemësh. Në raste të tjera, ajo mallkohej nga burrëria krahinore, si e pazonja për të lindur të “*shtëna*” dhe jo të “*qara*”. (Kanuni Lek Dukagjinit:2005).

Në këtë marrëdhënie që e fsheh deri diku gruan shqiptare, është morali burror kombëtar, i cili nuk i lejon asaj të kuptojë se çfarë mund të përfaqësojë. Dhe pse shteti shqiptar kishte kushtetutën, sipas të cilës ndalohej mbajtja e perçeve, dhe pse arsimi fillor ishte i detyruar, edhe pse ligjërisht ndalohej gjakmarrja, këto ishin realitete virtuale. Realiteti shoqëror ishte tjetër. Do të duhej kohë, që Shqipëria të ecte drejt të drejtave politike e civile të grave. “*Barazia në të drejtën e votës midis burrave dhe grave në Shqipëri, u realizua për herë të parë në vitin 1946*”. (Antoni Giddens,1997:185). Paragjykimi i femrës del në pah me një paraqitje të qartë, pasi ato ishin të pakta në jetën publike, arsimore e kulturore, studentet e rralla, për të mbërritur tek femra, në krah elitës mashkullore shqiptare!

Metamorfoza e mendimit dhe e veprimit në një kohë dhe periudhë të caktuar, janë pjesë të jetës së përditëshme të shoqërisë njerëzore. Në çastet më të rëndësishme, individët dhe shoqëria pësojnë ndryshime cilësore, të cilat me kohën kthehen në tipare dalluese, të denja për t’iu nënshtruar studimeve të mëvonshme. Ajo rrëfen karakterin individual të kohës, me tendenca përgjithësuese. Arsyetimi logjik i situatës kohore mbi dukuritë në jetën e femrës shqiptare, i shkonte për shtat fizionomisë sociale të saj. Koha kërkonte ndryshimin. Jeta meriton shpjegim më të thjeshtë, sepse qytetarët janë të përfshirë me vetëdije brenda një misioni fisnik, duke respektuar parimet bazë të të drejtave njerëzore. As më shumë e as më pak, njeriu i thjeshtë falënderon faktin që ekziston, dhe shkon më tej me besim tek drejtësia, kur mendon se ekzistojnë gjithashtu njerëz të mirë, të cilët çdo ditë i falin njeri-tjetrit dashuri dhe siguri për jetën. Kjo paraqitje i takon grave dhe vajzave, të cilat janë gjysma e popullsisë dhe meritojnë më shumë se sa kaq.

Çështja femërore sot nuk mund të reduktohet në lëvizje feministe kundër ndikimit të burrit, apo diktatit të tij në jetën private dhe familjare. Ajo merr vlerat e lëvizjes ndërkombëtare për të drejtat gjinore. Ajo nuk i kundërvihet autoritetit të burrit, sepse liria e pakontrolluar, është po aq e rrezikëshme sa dhe konservatorizmi. Askush nuk mund të deformojë qëllimin e lëvizjeve të grave në botë dhe në Shqipëri, në emër të mbrojtjes së të drejtave të tyre.

Sot shoqëria e socializuar po ballafaqohet me situatën e raporteve midis sekseve. Mbrojtja morale dhe fizike e grave, e të drejtave të tyre juridike, është lëvizje institucionale kombëtare e ndërkombëtare, në shërbim të natyrës humane të femrës. Shoqëria Civile dhe institucionet publike e private, duhet të bëjnë atë që kanë bërë shumë gra, simbol në botë për mbrojtjen e të drejtave të grave kudo. Nën shëmbullin e tyre, duhet të kemi shumë gra luftëtare të emancipimit shoqëror.

Reagimi i shoqërisë kërkon që gratë, duhet të organizohen dhe të kërkojnë prej institucioneve publike mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të tyre. Në çdo rastë abuzimi apo dhunimi, ato duhet të paraqiten pa frikë në polici, të denoncojnë mbi abuzimet, të kërkojnë mbrojtjen nga shteti, të pranojnë këshillat nga mjeku, psikologu, duke vendosur gjendje normale emocionale dhe dëshirë për jetën. Të kërkojnë ndihmën e avokatit, të policit në rrugë, mësuesit në shkollë, më së shumeti të ketë sa më shumë respekt për veten, duke e çmuar jetën dhe të gjejnë kurajo për t'a denoncuar situatën e dhunimit të jetës së tyre. Besimi në mbrojtjen e të drejtave njerëzore, do të ushqejë shpresën për jetë më të mirë. Lëvizja për barazi, është harmonia e marrëdhënieve mes tyre. Për arsye jetike, diskriminimi, dhuna fizike, abuzimi seksual, përdhunimi, detyrimi për ushtrim të prostitucionit, mbingarkesa në familje, privimi nga e drejta e arsimimit dhe karrierës, janë shfaqjet më të shëmtuara të shoqërisë njerëzore. Si qenie e lirë, gruaja duhet të trajtohet e barabartë me burrin nga ligji dhe opinionin publik dhe ajo, duhet të fitojë të drejtat që gëzon burri. Për sa kohë që ajo nuk e kupton se është njeri si gjithë të tjerët, e lirë të gëzojë të drejtat njerëzore, e pavarur ekonomikisht, e zonja të përballojë jetën pa ndihmën e burrit, gruaja do të jetë gjithmonë fatkeqe. Këtu fillon problemi, sepse shoqëria njerëzore po reflekton hipokrizi në respektimin e të drejtave të grave në jetën shqiptare. Parimi i ndërvartësisë reciproke mes sekseve, duhet të jetë detyrim shoqëror. Thirrja për të drejtat e tyre merr hapësirë antropologjike në vlera jetësore, kundër pasojave të diskriminimit. Çështjet e emancipimit shoqëror dhe mbrojtja e të drejtave të femrës janë problem i pambarimtë. Në çdo sistem apo vend qoftë ky dhe i zhvilluar, nuk mund të pranohet që gratë të jenë skllave brenda shoqërisë njerëzore.

Mbrojtja e të Drejtave të Fëmijëve. Sipas raportit të UNCR dhe CRCA për fëmijët e zhdukur, çdo ditë në botë humbasin rreth 22.000 fëmijë apo 8 milion fëmijë në vit. Nga 1 në 7 fëmijë të humbur, ka më tepër gjasa që të bëhet viktimë e trafikimit dhe shfrytëzimit. Rreth 30% e viktimave të trafikut ndërkombëtar të fëmijëve, janë me origjinë nga vendet e Europës Juglindore. Në Shqipëri, Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijë, raporton se çdo ditë një fëmijë mendon të largohet, apo është larguar nga shtëpia. (<https://www.crca.al/sq/vepro-per-femijet-news>).

Arratisja apo largimi i fëmijëve dhe adoleshentëve nga disa orë në disa ditë, është forma më e përhapur e manifestimit të refuzimit që fëmijët i bëjnë situatave familjare, dhunës, abuzimit dhe neglizhimit. Fatmirësisht, shumica e rasteve që denoncohen, gjenden brenda 3-ditëve të para të shpalljes në kërkim, por kjo nuk do të thotë që problemi është i zgjidhur. Shumë fëmijë pasi gjenden dhe rikthehen në familje, ndeshen sërish me të njëjtat situata konfliktuale, abuzimi dhe neglizhimi, të cilat ndikojnë që ata të largohen sërish. Sa më shpesh që ata largohen, aq më shumë janë të ekspozuar ndaj rreziqeve dhe kërcënimeve për jetën e tyre. Sipas disa studimeve, është arritur në përfundimin se, 25% e rasteve vuajnë një formë abuzimi gjatë humbjes, 13 % e rasteve të fëmijëve të larguar nga familja, lëndohen fizikisht dhe 8% e tyre bien viktimë të dhunës seksuale. (Raporti vjetor INSTAT në RSh. 2017).

Një pjesë e fëmijëve dhe të rinjve që largohen nga mjedisi familjar, përfshihen në aktivitete kriminale, gjithashtu vuajnë probleme të shëndetit mendor dhe depresionit. Shqipëria pas vitit “90, është ndeshur me një natyrë shumë komplekse të çështjes së fëmijëve të humbur. Rrëmbimi, trafikimi, shfrytëzimi, pengmarrja, kanë qënë disa nga fenomenet me të cilat bota e fëmijëve, është ndeshur gjatë këtyre viteve në Shqipëri.

Në periudhën 2009-2014 janë raportuar 444 raste të humbjes së fëmijëve. Fëmijët vajza, janë më të ekspozuara ndaj fenomenit të humbjes dhe zhdukjes, me 67 % të rasteve, apo 296 raste gjithsej. Fëmijët djem për këtë periudhë, përbëjnë rreth 33 % të rasteve të policisë, me 148 çështje të trajtuara. Niveli i zbulueshmërisë për gjetjen dhe kthimin e tyre në mjedisin familjar, arrin në 88 %, që është një nivel relativisht i mirë, ndërkohë që sipas këtyre të dhënave, 49 fëmijë rezultojnë të humbur dhe janë në kërkim. Në 3 vitet e fundit sipas të dhënave të Policisë së Shtetit 365 fëmijë kanë humbur, prej të cilëve 258 vajza dhe 107 djem. Ndërkohë që 353 prej tyre janë rikthyer pranë familjeve, pjesa tjetër vijojnë ende të jenë të pagjetur. Gjatë 6 viteve të përkujdesjes sociale, janë trajtuar në mënyrë direkte 11 raste të fëmijëve të humbur. Niveli i zbulueshmërisë dhe i rikthimit në familje të këtyre rasteve, varion nga 78 % në 100 % në vitin 2011. (<https://www.crca.al/sq/vepro-per-femijet-news>).

Greqia dhe Italia kanë qënë destinacionet më të shpeshta për fëmijët. Në situata të vështira ekonomike, ka pasur precedent të shitjes së fëmijëve nga familjarët apo të afërmit. Një fëmijë i humbur, shkakton gjithmonë tronditje në shoqërinë e çdo vendi. Humbja e një fëmije prek dhe përfshin qindra familjarë dhe të afërm, të cilët humbasin vite duke u shqetësuar për fatin e tyre. Fatkeqësisht në disa raste, ata nuk kthehen kurrë dhe shumë familje jetojnë me këtë ankth.

Shkak i humbjes apo i zhdukjes së fëmijve, përfshin rrëmbimin, dhunën, abuzimin dhe shfrytëzimin seksual. Shërbimet e Linjës për Fëmijët e Humbur në Shqipëri synojnë të kontribuojnë në përmirësimin e sistemit të mbrojtjes së tyre përmes avokatësisë dhe mbështetjes në sistemin që i përgjigjet fëmijëve që kanë nevojë për kujdes dhe mbrojtje. Shoqëria shqiptare për shkak të tranzicionit të tejzgjatur dhe problemeve të shumta sociale që ka trashëguar, në këto tre dekada pothuajse e ka humbur identitetin e saj. Fenomenet dhe dukuritë sociale janë bërë gjithë përfshirëse, të shtrira sa në dimensionin individual, po asq në atë familjar e shoqëror. Rritja e numrit të divorceve parasheh një tkurrje të familjes dhe tronditje të themeleve të saj. Kjo vlerësohet si një pasojë e rëndë për shoqërinë. Ajo transformohet në shifra të frikshme më shumë në marrëdhëniet e tronditura martesore, divorcet, mungesa e dëshirës për të patur fëmijë, varfëria shpirtërore për shkak të pasigurisë së jetës dhe vështirësive financiare, të cilat po e çojnë popullsinë shqiptare në plakje.

Shoqëria po përballet me psikologji të tronditur përballë krimit, korrupsionit, kronikës së zezë dhe fenomeneve që shkaktojnë vetëgjyqësi. Humbja e jetës po bëhet fenomen i zakonshëm, jo vetëm për shkak të sëmundjeve natyrale, por si pasojë e pasigurisë, e cila shkarkon mbi liritë dhe të drejtat e njeriut në një shtet ku respekti për ligjin ka humbur vlerat e tij. Vetëm gjatë 3 muorit të parë të vitit 2020 në Shqipëri u regjistruan mbi 6 mijë vdekje nga sëmundje të ndryshme, nga pasojat e pandemisë por dhe nga kostua e krimit mbi jetën e njeriut, në të njëjtën kohë kur statistikatat e zakonshme në shtetin shqiptar regjistrojnë 60 vdekje në muaj. Shqipëria mbylli vitin 2021 me 30,580 vdekje. (<https://www.reporter.al/2022/02/11/82691/>).

Krahasimi është i frikshëm. Abuzimet ndaj grave dhe fëmijëve, sidomos në zonat rurale, janë plagët e vazhdueshme, duke parë disnivelet e standartit të jetesës në raport me qytetet. Ka raste të ndryshme ku janë dhënë dëshmi, vetëm ligjet e forta mund ta frenojnë dhunën dhe abuzimin e fëmijëve, keqtrajtimin, papërgjegjshmërinë nga prindrit e tyre. Vëmendje meriton trajtimi i grave dhe vajzave për situatën e rëndë që përjeton popullsia në vështirësi jetese.

IV.2. Mediat dhe Opinioni Publik në mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut

A ka rëndësi roli i opinionit publik dhe mediave në mbrojtjen e të drejtave njerëzore? A duhet të perceptojë opinioni i gjerë ndikimin e akteve juridike kombëtare e ndërkombëtare në garantimin e lirive dhe të drejtave të tyre? Për shumë studiues të kësaj fushe, sigurisht që përgjigja e pyetjeve

është e qartë, sepse në fakt shumë pak gjëra që ndodhin në botë dhe në mjedisin shqiptar, të cilat nuk bëhen objekt i “*kronikës së zezë*”, japin një pasqyrë të qartë të asaj që ndodh në fakt në jetën e qytetarëve. Ka shumë rëndësi nxjerrja në pah e ligjeve që mbrojnë këto të drejta, të kornizave kushtetuese, të akteve ligjore, të ndëshkimit nëpërmjet kodit penal dhe atij civil, të nënakteve ligjore e administrative që rregullojnë jetën sociale dhe mbrojnë të drejtat njerëzore.

Ky dimension juridik dhe social ka nevojë të përherëshme për mbështetjen mediatike, duke kushtëzuar karakterin përgjithësues dhe edukativ të saj. Nëse opinionin publik dhe mediat kanë kaq shumë rëndësi, atëherë në materiale hulumtuese, problemi duhet prekur në thelb: Si e kanë trajtuar studiuesit këtë çështje? Duke e parë problemin në vijë të drejtë, atëherë krejt ndryshe mund të thuhet për analizën që duhet bërë, e cila trajtohet në literaturë më të zgjeruar, në raport me qëndrimin dhe pozicionin e grupeve të interesit në fushën e mbrojtjes së të drejtave njerëzore.

Shpjegimi individual i problemit nga përvoja, çdo herë mbështetet në psikologjinë e vendimmarrjes institucionale, në vendimet gjyqësore, në mbrojtjen e të drejtës përmes avokatisë, në qëndrimin e organeve të sigurisë publike, duke formuar në përgjithësi opinionin shoqëror mbi këtë temë të nxehtë sociale. Në përgjithësi opinionin qytetar është larg njohjes së kuadrit ligjor, dhe në përballje me ligjin apo mjedisin social, dominojnë koncepte negative, të cilat diktojnë edhe mbi vetë përfaqësuesit e ligjit për të mos vepruar sipas ligjit. Në hapësirën mediatike dominojnë dy alternativa, të cilat dukshëm ndikojnë në opinionin shoqëror. “*Modeli pluralist*” është vënë përballë “*modelit elitar*”, (Piers Robinson, 2012: 210), ku e drejta qytetare dhunohet apo keqtrajtohet pa kurrfarë kufizimi, ndërsa e drejta elitare mbrohet apo fshihet pas ligjit dhe ushtrimit të së drejtës së pushtetit, duke thelluar hendekun në konfliktin social të së drejtës dhe detyrimeve në një shoqëri demokratike. Në rolin e medias në mbrojtjen e të drejtave të Njeriut, rëndësi merr paraqitja e koncepteve, argumenteve dhe trajtimet teorike që lidhen me çfarë duhet të dijë opinionin publik në raport me detyrimin e sistemit mediatik, duke i integruar dy elementet me kornizat ligjore dhe disiplinat juridike për garantimin nëpërmjet zbatimit. Të dy elementet nxjerrin detyrime për institucionet ligjzbatuese, organet e drejtësisë dhe të rendit publik, të cilat përballen me qëndrimin qytetar. Në shumë raste individin nuk i njeh të drejtat dhe detyrimet e tij përballë shtetit, ligjit, familjes dhe mjedisit social në komunitet.

Njohja dhe sensibilizimi është detyrë e përherëshme mediatike, me objekt, njohjen e të Drejtave dhe Përgjegjësisë, të cilat janë të mbrojtura me ligj. Askush nuk mund të abuzojë dhe t’i shkel këto të drejta, nën frymën e justifikimit dhe mbulimit të situatës sociale. Gjetja e mënyrave të pasqyrit dhe nxjerrjes së problemit kryesor që cënon të drejtat, është detyrim sa institucional,

po aq individual. Brenda dimensionit mediatik me ndikim në sferën publike, mediat e lajmeve, përfshi lajmet në TV, gazeta, dhe forma të tjera komunikimi, nëpërmjet lajmit, aktualitetit dhe programeve, duhet të përfshihen në sistemin edukativ, për të lehtësuar qëndrimin qytetar dhe ndërgjegjësuar qëndrimin juridik shtetëror. Harmonia mes tyre, ndikon pozitivisht në zbatimin e politikave qeveritare me interes publik. Brenda sistemit mediatik dallohet lehtësisht misioni propagandistik, investigativ dhe denocues, të cilat nuk janë në një linjë me pritshmëritë në standardizimin e jetës sociale të individit në raport me shtetin. Brenda sistemit funksionojnë “*sfera e konsensusit, sfera e kundërshtimit të justifikuar dhe sfera e devijimit*”, (Piers Robinson, 2012:217), të cilat prezantojnë thelbin e sistemit mediatik në raport me detyrimin që ai ka ndaj qytetarëve dhe komunitetit. Mes tyre qëndrojnë politikat redaksionale, bosët e financimit, diktati shtetëror, të cilët nxisin terrorin psikologjik mbi qytetarin me anë të kronikës së zezë, vendimmarrjeve të publikuara dhe kufizimeve që rëndojnë mbi vetëdijen qytetare.

Në paraqitjen e rolit mediatik, shpesh roli i tyre mbetet pasiv, përballë konsensusit që kërkon zgjidhja e situatës që shkakton plagën më të rëndë sociale të shoqërisë. Ç’ekuilibrimi i shoqërisë, sistemit mediatik dhe publik në veçanti, në mjedisin social-politik shqiptar ka një arsye, e cila shfaqet në konfliktin e interesit, mbulimin e situatës, anashkalimin e përgjegjësisë, përftimeve institucionale dhe individuale të nxitura nga korrupsioni, duke lënë shpesh në mjerim familje të tëra, fëmijë dhe gra të dhunuara, pasiguri të jetës, drejt kaosit social me pasoja në jetën publike dhe komunitet. Koncepti i ristrukturimit të programacionit mediatik në sistemin publik, sipas orientimeve akademike e universitare, në ndikimin e Shoqërisë Civile dhe organizatave humanitare, përcakton më së shumti rrjedhojat për të ardhmen e shoqërisë. Nuk ka më justifikim prej politikanëve, gazetarëve, bosëve të mediave, për fshehjen që ata i bëjnë qëllimeve të tyre, në ballafaqim me të drejtat njerëzore. Në këtë rast, sistemi mediatik duhet të dalë nga kornizat teorike të gazetarisë statike, duke i shërbyer çështjeve humane. Cilado qoftë vlefshmëria studimore e trajtimit të problemit shoqëror, mediat duhet të ndikojnë në këndvështrimin ideologjik të propagandës, pa nënvleftësuar zgjidhjet racionale që respektojnë të drejtat për një shoqëri të shëndetshme.

IV.3. Vlera e dobishme të Lirisë së Shprehjes, Publikimit dhe Informacionit

Në ndryshimet e fundit ligjore për të respektuar të drejtat, shpifja konsiderohet vepër kriminale. Në studimin e situatës, ka presione nga biznesi dhe grupet kriminale për të ndikuar në sistemin mediatik në mënyra të papërshtatshme. Shtypi dhe media, përfshirë media online sot janë aktive

dhe kanë të drejtën të shprehin larmi pikëpamjesh dhe qëndrimesh mbi jetën dhe shoqërinë, pavarësisht presionit të ushtruar indirekt ndaj tyre nga politika dhe struktura të tjera që përfaqësohen nga grupet e interesit. Nuk përjashtohen kërcënimet dhe dhuna ndaj gazetarëve, të cilët të përfshirë në mediat investigative bëjnë përpjekje të denoncojnë aktet e korrupsionit dhe të krimit për opinionin publik. Pronarë biznesesh përpiqen ta përdorin atë për interesat e tyre, drejt favoreve për të promovuar bizneset jashtë konkurrencës së ndershme, duke shkaktuar probleme.

Shumica e pronarëve të stacioneve televizive private, përdorin transmetimet për të ndikuar në veprimet apo qëndrimet ligjore të institucioneve të shtetit ndaj biznesit të tyre. Kjo reflekton në shantazhe dhe presione, duke shkelur të drejtën ligjore. Presioni politik, korrupsioni dhe mungesa e fondeve, uria financiare, detyron shumë stacione TV apo media të pavarura të bëjnë lëshime, duke deformuar informacionin e nevojshëm për opinionin publik. Fenomeni dhunon të drejtën e gazetarëve, duke imponuar vetëçensurimin e lajmit dhe informacionit. Pasiguria financiare për mungesë të kontratave të zbatueshme të punës, ul pavarësinë e mediave në raport me të drejtën.

Unioni i Gazetarëve Shqiptarë (AJU) reagon rast pas rasti kundër shkeljeve të të drejtave të gazetarëve dhe organeve mediatike, të cilat rëndojnë situatën e sigurisë në veprimtarinë mediatike. Problemet financiare nxisin gazetarët të mbështeten në burime të jashtme, duke cënuar integritetin profesional. Fenomeni deformon etikën profesionale, rrit dezinformacionin mbi opinionin publik. Informacioni nga mediat on-line, ka zgjeruar mundësitë e informimit në hapsira më të mëdha, jashtë çensurës dhe kufizimeve mbi fjalën e lirë. Nuk janë të pakta rastet e dhunës dhe shqetësimeve ndaj mediave dhe personelit të tyre. Vetëm për vitin 2020 Unioni i Gazetarëve Shqiptarë denoncon mbi 14 raste të ushtrimit të dhunës dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve dhe reporterëve të terrenit. (<https://unionigazetareve.com/index.php/rreth-nesh/>). Problem shqetësues në Shqipëri përbën çensurimi dhe kufizimet e përmbajtjes së informacionit, duke cënuar të drejtën e fjalës së lirë dhe të drejtën e informimit të opinionit publik.

Shembull: Një studim i 800 profesionistëve të mediave publikuar në muajin maj të vitit 2020, zbuluan se, 62 % e të anketuarve mendonin se kishte ndërhyrje nga individë ose nga politika, 60 % mendonin se; ka pasur ndërhyrje nga pronarët e mediave; 39 % mendojnë se kishte autoçensurim dhe 31 % mendonin se kishte korrupsion në media. Rreth 78 % e profesionistëve të mediave mendonin se, kishte gazetarë që merreshin me praktika korruptive për të përhapur dezinformacionin në opinionin publik. (<https://www.idrainstitute.org/sq/events/media-study>, Raporti i Plotë, Panorama e Medias në Shqipëri). Ligji kundër shpifjes, jep të drejtën individëve dhe

subjekteve të kundër veprojnë duke u mbështetur në sistemin e drejtësisë, kundër dhunës ndaj të drejtës dhe të vërtetës.

Udhëheqësi shpirtëror i të Drejtave Civile Martin Luther King Jr. Thëniet për të kuptuar Fuqinë e një Vizioni, të mendimit, ideve dhe të fjalës së lirë.



Foto: Martin Luter King, luftëtari i humanizmit dhe të drejtave të njeriut

Njeriu përparon në luftën kundër shkeljes së të drejtave njerëzore, kundër dhunës, diskriminimit fetare e racor. Ishte vetëm 39 vjeç kur u vra 52 vjet më parë, më 4 Prill të vitit 1968. Vlera e ideve të tij humane e paqësore synonin pranimin, barazinë, protestat paqësore, kundër racizmit, duke bërë jehonë në jetën e njerëzimit. Fjalimet e guximshme, triumfuese dhe prekëse u dëgjuan nga miliona njerëz, duke përcjellë energjitë e tij positive, duke vrarë frikën për të ngritur lartë vlerat morale të jetës. Liria e shprehjes, e publikimit dhe sigurimit të informacionit mori forcë morale dhe shoqërore nga këta njerëz të jashtëzakonshëm, që sakrifikuan jetën e tyre në shërbim të paqes, harmonisë dhe të të drejtave njerëzore. “Një e drejtë e vonuar është një e drejtë e mohuar. Çdo njeri që ka një ëndërr, duhet ta ndjek atë me forcën e një vizioni”.

7. Përfundime

Punimi studimor në strukturë, është trajtuar dhe sjellë brenda dimensionit të konflikteve të herë pas hershme që kanë pasur qytetarët me ligjin dhe shtetin, në lidhje me respektimin e të drejtave

të tyre, apo të të drejtave të vonuara dhe të mohuara, të cilat kanë sjellë ndikime sociale në shoqëri. Ndihet e nevojshme njohja e trajtimit të ligjeve specifike, që rregullojnë veprimtarinë institucionale mbi të drejtat dhe liritë e njeriut, të drejtësisë, shëndetësisë, punës sociale dhe të rendit publik, si dhe harmonizimin e shtyllave bazë të demokracisë që i garantojnë ato.

Shpesh qytetarët nuk njohin detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre, duke ekspozuar shtresëzimet sociale dhe realitetin kontradiktor. Ato në përplasje por dhe ndërveprim, shfaqin lidhje racionale përmes të drejtave, solidaritetit dhe situatës paqësore të nevojshme të shoqërisë shqiptare. Përfshirja e standardeve bashkëkohore, jep hapësira për ide të reja racionale të unifikuara në mbrojtje të të drejtave njerëzore, duke shfaqur sfidën në ndërgjegjësimin qytetar.

Në jetën shqiptare, në mënyrë të hapur dhe të argumentuar, shfaqen faktorët dhe aktorët politik, të cilët shkaktojnë konfliktet që dominojnë jetën social-politike të popullit dhe institucioneve. Konceptet bazë filozofike, psikologjike dhe juridike, të parashtruara në dokumentet kryesorë të drejtësisë shqiptare, shfaqin karakterin formal në ballafaqim me realitetin.

Marrëdhëniet e shtetit me qytetarin nuk garantojnë mbrojtjen e të drejtave në Shqipërinë postkomuniste. Strukturat bazë të shoqërisë duhet të përfshihen në mbrojtje të tyre, duke vlerësuar elementet bazë objektive dhe subjektive, të cilët bëhen shkak dhe mbështetje për gjenerimin e mendimit pozitiv në qëndrimin qytetar. Tranzicioni i gjatë nuk arriti të minimizojë negativitetet e një sistemi me mentalitet të mbyllur, duke toleruar abuzimet mbi të drejtat dhe pronën, tjetërsimeve, diskriminimit social, si diktate politike që imponuan sistemet e një drejtësie të korruptuar.

Mbështetur në të drejtat kushtetuese, analiza dhe ballafaqimi sjellin tablo konkrete në mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve, grave, fëmijëve, të drejtave në paraburgim, trafikimeve, të drejtës së informacionit, të denoncuar nga Zyra e Avokatit të Popullit. Ligji dhe individi ndodhen në dezëharmonit në një mjedis social-juridik të ngarkuar me probleme. Ndikimet psikologjike mbi shoqërinë janë të fuqishme.

Ballafaqimi me kërkesat ndërkombëtare mbi garancitë e mbrojtjes së të drejtave njerëzore, është qëndrimi kritik i imponuar ndaj institucioneve kombëtare, të cilat për një kohë të gjatë e humbën orientimin mbi atë çfarë është thelbësore dhe e dobishme në Drejtësinë Shqiptare, për të mbrojtur vlerat e demokracisë. Sjellja e përvojës dhe përmbajtjes së akteve ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, janë ndihmesë konstruktive kundër interpretimeve anësore, duke u ballafaquar me përvojat e shteteve me demokraci të zhvilluar.

Këndvështrimi mbi fenomenet sociale dhe juridike të shkeljes së të drejtave njerëzore, shkakët e fenomeneve negative, diktojnë nevojën e masave parandaluese, të cilat në çdo rast duhet të jenë institucionale dhe individuale në zgjidhjen pozitivisht të situatave. Në thelb, kjo ka të bëjë me një problem politik dhe social mbi të ardhmen e shoqërisë.

Në analizën e përgjithëshme merr rëndësi promovimi i qasjeve të reja dhe përvojave të mira, të cilat nuk mungojnë në praktikën juridike shqiptare mbi të drejtat njerëzore. Përgjegjshmeria institucionale dhe individuale në ballafaqim me shkallën e sensibilizimit të shoqërisë, ka rritur ndikimin e institucioneve ndërkombëtare mbi drejtësinë shqiptare, duke sjellë ndryshime pozitive në mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Në praktikën juridike është sjellë diçka e re, që ka të bëjë me rritjen e fuqisë së vetëdijes qytetare përballë detyrimeve institucionale, rritjen e nivelit të emancipimit shoqëror në mjedisin shqiptar, përballjen me kushte e rregulla të reja, të cilat kanë bërë hapa përpara në marrëdhënien e individit me vetëveten, shoqërinë, ligjin, shtetin dhe politikën.

Ndryshimet dhe përvojat e mira ndaj kujdesit qytetar, kanë minimizuar dukuritë negative në ushtrimin e të drejtës së ligjit, të cilat nuk janë kufizuar vetëm brenda kuadrit juridik shtetëror, por shumë më gjerë, për shkak të detyrimeve që ka Republika e Shqipërisë si vend antar i NATO dhe synimit të saj për t'u antarësuar në BE. Kështu, mbrojtja e të drejtave të njeriut ka marrë dimension të gjerë për ekuilibrin e jetës shqiptare, duke e kthyer atë në burime të sigurisë dhe forcimit të sigurisë së brendshme dhe të jashtme të vendit.

Nëse çdo qytetar apo individë i përfshirë në veprimtari politiko-shoqërore apo të biznesit do të njihet, përfshihet në sistemin e edukimit dhe atë informativ mbi vlerat kushtetuese të ligjit dhe përmbajtjen e Konventës Universale Evropiane e të Drejtave të Njeriut, kjo do të jetë një lehtësi sociale dhe juridike që do të mundësojë kuptimin e qartë të qëllimit dhe rolin e drejtësisë dhe të së Drejtës, përgjegjësi, të drejtave, detyrimeve, duke balancuar jetën e individit në raport me shtetin, ligjin dhe shoqërinë.

Bibliografi

- Aggestam, Lisbeth, Politika e Jashtme, “*BE dhe zgjerimi*”, *Botim Politika e Jashtme, teori, aktorë, raste*”, Shtëpia botuese AiiS, Tiranë 2012:522;

- Aristoteli (184-322), Shtëpia Botuese “*Fllad*”, përkthyes Hysni Bregu, Tiranë 2001, f. 9, 23, 26, 38, 77; 85, 140, 147, 148, 149, 154, 158;
- Abazi, Bashkim, Ekstremitetë të Filozofisë (Kultura dhe Morali), Shtëpia Botuese “*GEER*”, Tiranë 2013, f. 89, 159, 182;
- Abazi Sulejman, Mbi Strategjinë Kombëtare, Shtëpia Botuese “Era”, Prishtinë 2019, f. 73, 94, 101;
- By Lora Jones, Palumbo, Daniele & David Brown, Coronavirus: A visual guide to the economic impact, 2021;
- Council of Europe. Archived 2008-02-14 at the Wayback Machine;
- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut; <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2020/10/covid-guide-alb.pdf>. “Covid-19 dhe Impakti mbi të Drejtat e Njeriut”. Shikim i përgjithshëm mbi jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Shtator 2020, f. 20;
- D'Amato A, 273–274, 325–327; International Law: Process and Prospect (1986) pp. 123–147;
- Galimberti, Umberto, psiko-analist, 25 Prill 2020. Analiza: “*Reflektime në kohën e koronavirusit mbi kuptimin e së ardhmes*”. (Shqiptarja.com);
- Giddens, Antoni, ”*Analizë mbi letërsinë e viteve '30*”, 1997 : 185;
- G. Feltham, Ralph, Diplomacia, “*Marrëdhëniet Diplomatike*”, Shtëpia Botuese “*Aiis*”, Tiranë 2010, f. 13;
- Hoxha Dorian, Osmani Enkeleida, “*Balkan Journal of interdisciplinary Research HPCCL Publishing: E drejta për informim e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore*”, Tirana-Albania, Vol. 2 Nr. 3, 2017:87
- Humphrey JP, “*The Universal Declaration of Human Rights: Its History, Impact and Juridical Character*”, in Ramcharan BG (ed), Human Rights: Thirty Years After the Universal Declaration (1979) pp. 21, 37; Sohn I, “The Human Rights Law of the Charter” (1977) 12 Texas Int LJ 129, 133;
- Huntington Samuel P, “*Përplasja e Qytetërimeve dhe ribërja e rendit botëror*”, Shtëpia Botuese “*Logos-A*”, Shkup, Prishtinë, Tiranë, 2004, f. 310, 314, 316;
- Kissinger Henry, “*Rendi Botëror, Reflektime mbi karakterin e kombeve dhe kursin e historisë*”, Shtëpia botuese Aiis, Tiranë 2015:356;
- Kumnova, Edmond, cituar, Hooker, Laws of Ecclesiastical Polity, I, 8, § 7, Prishtinë, 2007;
- Kanuni Lek Dukagjinit, botim Tiranë 2005;

- Kushtetuta e R. Shqipërisë, Kapitulli, “*Të drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut*”, Kreu Parime të Përgjithshme, Tiranë 2017, neni 15, faqe 8, 9, 12; 17,18,21,27,51
- Konferenca e 23 e Ministrave Europiane të Drejtësisë, zhvilluar në Londër, në qershor të vitit 2000;
- Konventa Ndërkombëtare e të Drejtave të Fëmijëve;
- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- Le Bon, Gustave, “*Psikologjia e racave*”, Shtëpia Botuese “*Reklama*”, Tiranë 2001, f. 6, 38, 75;
- Meta, Beqir, Frashëri Ermal, Studim Kornizë, “*Mbi sistemin e burgjeve, internimit dhe punës së detyruar gjatë regjimit komunist në Shqipëri*”, Tiranë 2018:7,9,11,20,29;
- Michael Barnett, Botim “*Politika e Jashtme, Teori-Aktorë-Raste*”, “*Tragjedia e Ruandës*”, Shtëpia Botuese “*Aiis*” UET PRESS, Tiranë 2012:293;
- McDougal MS, Lasswell H and Chen I, Human Rights and World Public Order (1980) pp;
- Marek Piechowiak, www.researchgate.net, Instituti Holandez për Studimet e Larta. Koncepti mbi të drejtat e njeriut;
- Office of the High Commissioner for Human Rights. "Digital record of the UDHR". United Nations;
- Piechoëiak, Marek, Instituti Holandez për Studimet e Larta. Koncepti mbi të drejtat e njeriut ee.researchgate.net;
- Piers Robinson, Politika e Jashtme, “*Roli i medias dhe i opinionit publik*”, Botim Politika e Jashtme, teori, aktorë, raste”, Shtëpia botuese Aiis, Tiranë 2012:212;
- Quentin Skinner, Makiaveli, një hyrje e shkurtër, Botimet Ideart–Adrion, Tiranë 2018:82;
- Rosemary Foot, botim “*Politika e Jashtme, Teori-Aktorë-Raste*”, “*Tragjedia e Ruandës*”, Shtëpia Botuese “*Aiis*” UET PRESS, Tiranë 2012:430, 432, 551;
- Raporti Vjetor i Avokatit të Popullit për vitin 2019, Tiranë 2020 f. 5;
- Reaper William, Smith Linda, Shtëpia Botuese “*Ditura*”, “*Metodologjitë dekolonizuese: Kërkimi dhe popujt indigjenë*”, Zed Books, Londër Carla Wilson, Grupi i Menaxhimit të Njohurive Ministria e Zhvillimit Social, 1999:89;
- Raporti i Plotë, Panorama e Medias në Shqipëri, 2020. <https://www.idrainstitute.Org/sq/events/media-study>,

- Schopenhauer, Arthur, “*Oxford University Press, 2002*”, Vështrim filozofik, botim në shqip i shtëpisë botuese “*Ideart*”, Tiranë 2005: 139;
- Smith, Steven, Hadfield Hamelia, Dunne Tim, Politika e Jashtme, teori, aktorë raste, Shtëpia Botuese AiiS, Tiranë 2012;
- Skinner, Quentin, Makiaveli, një hyrje e shkurtër, Botimet Ideart-Adrion, Tiranë 2018;
- Teksti i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (anglisht);
- Teksti i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (shqip);

- "UDHR50: Didn't Nazi tyranny end all hope for protecting human rights in the modern world?". Udhhr.org. 1998-08-28. "UDHR – History of human rights". Universalrights.net. Marrë më 2012-07-07;

REFERENCES

Gest Aggestam, Lisbeth, Foreign Policy, "EU and enlargement", Foreign Policy Publishing, theory, actors, cases ", AiiS Publishing House, Tirana 2012: 522;

☞ Aristotle (184-322), Publishing House "Fllad", translator Hysni Bregu, Tirana 2001, p. 9, 23, 26, 38, 77; 85, 140, 147, 148, 149, 154, 158;

☞ Abazi, Bashkim, Extremes of Philosophy (Culture and Morality), Publishing House "GEER", Tirana 2013, p. 89, 159, 182;

☞ Abazi Sulejman, On the National Strategy, Publishing House "Era", Prishtina 2019, p. 73, 94, 101;

☞ By Lora Jones, Palumbo, Daniele & David Brown, Coronavirus: A visual guide to the economic impact, 2021;

☞ Council of Europe. Archived 2008-02-14 at the Wayback Machine; Ale Universal Declaration of Human Rights; <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2020/10/covid-guide-alb.pdf>. Covid-19 and the Impact on Human Rights. Overview of the jurisprudence of the European Court of Human Rights, September 2020, p. 20;

☞ D'Amato A, 273–274, 325–327; International Law: Process and Prospect (1986) pp. 123–147;

☞ Galimberti, Umberto, psychoanalyst, April 25, 2020. Analysis: "Reflections in coronavirus time on the meaning of the future." (Shqiptarja.com);

☞ Giddens, Antoni, "Analysis of the literature of the '30s", 1997: 185;

☞ G. Feltham, Ralph, Diplomacy, "Diplomatic Relations", Publishing House "AiiS", Tirana 2010, p. 13;

☞ Hoxha Doriana, Osmani Enkeleida, "Balkan Journal of interdisciplinary Research HPCCL Publishing: The right to information of victims of trafficking in human beings", Tirana-Albania, Vol. 2 Nr. 3, 22017: 87

☞ Humphrey JP, "The Universal Declaration of Human Rights: Its History, Impact and Juridical Character", in Ramcharan BG (ed), Human Rights: Thirty Years After the Universal Declaration (1979) pp. 21, 37; Sohn 1, "The Human Rights Laë of the Charter" (1977) 12 Texas Int LJ 129, 133;

☞ Huntington Samuel P, “The Clash of Civilizations and the Restoration of the World Order”, Logos-A Publishing House, Skopje, Prishtina, Tirana, 2004, p. 310, 314, 316;

☞ Kissinger Henry, “World Order, Reflections on the Character of Nations and the Course of History”, AiiS Publishing House, Tirana 2015: 356;

Umn Kumnova, Edmond, quoted, Hooker, Laws of Ecclesiastical Polity, I, 8, § 7, Prishtina, 2007;

☞ Kanun Lek Dukagjini, published in Tirana 2005;

☞ Constitution of the Republic of Albania, Chapter, "Fundamental Human Rights and Freedoms", Chapter General Principles, Tirana 2017, article 15, pages 8, 9, 12; 17,18,21,27,51

23 23rd Conference of European Ministers of Justice, held in London, in June 2000;

Ndërk International Convention on the Rights of the Child;

Evrop European Convention on Human Rights;

☞ Le Bon, Gustave, “Psychology of races”, Publishing House “Reklama”, Tirana 2001, p. 6, 38, 75;

Eta Meta, Beqir, Frashëri Ermal, Studim Korrnizë, “On the system of prisons, internment and forced labor during the communist regime in Albania”, Tirana 2018: 7,9,11,20,29;

☞ Michaael Barnett, Publication "Foreign Policy, Theory-Actors-Cases", "Rwanda Tragedy", Publishing House "AiiS" UET PRESS, Tirana 2012: 293;

☞ McDougal MS, Lasswell H and Chen I, Human Rights and World Public Order (1980) pp;

. Marek Piechowiak, www.researchgate.net, Dutch Institute for Higher Studies. Concept on human rights;

☞ Office of the High Commissioner for Human Rights. "Digital record of the UDHR". United Nations;

☞ Piechoëiak, Marek, Dutch Institute for Higher Studies. Concept on human rights www.researchgate.net;

☞ Piers Robinson, Foreign Policy, "The role of the media and public opinion", Publication Foreign Policy, theory, actors, cases ", AiiS Publishing House, Tirana 2012: 212;

☞ Quentin Skinner, Machiavelli, a brief introduction, Ideart – Adrion Publications, Tirana 2018: 82;

- Em Rosemary Foot, publication "Foreign Policy, Theory-Actors-Cases", "Rwanda Tragedy", Publishing House "AiiS" UET PRESS, Tirana 2012: 430, 432, 551;**
- V Annual Report of the People's Advocate for 2019, Tirana 2020 p. 5;**
- 📖 Reaper William, Smith Linda, Wisdom Publishing House, Decolonizing Methodologies: Research and Indigenous Peoples, Zed Books, London Carla Wilson, Knowledge Management Group Ministry of Social Development, 1999: 89;**
- I Full Report, Media Panorama in Albania, 2020. <https://www.idrainstitute.org/sq/events/media-study>,**
- 📖 Schopenhauer, Arthur, "Oxford University Press, 2002", Philosophical Overview, Albanian edition of the publishing house "Ideart", Tirana 2005: 139;**
- 📖 Smith, Steven, Hadfield Hamelia, Dunne Tim, Foreign Policy, Theory, Case Actors, AiiS Publishing House, Tirana 2012;**
- 📖 Skinner, Quentin, Machiavelli, a brief introduction, Ideart-Adrion Publications, Tirana 2018;**
- 📖 Text of the Universal Declaration of Human Rights (English);**
- 📖 Text of the Universal Declaration of Human Rights (Albanian);**
- 📖 UDHR50: Didn't Nazi tyranny end all hope for protecting human rights in the modern world?". Udhr.org. 1998-08-28. Retrieved on 7/7/2012;**

Burime nga Interneti

- [https://realiteti.post.net.the-economist-ballkani-po-mbetet-pa-njerez-popullsia-e-shqiperise-pritet-te-tkurret-me-26-deri-n-e2050](https://realiteti.post.net/the-economist-ballkani-po-mbetet-pa-njerez-popullsia-e-shqiperise-pritet-te-tkurret-me-26-deri-n-e2050);
- <https://shcba.gov.al/wp-content/uploads/2020/06/RAPORT-VJETOR-2019-SHCBA-pdf>, ankesa@shcba.gov.al; PDF-f. 7-10, Tiranë 2020;
- <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports>, Raporti i Avokatit të Popullit PDF, Aneks-1, 2020:179-187);
- <https://www.alo116.al/sites/default/files/uploade/Raport%20Tematik%20%20Femijet%20e%20Humbur%20ne%20Shqiperi%202015.pdf>;
- https://sq.wikipedia.org/wiki/Deklarata_Universale_per_te_Drejtat_e_Njeriut;
- <https://www.facebook.com/kohajone/videos/601363330479752/?d=null&vh=e>;
- <https://www.crca.al/sites/default/preambula>. Neni 29/2, f.2;
- <https://dosja.al/ish-kreu-i-keshillit-evropian-demon-shembjen-e-tk-tusk-cenon-vlerat-evropiane-u-perdor-dhune-kunder-protestuesve/>;
- <https://tvklan.al/opinion-live-18-maj-2020/>;
- https://www.instagram.com/tv/CAaV7IHgV0I/?utm_source=ig_web_copy_link;
- <https://www.crca.al/sq/vepro-per-femijet-news>;
- <https://www.oraneës.tv/article/mbyllja-e-rtv-ora-shima-po-mbyllet-nje-tv-qe-nuk-jep-lajme-te-gatshme>;
- <http://top-channel.tv/video/nen-dhune-dhe-ne-karantine-grate-me-urdher-mbrojtje-jane-ne-veshtiresi-te-medha/> Informacion i marr nga top- channel;
- <https://www.youtube.com/watch?v=fDYoEmcw53o>;
- ABC News Albania <https://www.youtube.com/watch?v=VXmW0BXvcOI>;
- <https://www.youtube.com/watch?v=4ëëfëIGTW-A>;
- <https://atna.it/2020/04/16/neder-berati-ngrihet-ne-kembe-kunder-edirames-qytetaret-kerkojne-arrestimin-dhe-shkarkimin-e-drejtorit-hasan-ahmetaj/>;
- <https://atna.it/2020/03/27/si-ne-filma-aksion-dy-polic-dhe-nje-ushtar-i-ndjekin-kemba-ke-mbes-djalin-e-ri/>;
- <https://www.reporter.al/2022/02/11/82691/>

Internet Resources

 <https://realitypost.net/the-economist-balkani-is-left-without-people-the-population-of-albania-is-expected-to-shrink-with-26-until-2050>;

 <https://shcba.gov.al/wp-content/uploads/2020/06/RAPORT-VJETOR-2019-SHCBA-pdf>, complaint @ shcba.gov.al; PDF-f. 7-10, Tirana 2020;

 <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports>, Report of the People's Advocate PDF, Annex-1, 2020: 179-187);

 <https://www.alo116.al/sites/default/files/uploade/Raport%20Tematik%20%20Femijet%20e%20Humbur%20ne%20Shqiperi%202015.pdf>;

 https://en.wikipedia.org/wiki/Universal_Declaration_for_Human_Rights;

 <https://www.facebook.com/kohajone/videos/601363330479752/?d=null&vh=e>;

 <https://www.crca.al/sites/default/> preambula. Article 29/2, p.2;

 <https://dosja.al/ish-kreu-i-keshillit-evropian-denon-shembjen-e-tk-tusk-cenon-vlerat-evropiane-u-perdor-dhune-kunder-protestet>;

 <https://tvklan.al/opinion-live-18-maj-2020/>;

 https://www.instagram.com/tv/CAaV7lHgV0I/?utm_source=ig_web_copy_link;

 <https://www.crca.al/sq/vepro-per-femijet-news>;

 <https://www.oranees.tv/article/mbyllja-e-rtv-ora-shima-po-mbyllet-nje-tv-qe-nuk-jep-lajme-te-gatshme>;



<http://top-channel.tv/video/nen-dhune-dhe-ne-karantine-grate-me-urdher-mbrojtje-jane-ne-veshtir-esi-te-medha/> Information I get from top- channel;



<https://www.youtube.com/watch?v=fDYoEmcw53o>;

BC ABC News Albania <https://www.youtube.com/watch?v=VXmW0BXvcOI>;

Ps <https://www.youtube.com/watch?v=4ëëfëIGTW-A>;



<https://atna.it/2020/04/16/neser-berati-ngrihet-ne-kembe-kunder-edirames-qytetaret-kerkojne-arr-estimin-dhe-shkarkimin-e-director-hasan-ahmetaj/>;



<https://atna.it/2020/03/27/si-ne-filma-aksion-dy-polic-dhe-nje-ushtar-i-ndjekin-kemba-kembes-djalin-e-ri/>;



<https://www.reporter.al/2022/02/11/82691/>

